



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 11.02.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Albana Vokshi – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore me Asamblenë e Pedagogëve për të diskutuar në lidhje me problematikat e krijuara nga ligji për arsimin e lartë, situatën në universitete gjatë dhe pas protestës studentore, “Paktin për universitetin”, vakumin e krijuar nga mosnxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, aktet nënligjore të fundit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe shqetësimet që kanë prodhuar këto vendime në botën akademike dhe çështje të tjera në lidhje me arsimin e lartë. *(Komision përgjegjës)*

**Marrin pjesë:**

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Mirela Kumbaro, Lindita Nikolla, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj.

**Mungojnë:**

Kejdi Mehmetaj.

**Të ftuar:**

*Përfaqësues të Asamblesë së Pedagogëve:*

Klejdi Kelliçi,

Altin Shegani,

Mark Marku,

Jani Marka,

Rezart Prifti.

## HAPET MBLEDHJA

**Albana Vokshi** – Mirëmëngjesi!

Në rendin e ditës së sotme, në mbledhjen e komisionit kemi dy dëgjesa.

E para, seancë dëgjimore me përfaqësues të Asamblesë së Pedagogëve, edhe në përgjigje të kërkesës publike që Asambleja e Pedagogëve e ka bërë pas mbledhjes së saj të dytë. Sigurisht, disa prej çështjeve që kemi për të diskutuar janë për problematikat e krijuara nga ligji për arsimin e lartë, situata në universitete gjatë dhe pas protestës studentore. Do të donim të ndaleshim edhe në opinionin e gjithsecilit prej jush për “Paktin për universitetin”, vakumin e krijuar nga mosnxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, për aktet e fundit nënligjore që ka miratuar qeveria nga Këshilli i Ministrave, si dhe shqetësimet që kanë prodhuar vendimet e fundit në botën akademike dhe çështje të tjera, që jam e sigurt se do të ngrihen gjatë kësaj seance dëgjimore.

Kemi të ftuar Klejdi Këllicin, Altin Sheganin, Mark Markun, Jani Markën dhe Rezart Priftin.

Unë do të doja t’ju jepja menjëherë fjalën, por, ju lutem, bëni prezantimin, sepse e kemi edhe për efekt regjistrimi! Pra, secili prej jush, kur të marrë fjalën, të bëjë një prezantim të vetes, për t’i pasur të gjitha të regjistruara.

E ka fjalën zoti Marku.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Faleminderit!

T’i limë 5 deri në 7 minuta kohë gjithsecilit, edhe për pyetjet, edhe për shqetësimet. Nëse do të doni më shumë kohë, pa problem, mjafton që ne t’i shterojmë të gjitha shqetësimet që kemi.

Zoti Marku, urdhëroni!

**Mark Marku** – E nderuar zonja kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë,

E para, faleminderit që na keni ftuar sot për këtë seancë dëgjimore!

Ne jemi një grup i autorizuar nga takimi i asambleve të Universitetit të Tiranës për të negociuar kërkesat që takimi i asambleve ka prezantuar publikisht dhe ua ka drejtuar edhe institucioneve qeveritare: Ministrisë së Arsimit, Kryeministrisë dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Normalisht, tagri ynë përfaqësues është vetëm për atë që ne negociojmë, nuk bëjmë negociata për kërkesat e kolegëve, por bëjmë procedurën e avancimit të kërkesave dhe të qëndrimeve tona në raport me të gjithë aktorët e interesuar për këto qëndrime.

Po e marr fjalën jo se jam kryetar i grupit, sepse të gjithë jemi të barabartë mes të barabartëve, por për të shpjeguar, e para, pse jemi këtu dhe, e dyta, problematikën që ne na shqetëson.

Ne jemi këtu si grup mbi bazën e një iniciative të ndërmarrë nga asambltetë e fakulteteve të Universitetit të Tiranës. Konkretisht janë mbledhur 4 nga 6 asambltetë e Universitetit të Tiranës. Para se ne të bënim takimin e të gjitha asambleve, asambltetë janë mbledhur dhe kanë dalë me disa kërkesa, mes të cilave ka qenë kërkesë unanime e 4 nga 6 asambltetë e Universitetit të Tiranës. Pra, 4 asamble janë shumicë në raport me të gjithë pjesën tjetër dhe pjesa tjetër jo se nuk është dakord me kërkesat tona, por praktikisht nuk janë mbledhur. Pra, kanë qenë unanime me 2-3 kërkesa.

E para, kanë mbështetur kërkesat e studentëve, siç kanë bërë në vazhdimësi.

E dyta, kanë arritur në përfundimin që ligji për arsimin e lartë ka krijuar probleme në universitet dhe është një nga problemet e arsimit të lartë në Shqipëri. Pra, nuk i ka krijuar ai të gjitha problemet, sepse janë të akumuluar ndërkohë, ndoshta edhe në një shekull. Problemi është se ligji u miratua dhe pas 4 vjetësh ka dhënë këto rezultate. Ne kemi qenë në grup që, të paktën në Universitetin e Tiranës, në bllok e kemi kundërshtuar ligjin për arsimin e lartë. Të gjitha këshillat e fakulteteve, të gjitha dekanatet, organizatat dhe forumet që operojnë brenda universitetit, forumi “Për lirinë akademike”, lëvizja “Për universitetin” e të tjera, senati i Universitetit të Tiranës dhe në momentin kur diskutohej projektligji, që sot është bërë ligj, të gjithë në bllok e kemi kundërshtuar. Nuk e kanë kundërshtuar se donin ta bënin, por grupi social që e ka kundërshtuar, është pjesa më e lidhur me universitetin, janë pedagogë që pjesën më të madhe, jetën, karrierën dhe interesat i kanë aty, të cilët e njohin shumë më mirë jetën universitare se kushdo që mund të pretendojë se e njeh.

Shqetësimi kryesor ka qenë për ligjin, ku në dy pika është bërë kundërshtimi më i fortë. Ka pasur edhe kundërshtime të tjera, por unë do të koncentroj dy gjërat bazë.

Modeli ekonomik që ofrohej përmes ligjit, e kemi thënë edhe para 4 vjetësh, kemi vazhduar për 4 vjet ta themi dhe të ngulmojmë për të, do të çonte në këtë krizë të sistemit arsimor në Shqipëri. Kemi thënë se nëse shteti nuk merr përsipër financimin e universitetit si universitet publik, duke e kaluar barrën e financimit te studenti, tarifat do të rriten atëherë shumë, sa do të rëndojnë mbi studentët dhe universiteti publik do ta humbasë natyrën e tij si universitet që ofron një produkt, që është një e mirë publike. Praktikisht ka ndodhur. Kur është prezantuar

ligji që kemi tani, është shoqëruar edhe me një kartë jeshile, që përcaktonte edhe grafikun e rritjes financiare të buxhetit të shtetit. Është thënë që atëherë se nëse ky ligj duhet të funksionojë, duhet të shoqërohet me këtë rritje të buxhetit të shtetit në mënyrë proporcionale vit pas viti. Çfarë ndodhi?

E para, buxheti i shtetit nuk u rrit, por, përkundrazi, shkoi duke u rrudhur.

Nga ana tjetër, e gjithë pesha ra mbi universitetet dhe automatikisht mbi studentët, sepse i vetmi shërbim që ofrojnë sot universitetet publike janë shërbimet studentore. Kjo bëri të rriteshin tarifat e studentëve, sepse praktikisht universitetet u futën në një logjikë ekonomike, që nëse nuk rrisin tarifat, do të falimentonin, do të mbylleshin.

E dyta, ka qenë autonomia. Në hyrje thuhet se ligji jep dhe garanton autonominë, madje se shteti e garanton autonominë. Problemi është se ligji e cenon autonominë financiare në të gjitha drejtimet. Praktikisht universiteti publik në Shqipëri nuk ka autonomi financiare, që është një nga kolonat e autonomisë së universiteteve, sipas standardeve të autonomisë së universiteteve publike në Europë.

Pse nuk ka autonomi? Autonomia financiare cenohet në dy drejtime.

E para, pjesa më e madhe e buxhetit për fondin e kërkimit shkencor, për inovacionin e të tjera, shkon te pesë agjencitë e krijuara nga qeveria, që janë direkt në varësi të saj. Këto pesë agjenci shërbejnë si një instrument, që praktikisht cenon autonominë financiare nga jashtë. Nga brenda është krijuar statusi që kanë bordet e administrimit bashkë me administratorët. Praktikisht krijojnë një pushtet paralel, ku autoritete akademike dhe institucionet përfaqësuese akademike nuk kanë asnjë akses në hartimin e politikave të menaxhimit të universiteteve.

Unë mendoj se prirja për të ndarë pjesën akademike me pjesën financiare ka qenë shumë e mirë në ligj, por ndarja është bërë në mënyrë të tillë, që ka krijuar pushtete paralele.

Për shembull, bordi krijohet, aty ku është shumicë, nga senati, me përfaqësues dominancë nga senati dhe tre nga qeveria. Problemi është se senati, pasi zgjedh përfaqësuesit e vet, nuk ka asnjë instrument në ligj që t'i kërkojë llogari, siç ka instrumente parlamenti për t'i kërkuar llogari qeverisë, të kërkojë ministra në seanca dëgjimore, të bëjë edhe mocion kundër qeverisë e të tjera. Pra, është krijuar ky pushtet paralel, i cili praktikisht i çon në një konflikt të vazhdueshëm të dyja anët, pjesën e menaxhimit dhe pjesën akademike. Ne kemi kërkuar të mos bashkohen siç kanë qenë, sepse ka qenë i gabuar përqendrimi edhe i politikëbërjes, edhe i menaxhimit të fondeve, sepse çojnë në korrupsion, por një ndarje, sipas së cilës, bordi dhe administratori të kenë mundësi të japin llogari dhe t'u nënshtrohen interesave shkencore të mësimdhënies së universitetit. Kjo gjë nuk ka ndodhur. Ky ka qenë problemi

kryesor dhe praktikisht ky problem ekziston në ligj. Ne mendojmë se universitetet funksionojnë nëse ligji ndryshon, të paktën në këtë pikë.

Problem tjetër, i cili është kundërshtuar fort, ka qenë kreu 12, sipas së cilit institucionet e larta publike mund të bëhen institucione publike të pavarura. Pra, lind e drejta që të privatizohen, në njëfarë mënyre, përmes disa procedurave që mund të kalojnë në fondacione e të tjera, dhe këtë e bën Bordi i Administrimit. Sipas ligjit, Bordi i Administrimit ka të drejtë të privatizojë universitetet publike, gjë që ndodh edhe me universitetet private, por këtu nuk jam për të diskutuar për to, sepse ata i diskutojnë vetë çështjet e tyre. Pra, ky është një rrezik shumë i madh për universitetin. Unë dhe kolegët e mi mendojmë se kjo fushatë denigrimi dhe shkatërrimi i universitetit, që po ndodh në këta 4 vjet, është pikërisht në funksion të shkatërrimit të universitetit publik, siç ka ndodhur me të gjithë sektorin publik, që degradoi deri në fund dhe, më pas, të krijojë kushtet që të privatizohen apo dikush t'i marrë në administrim me një kosto shumë të ulët. Ne, pjesa më e madhe e pedagogëve, e shikojmë si një projekt privatizimi në funksion të disa interesave, të cilat për momentin nuk i identifikojmë dot, sepse do të kalonim në akuza pa sens, por nuk shikojmë qëllim tjetër në këtë kre. Kjo është arsyeja dhe ndaj janë mbledhur edhe asamblëtë.

Meqenëse është një krizë në universitet, është ofruar një pakt për universitetin, që, në gjykimin tonë, nuk e zgjidh krizën, por e thellon. Kanë dalë disa VKM që e pezullojnë totalisht jo vetëm autonominë e universitetit, por edhe liritë akademike, por për këtë do të flasim kolegët e mi. Në këtë shqetësim dhe duke besuar se ajo që thotë qeveria, nevoja për dialog, për debat dhe për të ndryshuar ligjin ekziston dhe ne mendojmë se ekziston, ne kemi bërë këto lëvizje, të cilat janë qëndrimet e kolegëve tanë.

Të keni parasysh se nuk janë vetëm asamblëtë e Universitetit të Tiranës, por është edhe Asambleja e Gjeologji - Minierave që ka arritur në këtë konkluzion, është edhe asambleja e dy fakulteteve në Universitetin Bujqësor të Kamzës, asambleja e Fakultetit Juridik dhe e Shkencave Sociale në Universitetin e Durrësit dhe asambleja e Fakultetit Juridik në Shkodër.

Të gjitha fakultetet juridike të të gjitha universiteteve publike shqiptare kanë dalë në këto konkluzione, që janë pjesa më e mirë e ekspertizës për çështjet legislative në Republikën e Shqipërisë. Kështu që, në këtë kuptim, pedagogët janë pakicë. Nuk mund të ketë më shumë pedagogë sesa studentë apo punëtorë. Shyqyr që është kështu, sepse ky është thelbi i universitetit. Pedagogët janë pakicë dhe nuk tentojnë të bëhen shumicë. Edhe sikur 100 vjet të përpiqen, nuk mund të ketë kurrë më shumë pedagogë sesa studentë apo punëtorë. Jemi një pakicë që e shikojmë veten shumë të lidhur me universitetin ku punojmë. Pjesa më e madhe kanë bërë investime krejt individuale për të qenë pedagogë dhe profesorë të mirë.

Mendoj se universiteti publik është në prag të shkatërrimit dhe nëse vazhdohet kështu, do të ketë ditë edhe më të këqija. Problemi mund të zgjidhet përkohësisht me presione, sharje apo fushata denigruese, por kemi 4 vjet që themi që situata në universitetin publik do të përkeqësohet. Nëse situata do të vazhdojë kështu, universitetet do të shpërthejnë. E kemi thënë në mënyrë sistematike këto 4 vjet.

E përsëris, çështja e universitetit mund të zgjidhet përkohësisht me frikë apo kërcënime, por do të shpërthejë pas 1, 2, 3 apo 6 muajve, sepse ekziston një krizë shumë e madhe. Problemi është aty, nuk e mbyllim dot as me frikë, as me propagandë dhe as me konformizëm. Ne i njohim funksionet e një komisioni parlamentar, por ju bëjmë thirrje që, aq sa keni mundësi, të krijoni premisa për një ndryshim. Është pa sens që të mbahet një ligj në këmbë vetëm se mendohet ose duan të na e shesin si të mirë. Ne vetë kemi pasur hezitimet tona deri kur ligji u vu në zbatim. Nuk kemi pretenduar të kemi të vërtetën absolute, por tani që ligji i ka dhënë pasojat, nuk ka më sens të vazhdohet. Është një ligj për të cilin nuk po diskutojmë në mënyrë hipotetike nëse është i mirë apo i keq. Gjithsecili mund të ketë këndvështrimin dhe vizionin e tij për një ligj. Ligji nuk mund të jetë as yni, as i atyre që mendojnë ndryshe nga ne në universitet dhe as i burokracisë universitare.

Unë mendoj se ka ardhur koha të bëjmë një debat të madh për arsimin publik në Shqipëri. Ne nuk mendojmë se po të bënim ne ndonjë ligj për arsimin, ai do të ishte më i miri, por kërkojmë që meqenëse ekziston kjo krizë, ka një premisë debati dhe meqenëse vetë qeveria thotë që ka hapur një fushatë komunikimi nëpërmjet “Paktit për universitetin”, atëherë mendojmë që kjo situatë duhet shfrytëzuar, për të krijuar një debat kombëtar për arsimin publik në Shqipëri dhe pastaj mund të bëhen ndryshime.

E dimë që ligji nuk mund të ndryshohet për një ditë, por kemi kërkuar që të shprehet vullneti për ndryshimin e ligjit.

Na thuhet pse nuk sjellim kërkesa konkrete.

Së pari, nga universiteti ka shkuar një oponencë e plotë me mbi 1000 faqe. Këtu në komision ka kolegë që më parë kanë qenë profesorë. Ekziston ekspertiza e plotë e të gjitha grupeve akademike në Shqipëri për projektligjin. Pra, janë kërkesa konkrete, që nuk janë marrë parasysh. Ne nuk mund të bëjmë kërkesa konkrete nëse nuk thuhet konkretisht që ekziston vullneti për të ndryshuar iks çështje. Të diskutojmë, secili grup të sjellë kërkesa konkrete dhe brenda 1 jave ne jemi gati të sjellim këndvështrimin tonë për problematikën që paraqet ligji dhe alternativat për ndryshimin e tij.

Kështu që, nëse na kërkoni kërkesa konkrete, ne jemi gati t'i futemi punës, por jo kot siç u futëm herën e parë. Kemi dërguar tre herë oponencë. Dërgonim oponencë për një

draft, na vinte një draft që nuk kishte lidhje me draftin e parë dhe bënim përsëri oponencën për atë draft. Më pas drafti ndryshonte 100%. Nuk ka sens kur ofron një draft, bën oponencë dhe pastaj sjell një draft tjetër, që nuk ka lidhje me të parin. E gjithë puna dhe angazhimi i trupës akademike shkon dëm.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, zoti Marku!

Po, zoti Shegani.

Dua të përqendrohemi pak edhe te pjesa e VKM-ve të fundit.

**Altin Shegani** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, të nderuar kolegë!

Unë jam Altin Shegani, pedagog në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, anëtar i Departamentit të së Drejtës Penale.

Jam këtu me statusin që kolegu Marku përcaktoi qartë. Do të përpiqem që në kufijtë e një kohe të arsyeshme të paraqes vizionin e kolegëve të Departamentit të së Drejtës Civile dhe shumicës së pedagogëve të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës për projektligjin “Për Kodin e Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor” dhe VKM- të e fundit të miratuara në fushën e arsimit të lartë, të cilat kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit të arsimit të lartë.

Projektligji “Për Kodin e Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” i është referuar një pjese të Kodit European të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, botuar nga ALLEA, Federata Europiane e Akademive të Shkencave dhe Studimeve Humane, të cilin Akademia e Shkencave të Shqipërisë e ka miratuar prej vitit 2017. Përveç faktit se Kodi është i një natyre juridike *soft law*, pra, nuk përmban norma juridike dhe nuk është i detyrueshëm, projekti i servirur ka ndërhyrje, të cilat jo vetëm që kanë ndryshuar në thelb kodin në fjalë, por janë të papajtueshme me veprimtarinë dhe funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe punës shkencore.

Në përputhje me lirinë akademike dhe autonominë e institucioneve të arsimit të lartë, të garantuara nga neni 57, pika 7, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 3, i ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, referuar si LALKSH, normat e sjelljes, etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor nuk mund të rregullohen me ligj nga Kuvendi, por duhet të rregullohen nga vetë IAL-të, sipas përcaktimeve në statut dhe në aktet e tjera të tyre. Kjo rrjedh edhe nga fryma e ligjit, ku në momente të caktuara ligji thotë që IAL-të duhet të konceptojnë dokumentet e tyre ligjore, aktet e tyre drejtuese. Vetë neni 2 i këtij projektligji është

kontradiktor, sepse nga njëra anë pranon natyrën vetërregulluese të normave të sjelljes në integritetin e kërkimit shkencor, kurse nga ana tjetër këto norma sjelljeje ua imponon nga jashtë institucioneve të arsimit të lartë. Për më tepër, ky projektligj bart problematika të shumta, të cilat cenojnë rëndë autonominë e institucioneve të arsimit të lartë, në shkelje të hapur të Kushtetutës dhe të ligjit të arsimit të lartë si më poshtë:

1. Zbatimi në kohë i ligjit. Neni 3 i projektligjit duhet të përcaktojë qartësisht zbatimin në kohë të ligjit. Në respekt të parimit të sigurisë juridike ligjet dhe aktet nënligjore nuk mund të kenë fuqi prapavepruese, përveçse kur ofrojnë një regjim më lehtësues dhe favorizues.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka theksuar disa herë se parimi i përgjithshëm që vepron në sistemin e së drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Ky parim nuk është reflektuar në aktet në fjalë.

2. Organet e verifikimit dhe shqyrtimit të shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor. Neni 22, paragrafi 2 i projektligjit, është konceptuar në shkelje të hapur të autonomisë së institucionit të arsimit të lartë. Ai bie ndesh me nenin 44 të ligjit dhe nenin 43 të Statutit të Universitetit të Tiranës. Sipas dispozitave në fjalë, është Këshilli i Etikës që ngrihet pranë IAL-ve organi që promovon dhe shqyrton çështjet që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Zoti Shegani, faleminderit që jeni sot këtu! Në mënyrë që komisioni të administrojë më mirë kohën, doja të ndaja me të gjithë faktin që ky projektligj është tërhequr.

Kështu që, oponenca që ju po bëni është e parakohshme, para se të shikoni draftin final të projektligjit. Mund të na e kurseni kohën në këtë drejtim.

Faleminderit!

**Altin Shegani** – Unë isha i ngarkuar të paraqisja një gjë të tillë.

**Albana Vokshi** – Kur është tërhequr, sepse ne nuk dimë gjë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E dini ju, por jo ne. Nuk e keni bërë publike tërheqjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, nuk ka ardhur te ne, por drafti është prezantuar. Ata po flasin për një draft që është prezantuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, Nora. Më pas Luçiano.



Do t'jua jap përsëri fjalën, zoti Shegani.

**Nora Malaj** – Për ta qartësuar dhe kuptuar atë që zoti Shegani po na sjell, sqaroj se ky draft nuk ka ardhur në komisione, por ka shkuar në universitete, ku po diskutohet paralelisht për të marrë mendime prej tyre. Ka ardhur në një kohë kur është shumë i rëndësishëm për t'u diskutuar, sepse kemi dy momente: momentin e ligjit që nuk funksionon dhe momentin e një ligji tjetër që shkon si projekt për të marrë mendime. Kolegët e kanë shqetësimin që ato mendime që ata do të japin, të paktën të rimerren në konsideratë, që të mos ndodhë e njëjta histori.

**Luçiano Boçi** – Mendoj se çështja e kohës duhet të mos na e kufizojë dëgjuesin me pedagogët, pasi e kanë kërkuar ata dëgjuesin dhe e menaxhojnë ata kohën. Ne jemi dëgjues, që në fund do të japim mendimet tona. Se si i parashtrojnë argumentet apo mendimet për një grup ligjesh, VKM-sh apo për shembuj të tjerë, është e drejta e tyre. Të mos intimidohemi fare, por t'i dëgjojmë me vëmendje deri në fund. Nëse ne kemi qendrim të tjera, kemi kohën në dispozicion për t'i shprehur ato. Nuk ka pse të pengohet paraqitja e shqetësimeve të pedagogëve nga vetë ata.

**Albana Vokshi** - Është pjesë e ligjit të arsimit të lartë.

**Mark Marku** – Ndërkohë që u bë ky debat, kolegu im do ta kishte mbaruar prezantimin.

**Albana Vokshi** – Unë e kam për detyrë t'i jap fjalën për procedurë çdo deputeti që e kërkon.

Zoti Shegani, mund ta vazhdoni fjalën. Unë e konsideroj gjë të mirë që qeveria e ka kuptuar sa i keq ishte drafti që ju ka sjell. Nëse është tërhequr, ju mund të vazhdoni përsëri të ngrini shqetësimet ose të kaloni direkt te VKM-të.

**Altin Shegani** – Dakord. Faleminderit për vëmendjen! Do të përpiqem të jem sa më konciz.

Po kaloj te VKM-të.

**Albana Vokshi** – Kam kërkesë nga disa deputetë që të vazhdoni të shteroni argumentet tuaja, sepse duam të njihemi edhe ne me draftin që ju ka ardhur dhe me shqetësimet tuaja.

**Altin Shegani** – Dakord.

**Albana Vokshi** – U ka shkuar universiteteve potencialisht dhe fizikisht. Ato janë ulur me seriozitetin më të madh, kanë studiuar dhe kanë bërë oponencën.

**Altin Shegani** – Neni 22, paragrafi 2 i projektligjit, është në shkelje të hapur të autonomisë së institucionit të arsimit të lartë. Ai bie ndesh me nenin 44 të ligjit të arsimit të

lartë dhe nenin 43 të Statutit të Universitetit të Tiranës. Sipas dispozitave në fjalë, është Këshilli i Etikës që ngrihet pranë institucionit të arsimit të lartë, organi që promovon dhe shqyrton çështjet që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor. Vendimet e Këshillit të Etikës, procedura e ndjekur për shqyrtimin e ankesave dhe sanksionet përkatëse, nuk mund të rregullohen nga ky projektligj, por rregullohen nga Rregullorja e hartuar nga Këshilli i Etikës dhe e miratuar nga senati i institucionit të arsimit të lartë.

Në të njëjtën linjë të cenimit të autonomisë, neni 23 i këtij projektligji, në shkelje të hapur me ligjin e arsimit të lartë, krijon një organ të ri, Kolegjin e Etikës, pranë Akademisë së Shkencave, duke i dhënë kompetenca rishikuese ndaj vendimeve të marra nga Këshilli i Etikës, si dhe kompetencën për të filluar kryesisht verifikimin për shkeljet e integritetit në kërkimin shkencor. Me këtë të fundit, këtij organi i janë dhënë kompetencat që ligji për arsimin e lartë, neni 44, i jep këshillit të etikës dhe senatit të IAL-ve. Përbërja e këtij kolegjii me anëtarë të zgjedhur nga Akademia e Shkencave, MASH-i dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, cenon lirinë akademike të komunitetit të kërkimit shkencor.

Sipas parimeve të vendosura nga Kodi Europian i Etikës, kërkimi shkencor duhet të zhvillohet në mënyrë të pavarur nga presioni i organizmave politike ose nga interesat ideologjike-ekonomike dhe shoqërore.

Sanksionet, sikurse parimet e integritetit në kërkimin shkencor dhe sanksionet për shkeljet e tyre, duhet të përcaktohen në aktet e brendshme të IAL-ve, aty ku zhvillohet kërkimi shkencor dhe jo në ligj. Për më shumë, nuk është në kompetencat e këshillit të etikës marrja e masave disiplinore të ndërprerjes së kontratës së punës dhe heqjes së gradës shkencore ose të titullit akademik, sikurse përcaktohet në nenet 30 dhe 31 të projektligjit. Marrja e masave disiplinore dhe largimi nga detyra për personelin akademik, bëhet në përputhje me nenet e ligjit nr. 68 për arsimin e lartë, pika 2, e cila përcakton se largimi nga detyra i personelit akademik të IAL-së bëhet nga rektori i institucionit, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe pas miratimit të komisionit *ad-hoc*, të ngritur nga Senati Akademik dhe është kompetencë e IAL-së që i ka dhënë ato.

Zbatimi i sanksioneve kërkon që udhëheqësve, oponentëve dhe vetë kërkuesve shkencorë t'u jenë ofruar të gjitha mekanizmat e nevojshme për verifikimin paraprak të punës kërkimore-shkencore për shmangien e shkeljeve të mundshme të etikës në integritetin e kërkimit shkencor. Kjo përfshin përdorimin e *software*-ve përkatëse dhe jo hamendësimet e personave të ndryshëm.

Përgjegjësia për plagjiaturë është individuale. Nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi solidarë edhe udhëheqësi shkencor, për sa kohë ai e ka ndërgjegjësuar studentin, doktorantin,

madje studenti nënshkruan një deklaratë para procesit të mbrojtjes, ku deklaron se punimi është individual, origjinal i tij. Në këtë mënyrë ai bëhet i ndërgjegjshëm mbi rrezikun e falsifikimit dhe plagjiaturës, si dhe nuk i janë ofruar mekanizmat e nevojshme për diktimin e plagjiaturës dhe të shkeljeve të tjera.

Rregullorja për organizimin e programeve të studimit të doktoraturave, e miratuar në senatin Akademik të UT-së me vendimin nr. 20, datë 13 nëntor 2008, sqaron qartë detyrat e udhëheqësit shkencor. Veçanërisht pika 7.3 e kësaj rregulloreje sqaron se udhëheqësi ka përgjegjësi të vetëdijeshme studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës. Bazuar në gjetjet e mësipërme, kërkojmë tërheqjen, gjë që ne e kemi bërë dhe këtu përfundon pjesa e këtij drafti, vendime të tjera lidhur me oponencën e VKM-së nr. 777 datë 26.12.2018 “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”. Kjo VKM është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në shkelje me parashikimet e bëra nga Kushtetuta dhe nga ligji për arsimin e lartë.

Fillimisht, sqarojmë se bazuar në nenin 7 të ligjit për arsimin e lartë, nuk është kompetencë e MASH-it të mbajë kopje të njësuara me origjinalin e disertacioneve, si dhe të bëjë kontrollin digjital, antiplagjiaturë të tyre. MASH-i administron vetëm regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe të titujve akademikë.

Gjithashtu, edhe AKSH-i, si institucion publik në varësi të MASH-it, sipas nenit 13 të këtij ligji, vetëm administron dhe përditëson listën e disertacioneve të doktoraturave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian.

E drejta e kontrollit antiplagjiaturë nëpërmjet *software*-ve për kontrollin automatik u takon IAL-ve, që kanë lëshuar gradat shkencore përkatëse. Për këtë qëllim rekomandojmë që MASH-i të mund të na ndihmojë, duke ndërmarrë masat e nevojshme për të mundësuar blerjen e *software*-ve të kontrollit automatik të plagjiaturës. Kjo *software* do t'i shërbente të gjithë komunitetit të kërkimit shkencor për kontrollin dhe për kontrollin paraprak të disertacioneve dhe të produkteve të tjera të kërkimit shkencor. Theksojmë se deri tani nuk ka ekzistuar një mekanizëm i tillë kontrolli, për shkak të kostove realisht të larta që ai ka.

Gjithashtu, deri tani nuk kanë ekzistuar rregulla sjelljeje, që normojnë në mënyrë specifike etikën në kërkimin shkencor dhe në këtë kuadër të japin një përkufizim të mirëpërcaktuar të konceptit të plagjiaturës. Për këto arsye rivlerësimi i disertacioneve të mbrojtura duhet të kryhet, duke pasur parasysh kuadrin ligjor rregullues dhe rregullat e etikës së kërkimit shkencor, që kanë qenë në fuqi në kohën kur është mbrojtur ky disertacion.

Për rrjedhojë, rivlerësimi *a posteriori* i gradave shkencore të mbrojtura sipas standardeve të kërkimit shkencor, që nuk kanë qenë të parashikuara në aktet e IAL-ve në fuqi

në kohën e mbrojtjes së disertacionit, është antikushtetues, pasi prek parimin e sigurisë juridike, e cila është një ndër elementet thelbësore të funksionimit të shtetit të së drejtës. Në kuptim të këtij parimi, rregullimet ligjore, që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve, duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme dhe si rregull nuk mund të mohohen interesat dhe pritshmëritë e ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion. Shteti duhet të synojë, të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë, vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive. Sipas jurisprudencës së GJK-së siguria juridike nënkupton, veç të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe të aktet që ato nxjerrin, dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht apo të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private apo profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me aktet e mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve, duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme, që siguron vijimësinë e tyre.

Për të kuptuar dhe për të zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte dhe në përputhje me të.

Nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik, nëse duhet t'i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme, që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë reforma në sistemin e arsimit të lartë.

Në të njëjtën linjë, edhe vendimi unifikues i kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 6.12.2013, afirmon se parimi i gjykatës së caktuar me ligj i të drejtës së ankimit, si dhe i sigurisë juridike janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën. Si element i sigurisë juridike, mbrojtja e pritshmërive të ligjshme nga rendi juridik ka të bëjë me të drejtën që kanë personat fizikë dhe juridikë për të gëzuar pasojat e pritshme të rendit juridik në fuqi, në kohën kur ata ushtrojnë të drejtat e tyre të ligjshme. Për më shumë, kur këtyre pasojave u vinë pasoja të pafavorshme nga ndryshimi i legjislacionit, ky i fundit nuk mund të veprojë me efekt prapaveprues.

Parimi i përgjithshëm është se masat me efekte të pafavorshme dhe njëkohësisht prapavepruese, janë të ndaluara. Përjashtimet mund të parashikohen vetëm në rastet kur synohet të mbrohen interesat publike më të larta dhe në rastet e përcaktuara qartë nga ligjvënësi.

Për sa i takon VKM-së nr. 783, datë 26.12.2018 “Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, edhe nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve”, kjo VKM është e paligjshme dhe e panevojshme. Ajo është në kundërshtim të hapur me nenet 14,104 dhe 105 të ligjit për arsimin e lartë, të cilat përcaktojnë kompetencat e ASCAL-it. Theksojmë se vlerësimi i performancës në mësimdhënie të personelit akademik, nuk është kompetencë e ASCAL-it. Ai monitoron dhe vlerëson periodikisht cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara. Edhe lidhur me mësimdhënien, janë IAL-të ato që i nënshtrohen vlerësimit nga ASCAL-i dhe jo çdo pedagog i IAL-ve.

Megjithatë, sipas nenit 104, pika 6 të ligjit për arsimin e lartë, vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet në përputhje me Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Sipas nenit 105 të këtij kodi, ky kod është dokumenti kryesor për të gjitha proceset dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ai përcakton standardet shtetërore të cilësisë, të detyrueshme për zbatim prej IAL-ve. Kodi i Cilësisë për Arsimin e Lartë hartohet nga ASCAL-i dhe nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe miratohet me VKM.

Ju bëj me dije, se ky kod është miratuar me VKM-në nr. 531, datë 11.09.2018.

Për sa më sipër, VKM-ja në fjalë duke i dhënë ASCAL-it kompetenca, që nuk i gëzon me ligj, cenon autonominë e arsimit të lartë. Ajo, gjithashtu, rregullon çështje që rregullohen tashmë në bazë të Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë dhe, për rrjedhojë, të gjithë kolegët kanë menduar që ajo duhet të shfuqizohet.

Për sa i takon VKM-së për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë, në VKM-në në fjalë, ndër të tjera përcaktohet se portali duhet të jetë i aksesueshëm nga të gjithë dhe në të të publikohen *online* rezultatet e kontrollit, dhe të verifikimit të titujve shkencorë, mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe paraqitjen e ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e drejtuesve/ organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, procedurën, nëpërmjet së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të institucionit të arsimit të lartë.

“Për trajtimin e ankesave në platformën e transparencës *online*, kontrollin e transparencës dhe pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë krijohet struktura përgjegjëse për kontrollin e transparencës së arsimit të lartë”.

Këto përcaktime janë në kundërshtim me parimin e autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, sepse ndërhyjnë në fuqinë dhe pushtetin e tyre për të marrë vendime në mënyrë të lirë dhe të pavarur për çështjet e transparencës.

Sikurse është shprehur Gjykata Kushtetuese, parimi i autonomisë, në vështtrimin historik, filloi të formësohej kur u krijuan universitetet, si entitete të shkencës dhe të studimit, dhe kur lindi nevoja e autonomisë së tyre, që synoi të siguronte pavarësinë e universiteteve nga shteti. Qëllimi i kësaj autonomie ishte ruajtja e lirisë së shkencës, kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, si dhe mbrojtja e studiuesve, profesorëve nga influencat politike e të tjerë, nisur nga ideja se shkenca dhe mësimdhënia normalisht mund të ekzistojnë dhe të sjellin progres vetëm kur janë të lira dhe të pavarura.

Parimi i autonomisë universitare është i lidhur ngushtë edhe me parimin e lirisë akademike, i cili është shprehje e projekteve për të mbrojtur lirinë e mendimit shkencor, të personave që merren me kërkim dhe mësimdhënie.

Autonomia universitare është një formë institucionale e lirisë akademike dhe një parakusht për të garantuar përmbushjen e duhur të funksioneve që i janë besuar personelit mësimdhënies dhe institucioneve të arsimit të lartë.

Autonomia universitare është thelbi i vetëqeverisjes dhe e nevojshme për vendimmarrjen efektive të institucioneve të arsimit të lartë, në përmbushjen e detyrave akademike dhe arsimore.

Parimi i autonomisë universitare kërkon nga universitetet që të jenë subjekte të përgjegjshme dhe transparente në marrjen e vendimeve të tyre dhe në shpenzimet e fondeve. Kjo realizohet nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së universiteteve nga organizma të ngarkuar për këtë qëllim, por kjo mbikëqyrje duhet të kryhet pa cenuar parimin e autonomisë universitare.

Respektimi i parimit të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, të sanksionuar në pikën 7, të nenit 57, të Kushtetutës, kërkon që ligji të krijojë dimensione të tilla, që institucionet e arsimit të lartë të pajisen me pushtet të mjaftueshëm për të marrë vendime në mënyrë të lirë dhe të pavarur. Vetëqeverisja, kolegjaliteti dhe drejtimi i përshtatshëm akademik janë elemente thelbësore të autonomisë së vërtetë në institucionet e arsimit të lartë.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Shumë faleminderit, zoti Shegani, për sqarimin shterues të oponencës për VKM-në e fundit!

Nëse ju keni mundësi, na jepni edhe ne një kopje, pasi besoj se janë shumë të dobishme për të gjithë anëtarët e komisionit.

Pa humbur kohë, po ia kaloj fjalën zotit Marka.

Ju lutem, pak më konciz!

**Jani Marka** – Do të flas shkurtimisht.

**Albana Vokshi** – Ju falënderoj nëse do të mundoheni ta përmbledhni fjalën tuaj në 5-7 minuta.

**Jani Marka** – E nderuar zonja kryetare, faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Unë quhem Jani Marka, jam pedagog në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, por edhe pjesë e kolegëve dhe studentëve të lëvizjes “Për universitetin”.

Ne kemi qenë në këtë komision edhe në qershor të vitit 2015 dhe që atë herë ju thamë se ky ligj do të shfaqë disa problematika që, në fakt, u bënë realitet.

Unë do të mbetem te ligji, ndoshta do të mbivendosem pak me profesor Markun, por për këto jam përgatitur. Ndërkohë, kam dëgjuar ministren e Arsimit, zonjën Shahini, e cila u shpreh se ligji i arsimit nuk është shkruar në gur. Në këtë kuptim, prezenca ime këtu nënkupton që ndoshta mund të gjejmë vullnetin e deputetëve, kryesisht të maxhorancës, për ta rishikuar ligjin si fillim.

Arsimi është një e drejtë e mbështetur në bazë të meritës dhe jo aftësisë për të paguar. Arsimi është e mirë publike dhe jo mall tregu. Studenti, me ligjin e ri, po kthehet në klient, diploma në mall dhe ky raport klientelizmi, shoqëruar me pasigurinë financiare, ku janë vendosur universitetet publike, cenon në themel cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në universitetet publike.

Studentët kanë të drejtë të kenë akses në arsimin e lartë dhe të marrin dije me cilësi të lartë, ndërsa ne, si trupë pedagogjike, kemi të drejtën e autonomisë dhe lirisë akademike për të zhvilluar bashkë me studentët dijen dhe institucionin.

Ndoshta edhe unë ose ne mund të kemi të drejtën të shtojmë ndonjë pyetje për ju, paraprakisht.

Të nderuar deputetë, nuk e di a keni shqyrtuar ju ndonjëherë ndonjë raport për tarifat e studimit në Shqipëri, krahasuar me vendet europiane dhe, mbi të gjitha, me nivelin e jetesës dhe të të ardhurave, ndaj shtroj pyetjet: a jeni ju në dijeni, besoj se po, që buxheti i shtetit për arsimin e lartë është rreth 0,5% e prodhimit të brendshëm bruto, ndërkohë që vetë maxhoranca, në një material të viteve më parë, është zotuar se do ta çonte 1% në harkun e pak viteve? A jeni ju në dijeni se shteti shqiptar nuk financon për kërkimin shkencor? A jeni ju në dijeni se universitetet tona, për fat të keq, janë të renditura në fund në krahasim edhe me vendet e rajonit?

Këto janë disa nga pyetjet që kam për ju.

Më tej, ne, studentë dhe pedagogë, nuk jemi një grup interesi periferik, por jemi ata që e jetojmë dhe e bëjmë universitetin, prandaj kemi kërkuar dhe kjo kërkesë ka ardhur gjithnjë në rritje. Vazhdimisht, me kalimin e viteve, ne kemi kërkuar një ligj të ri të arsimit të lartë, por natyrisht jemi të vetëdijshëm se ky ligj nuk mund të bëhet për dy javë. Nëse ju shfaqni vullnetin politik për një ligj të ri, natyrisht do të kërkojë kohën e nevojshme: një ose dy vjet, me përfshirjen e studentëve, të pedagogëve e, natyrisht, të institucioneve, siç jeni edhe ju apo Ministria e Arsimit, Ministria e Financave e kështu me radhë. Në këtë moment do të thosha se ju do t'i bënit një shërbim shumë të madh dijes dhe universitetit, nëse e pranoni që ky ligj ka dështuar dhe shfaqni vullnetin për një ligj të ri, ndërkohë që në terma afatshkurtër mund të bëni disa korrektive ose amendime të ligjit aktual.

Do të përmend shumë shkurt këtu disa prej tyre.

Së pari, kërkojmë anulimin tërësor të kreut XII, pasi këtë kapitull nuk e ka kërkuar asnjë nga universitetet publike, por ka edhe nene të tjera të veçanta, siç është neni 107 ose neni 7, që kanë të bëjnë me konkurrencën e institucioneve publike njëra me tjetrën ose me falimentimin e institucioneve publike të arsimit të lartë.

Gjithashtu, ka nene të tjera, si nenet 112 dhe 113, që kanë të bëjnë me financimin e universiteteve private me fonde publike; neni 48, që ka të bëjë me bordin, si dhe nenet 37, 39 dhe 42, që kanë të bëjnë me votën studentore, pse jo, edhe neni 114, si simbolikë, që ka të bëjë me kreditë studentore.

Për të gjitha këto sa përmenda mund të zgjatet edhe 3-4 minuta të tjera, ndoshta më shkurt, për herë të parë, ky ligj e formalizon gjendjen e pasigurisë financiare të universiteteve. Këtu ka profesorë që kanë qenë në Universitetin e Tiranës dhe kjo çështje është ngritur shpesh. Besoj se ju jeni në dijeni që të paktën Universiteti i Tiranës ndryshon nga viti në vit, por buxheti i shtetit mbulon vetëm nëntë paga pedagogësh, çdo gjë tjetër vjen nga tarifat e studentëve: tri pagat e mbetura, orët suplementare që ne zhvillojmë dhe çdolloj investimi, pagesa e faturave. Kjo pasiguri thellohet edhe më shumë në ligj kur këto fonde kaq të pamjaftueshme të buxhetit të shtetit në universitete tashmë, nëpërmjet ligjit, mund të shkojnë edhe drejt universiteteve private aktuale, që janë fitimprurëse nëpërmjet dy granteve, grantit për studentët ekselentë dhe atij të kërkimit shkencor.

Tjetër pyetje, që lidhet me nenin 107, që ka të bëjë me konkurrencën e universiteteve publike, njëra me tjetrën, është: çfarë do të thotë konkurrencë? Do të thotë konkurrencë për fonde. Nëse e kuptojmë drejt këtë vizion, do të thotë se universitetet publike do të konkurrojnë për fonde të pakta të buxhetit të shtetit dhe universitetet më të mira ndërmjet tyre do të marrin gjithnjë e më shumë fonde, ndërsa ato që janë më të dobëtat do të marrin gjithnjë e më pak



fonde, duke shkuar drejt degradimit të tyre, drejt falimentimit ose mbylljes së institucioneve publike.

Ne shtrojmë pyetjen: a mund të mbyllet, ku ta di unë, policia ose një spital? Natyrisht që jo. Arsimi është një e mirë publike dhe shteti duhet të marrë përgjegjësi për të. Pra, nuk duhet parë mbyllja si zgjidhja e fundit, por financimi i tij dhe gjetja e rrugëve të tjera për ta kthyer në cilësi.

Kam disa vërejtje edhe për kreun XII, por nuk po zgjatem më, se e përmenda më herët.

Për sa i përket edhe një herë financimit të universiteteve private me fonde publike, zonja ish-ministre mund të thotë: “kjo nuk ka ndodhur”, por është e shkruar në ligj që universitetet private përfitojnë nëpërmjet dy zërave, studentët ekselentë, nëpërmjet grantit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore.

Ndoshta nuk do të kishte asgjë të keqe që kërkues nga universitetet private të financoheshin për kërkimin e tyre shkencor, por në ligj nuk thuhet që kërkuesi shkencor financohet direkt, por financohet universiteti privat. Kështu që, edhe kjo mund të ishte një pikë, që në terma afatshkurtër ju mund ta ndryshonit.

Vijmë te një pikë tjetër, që është autonomia dhe demokracia, që ka dalë edhe nga kërkesat e studentëve. Në ligjin e vjetër studentët kanë pasur një peshë vote 20%, ndërsa ju në draftin paraprak, që e kemi ndjekur, e bëtë 0%. Falë presionit të studentëve, e çuat në 10%, ndërkohë studentët sot kërkojnë një të drejtë më të madhe të votës dhe kjo për disa arsye, si: për ta bërë mjedisin universitar më demokratik, për të luftuar kastat në universitete...

Siç është e vërteta dhe të gjithë jemi në dijeni, edhe ju e ndryshuat ligjin, me sa di unë, në minutin e fundit për çështjen e mandateve, ku nga një mandat, e bëtë me dy mandate. Ndërkohë, në ligj ju nuk keni gjetur një mekanizëm se si mund të shkarkohet një rektor, një dekan, përveçse nga Ministria e Arsimit dhe Presidenti. Universiteti nuk është një trupë shumë e madhe. Duhet të funksionojë në bazë të kolegjalitetit dhe në qoftë se një rektor apo dekan kryen një shkelje, edhe vetë trupa universitare mund të kërkojë shkarkimin e tij, natyrisht me një shumicë votash, por mund të parashikohet që nëse një e treta e trupës akademike kërkon diçka të tillë, mund të shkohet në këtë drejtim.

Për sa i përket bordit, aspekt që lidhet me autonominë financiare, i vetmi nga shtatë anëtarët që ka bordi, që ka shumicë, është Universiteti i Tiranës, dhe kjo vjen vetëm falë faktit që ne kemi shumë tarifa. Në të gjitha universitetet e tjera bordin e kontrollojnë universitetet.

Me këtë shembull që ju dhashë, e vetmja mënyrë që universiteti të jetë autonom dhe të kontrollojë bordin është që të sigurojë mbi 50% të të ardhurave.

Fatkeqësisht, Shqipëria nuk është një vend elitar për të prodhuar shkencë dhe patenta, siç dëgjojmë shpesh oponentët, madje mundësia e vetme për të siguruar të ardhura ose mundësia më e madhe është nëpërmjet tarifave.

Meqenëse u kërkua nga kryetarja, kam edhe dy komente për “Paktin për universitetin” dhe po e mbyll. Për mendimin tim, që kam qenë në protestë, protesta kishte dy aspekte: aksesin në arsimin e lartë dhe cilësinë e tij.

Për sa i përket aksesit, meqenëse kam qenë vazhdimisht pranë studentëve, si të gjithë, mund të them që nëpërmjet “Paktit” qeveria nuk e ka prekur aksesin, por u ka dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në terma afatgjatë, si: rregullimi i Qytetit Studenti apo karta e studentit, për të cilat jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se do të marrin jashtëzakonisht kohë.

Ndërkohë, studentët, madje edhe ditën kur u diskutua pakti, se e kam ndjekur, ia thashë edhe ministres në zyrë, katër-pesë studentë, të cilët i bënë pyetje zonjës ministre kur prezantoi paktin, i mëshonin çështjes së tarifave dhe bursave. Pra, e drejta për arsim është e drejtë themelore. Pakti nuk jep zgjidhje dhe, ç’është më e keqja, edhe në ligj, por edhe sot, vazhdon retorika që masterin e quan privilegj. Tani, në cilin vend normal, edhe me procesin e Bolonjës, masteri na qenka privilegj?! Ku do të punojnë studentët pa master?

Prandaj, në mënyrë urgjente, që pakti të quhej i suksesshëm, duhej që qeveria të ulte, gjithashtu, tarifat e masterit, gjë që nuk e ka bërë.

Kaq kisha.

Faleminderit për vëmendjen!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Para se t’jua kaloj fjalën, në fakt, dua të bëj një njoftim për komisionin.

Me kërkesën e tetë deputetëve të opozitës, ditën e premte, kemi kërkuar një seancë urgjente dëgjimore me dy ministrat, ministrin e Brendshëm dhe ministren e Arsimit. E patëm për sot, në orën 12:00, pra tani ne duhet të kishim nisur një seancë tjetër dëgjimore me dy ministrat për ngjarjen tjetër të rëndë, që ndodhi para tri ditësh në ambientet e Fakultetit të Filologjisë dhe të nesërmen e dëgjesës, e cila zgjati shumë orë, për incidentin tjetër me policinë brenda ambienteve universitare, sepse policia përsëri, në shkelje të ligjit, u fut brenda ambienteve.

Pra, ne, duke e konsideruar si një tjetër ngjarje të rëndë, bëmë një kërkesë nga të gjithë deputetët e opozitës që të dy ministrat të paraqiteshin në komision sot në orën 12:00.

Nuk dua të merrem me faktin se u dërgua në protokoll që në mëngjes dhe në orën 4 të pasdites, qëllimisht, nuk u dërgua zyrtarisht. Pra, mund t’ju siguroj që hapësirat e opozitës

vazhdojnë të cenohen në çdo hap brenda kësaj godine, por sapo ka mbërritur edhe një përgjigje nga ministri i Brendshëm, i cili refuzon të paraqitet në komision.

Ndërkohë, dua gjithashtu t'ju njoftoj se ministrja e Arsimit, për të disatën herë, e shpërfill, e injoron krejtësisht kërkesën e komisionit. Pra, nga ministrja e Arsimit nuk kemi as edhe një përgjigje, duke vënë në dukje që nga ministrja e Arsimit nuk ka as edhe një deklaratë në lidhje me ngjarjen e parë të rëndë të policisë, as edhe një deklaratë për ngjarjen e ndodhur ditën e enjte brenda ambienteve të Filologjikut, por nuk kemi as edhe një përgjigje.

Kështu, dua t'i referohem pikës 3 të nenit 80 të Kushtetutës, i cili i detyron ministrat, pra anëtarët e kabinetit, që të paraqiten pranë komisioneve parlamentare për të dhënë informacione, për të raportuar për ngjarje të ndryshme, për procese legislative, pra për çdo shqetësim në lidhje me to nga ana e deputetëve të këtij komisioni.

Ky komision nuk përbëhet vetëm nga deputetët e PD-së, nuk përbëhet vetëm nga deputetët e LSI-së, pra jo vetëm nga deputetë të opozitës, por kemi edhe deputetë të maxhorancës. Domethënë, është detyrim kushtetues dhe ligjor i ministrave, që të vijnë në çdo kohë për të raportuar para këtij komisioni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk kam mbaruar ende. Ne duhet të kishim nisur dëgjuesën e dytë për kërkesën e deputetëve të opozitës dhe për refuzimin për të disatën herë nga ana e ministrave.

Neni 7 i Kushtetutës e ka fare të qartë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Me qetësi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Është për procedurë, sepse në orën 12:00 kishim dëgjuesë dhe opinionin e mediet ishin të përgatitur që në orën 12:00 të paraqiteshin dy ministrat për të raportuar para këtij komisioni për një ngjarje të rëndë që ka ndodhur në mëngjes, ditën e enjte, brenda ambienteve universitare, ku përsëri policia ka hyrë në shkelje flagrante të ligjit dhe të Kushtetutës. Mua dhe të gjithë deputetëve të opozitës na ka shqetësuar shumë ky fakt dhe, për më tepër, që është bërë një ditë pas dëgjuesës në komision, ku ne i kemi argumentuar ministrit se është shkelje ligjore futja e policisë brenda ambienteve universitare. Pra, kjo është një sfidë e hapur me ligjin dhe me parlamentin që bëhet nga ministri i Brendshëm, duke shkelur për herë të dytë ligjin dhe Kushtetutën. Detyrimi i tyre është i bazuar bazuar në nenin 7 të Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ku nën dritën e këtij parimi merr përparësi funksioni i kontrollit parlamentar, i cili nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar në çdo kohë në lidhje me zbatimin, nga ana e organeve të pushtetit publik, të ligjeve.

E përmenda nenin 80 të Kushtetutës dhe nenet 36 e 102 të Rregullores, ku ministrat e kanë detyrim për t'u paraqitur në komision sa herë që deputetët e kërkojnë. Përdërisa është e disataherë që ata e refuzojnë, unë mund t'ju vë në dispozicion të gjitha shkresat e nisura nga ne, të cilat janë refuzuar nga ana e ministrave, që, mesa duket, mendojnë se janë ministra privatë të Edi Ramës dhe jo ministra të qeverisë, nuk e ndiejnë se duhet të raportojnë edhe para parlamentit, por mendojnë se duhet të raportojnë vetëm para Kryeministrit, sepse, në fakt, ata nuk përfaqësojnë asnjë qytetar, nuk janë votuar dhe nuk e ndiejnë të drejtën për të raportuar para këtij komisioni. Ne jemi përfaqësuesit e sovranit dhe të interesave të qytetarëve. Pra, injorimi i kësaj të drejte të opozitës dhe këtij detyrimi kushtetues përbën një akt injorimi ndaj autoritetit të Kuvendit. Si i tillë është thellësisht antikushtetues dhe duhet të sjellë përgjegjësi politike dhe disiplinore ndaj të dy ministrave.

Dua t'i kërkoj edhe një herë Kryeministrit që t'u tërheq vëmendjen ministrave dhe t'u shpjegojë atyre detyrimin kushtetues që të paraqiten në çdo orë që kërkohen nga deputetët e komisionin për të raportuar për shqetësimet e ndryshme.

I kërkoj Kryetarit të Kuvendit, zotit Gramoz Ruçi, të sigurojë mbarëvajtjen e punimeve të komisionit dhe ministrat të paraqiten. Është brenda përgjegjësisë dhe funksioneve të tij si Kryetar Kuvendi, për të siguruar që raportimi në komisionet parlamentare të bëhet në bazë të Rregullores dhe Kushtetutës. Është e disata herë brenda dy javëve që ndodh kjo. Ndaj, ju kërkoj edhe juve, deputetë të maxhorancës, të reagoni ndaj këtij akti thellësisht antikushtetues dhe injorimit të komisionit parlamentar. Është akt shumë i rëndë ai që ka ndodhur të enjten dhe kërkojmë, në rastin më të parë të mundshëm, prezencën e të dy ministrave. Në ditët në vijim ne do të thërrasim në dëgjuesë të dy ministrat, sepse është një çështje që duhet ta trajtojmë dhe do ta trajtojmë. Nëse ju jeni dakord, bëjmë një kërkesë nga komisioni, por, nëse nuk jeni, ne marrim përsëri firmat e deputetëve të opozitës, por ky puç antikushtetues që po ndodh në universitete duhet të marrë fund një herë e mirë.

**Milva Ekonomi** – Për procedurë.

Së pari, kemi një rend dite që ka të parashikuar një çështje...

**Albana Vokshi** – Rendi i ditës ka dy çështje, lexojeni mirë!

**Milva Ekonomi** – Çështja e parë është që kemi thirrur një asamble...

**Albana Vokshi** – Duhet të jemi të saktë, sepse po na ndjekin...

**Milva Ekonomi** – Nuk ju ndërpreva në asnjë moment, kështu që më lejo të mbaroj fjalën dhe mos më ndërhy!

Kemi një rend dite, që ka një çështje, e cila ka të bëjë me dëgjuesën e asamblesë së universitetit, për të cilën, edhe pse nuk ka ndodhur i gjithë procesi i zgjedhjes së këtyre

pedagogëve të nderuar që janë këtu, ashtu siç e kërkon ligji apo statusi i universitetit të Tiranës, maxhoranca pranoi që kërkesa e tyre publike për dëgjuesë të ishte e realizueshme. Kështu që, pika e parë...

**Albana Vokshi** – Kush i ka kontrolluar zgjedhjet e tyre, je ti që i kontrollon?

**Milva Ekonomi** - Askush, ashtu siç nuk kontrollove ti zgjedhjet e tjera, për të cilat bën kërkesë për një dëgjuesë. Kështu që, për çështjen e parë të rendit të ditës duhet të themi se kemi rënë në një dakordësi të përbashkët, sepse mendojmë se ky grup, që zoti Rrokaj e quajti grup interesi, ka nevojë të shprehë mendimin e vet përpara komisionit.

Ditën e premte ju bëtë një kërkesë për një dëgjuesë të menjëhershme me dy ministrat, të cilën ata e kanë marrë sot. E kemi diskutuar disa herë në komisione që ministrat kanë një ngarkesë të madhe dhe nuk mund të thirren sot për sot në dëgjuesë, por duhet t'i njoftojmë paraprakisht për të parë hapësirën që kanë në axhendë. Nuk duhet të harrojmë që edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 80, që ju i referoheni, pika 1, thuhet: “Kryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar t'u përgjigjet interpelancave dhe pyetjeve të deputetëve brenda tri javëve”. Kështu që edhe këtu kemi një hapësirë ligjore ku të mbështetemi. Edhe neni 36, edhe neni 102 i Rregullores lejojnë që ne të biem dakord me ministrat për të gjetur kohën e përshtatshme. Natyrisht që duhet të vlerësojmë faktin që edhe ministrja e Arsimit, edhe ministri i Brendshëm kanë qenë në këtë komision dhe kanë shpjeguar të gjitha pyetjet që ne bëmë. Kështu që unë mendoj se dëgjuesat me ministrat duhet të rakordohen, sepse nuk mund të bëhen gjërat tani për tani.

Diçka tjetër e rëndësishme është që në kalendar, përveç dëgjuesës që nuk ishte konfirmuar dhe është vendosur në kalendar, është edhe marrja në konsideratë e kalendarit të punës për periudhën që vjen, sepse komisioni ynë po e bën të zakonshme që një kalendar javor, për të cilin diskutojmë fort dhe biem dakord, të prishet në momentin e fundit. Kështu që unë dua të bëj një thirrje të fortë që kalendari i kësaj jave duhet të rakordohet patjetër me votim në komision, në të kundërt, komisioni nuk do të punojë siç duhet dhe nuk do të marrë informacionet e nevojshme.

Së treti, unë mendoj që pas diskutimit për procedurë, t'i lëmë profesorët të shprehin mendimet e tyre dhe ne të vazhdojmë normalisht mbledhjen e komisionit me pikën e parë të rendit të ditës.

**Albana Vokshi** –Faleminderit, Milva!

Dua të bëj një sqarim. Referenca e nenit 80, pika 1, është komplet e gabuar dhe ia kishit thënë gabim edhe ministrit Lleshaj, ndoshta me qëllim, e cila bën fjalë për interpelancat dhe pyetjet e deputetëve në seancat dëgjimore. Ju lutem, referojuni nenit 80, pika 3, i cili

shprehet pikërisht për seancat dëgjimore me ministrat, ku thotë: “Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre, për sa e lejon ligji”. Pra, janë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo ka lidhje edhe me ju. A nuk ju intereson juve që ministrat nuk kanë ardhur?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, do t’jua kaloj fjalën menjëherë, por dua t’ju them se kishim një seancë dëgjimore në lidhje me incidentin që ka ndodhur te Filologjiku, ku policia ka shkelur me të dyja këmbët ligjin dhe...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Pikërisht, por ata refuzuan. Pra, është shkelje e Kushtetutës dhe e ligjit.

**Luçiano Boçi** – Përfaqësuesit e asamblesë duhet të na mirëkuptojnë, pasi edhe kryetarja e bëri sqarimin për orën. Prandaj, le t’ua lëmë fjalën përfaqësuesve.

**Albana Vokshi** – Po, zoti Prifti.

**Rezart Prifti** – Të nderuar dhe fort të respektuar, unë quhen Rezart Prifti, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik. Profesor Shegani e zgjidhi këtë punë me detajimin që bëri, por unë do të përpiqem t’i bie sa më shkurt dhe ta bëj situatën sa më piktoreske, në mënyrë që të mos e bëjmë shumë teknike, pasi ju i dini teknikat.

Debatin doja ta nisja nga një çështje ndërgjegjeje, por, duke parë që kjo puna e ndërgjegjes, nga eksperiencat e fundit me ministren dhe me debate e tjera, është deri diku e kotë... Para se të vija këtu po lexoja “The Economist”, ku ishte 175 vjetori i krijimit të saj, dhe po lexoja një tekst shumë të bukur ku thuhej: *“The ruling class living a bubble. They go to the same colleges, marry each other, live the same streets and work in the same offices”*. Kjo është perlë për të shprehur mungesën e asaj, që unë e quaj jashtë kontekstit të bërjes së politikave deri sot. Kjo është epitoma e të gjithë këtij ligji, VKM-ve dhe diskutimeve deri diku të politikbërësve në atë pikë.

Siç u bë ligji, erdhi një Loni nga Anglia dhe na tha se çfarë duhet të bëjmë, por ka kaluar kaq kohë, ku edhe 4 VKM-të, të cilat preknin edhe pedagogët, u nxorën brenda natës si llamba e Aladinit dhe nuk na pyeti njeri as për ligjin dhe as për VKM-të, por harroni që ka ardhur një brez krejt i ri, i arsimuar jashtë, më mirë se ata londinezët që sillni ju këtu, i paguani 1500 dollarë dita dhe ne e kemi 140 dollarë, për arsye se nuk na lejon konflikt - interesi i punës, dhe na japin edhe mend.

Profesor Marku tha që nuk janë pakicë pedagogët. Për hir të së vërtetës, në atë kontekst që tha profesori, nuk janë pakicë, por unë sot po ju them që janë pakicë, sepse ata po ikin, ashtu

siç po ikin njerëzit e tjerë, në Gjermani dhe në Angli. Sot ka një *brain drain* nga fakultetet tona dhe për çështje ditësh do të dalë në ndonjë artikull ta thotë, sepse nuk e dinë akoma. Mund të përmend këtu departamente, në të cilat vetëm 2-3 vjetët e fundit kanë ikur nga 6-7 pedagogë, është bërë diarre e gjallë, të cilët kanë përfunduar universitetet më të mira. Për shembull, në universitetet e rretheve 1 pedagog jep 18 lëndë, jep shkencën e tokës, biologjinë dhe gjeografinë, ku flasin për gjëra që nuk i dinë dhe dalin jashtë kontekstit. Kjo është gafa më e madhe që bëhet në arsim. Nuk e di se sa efekt do të ketë kjo punë këtu, por të paktën të vihet gishti mbi 4 gjëra bazike që ka ky ligj.

Së pari, problemi i madh që ka ky sistem arsimor është masivizimi i madh. Pa zgjidhur problemin e masivizimit, është e kotë të diskutosh për përgjysmimin e tarifave, për ekselencën e të tjera.

Së dyti, kurrikula. A e dini ju, përpos atyre që thotë Kryeministri, që ne tregtojmë libra me lekë, ai nuk e di që nuk kemi libra fare dhe, kur nuk ke libra, nuk ke se çfarë shet, që ka mungesë kurrikule në universitet? Fakultetet tona sot kanë kurrikul me libra të viteve '89, të cilët nuk u përgjigjen as tregut që ishte në vitet '89, sepse janë të përkthyer keq. Ndaj edhe studentët, kur dalin nga universiteti duan dy vjet të marrin veten nëpër firma dhe nëpër medie, sepse janë jashtë kontekstit.

Së treti, është mekanizmi i kontrollit. U bë ligji, bordi e të tjerë dhe jam dakord që një pjesë të fajit e ka qeveria, por duhet t'i japësh Cezarit çfarë i takon Cezarit. I gjithë ai ligj u bë në mënyrën më injorante të mundshme, që nuk u bë një mekanizëm kontrolli për universitetet. Rektori ka 4 vjet që mban çelësin e serverit dhe nuk kemi serverë. Duhet të marr 500 studentë t'u bëj letra me emër e me mbiemër, me ditëlindje, që t'i dalloj se cilët janë. Ndonjë ditë do të vijë plaka ime në provim dhe do të hyjë në menaxhim, dhe unë nuk do ta verifikoj dot nëse ka hyrë ose jo. Ka 4 vjet që mban çelësin zotëria. Klasa drejtuese është shkëputur nga realiteti ekonomik dhe shoqëror. A e dini ju se ka drejtues nëpër fakultete që mendojnë se me 10 mijë lekë mund të shkosh në Sarandë, sepse 50 mijë lekë dietë janë shumë? Kjo ndodh, sepse ai zotëria ka 30 vjet që nuk ka futur dorën në xhep dhe e kujton ende si në kohën e qoftëlargut që veje e vije në Sarandë, haje edhe një tasqebap rrugës.

Së katërti, konkurrueshmëria. Universitetet tona nuk janë të konkurrueshme. Sot nuk ka një kurrikul për tregun që të vijë një firmë apo medie dhe të thotë që unë të financoj një program ekselence dhe ti të më japësh 10 gazetarët më të mirë, 10 financiarët, 10 IT-të më të mirë e të tjerë. Unë si pedagog duhet të jem i konkurrueshëm, sepse Kryeministri, me shumë të drejtë, na bën pyetje neve dhe ndonjëherë pyetja edhe nuk gjykohet, por për të na dëgjuar

nuk na dëgjon dhe, siç tha herën e fundit, ne jemi qenë që lehim, por karvani i tyre të ecë përpara. Jo, more, jo!

Kryeministri thotë: “vlerësimi i titujve akademikë”. Po, mund ta bësh, absolutisht po, por vlerësimi i titullit akademik ka procedurë dhe ka protokoll. Në qoftë se do ta bësh ashtu siç duhet, hajde na pyet ne që kemi mbaruar jashtë se si bëhet, por duhet të llogarisësh kasaphanë mbrapa, sepse shumica e kolegëve tuaj të nderuar do të dalin me pullë në biografi, do të dalin si vetingu në gjyqësor, që nuk ka mbetur gjyqtar për të gjykuar dynjanë, sepse i tillë ka qenë sistemi dhe nuk mund ta prapagjykosht ti me rregullat e reja që të vendosësh sot tituj akademikë.

Si do ta bëjë specialisti i Ministrisë së Arsimit “titull akademik”, kur unë jam “Doktor shkencash”, ai është specialisti im dhe ka dalë nga bankat e mia!? Mbi çfarë kriteri do ta bëjë? Pastaj thotë “libra për notën”. Pyetini pedagogët tuaj a tregtojnë libra për notën? Këto janë dy gjëra të ndryshme. Atë që tregon libra me notën, merre dhe çoje në burg. Gjithashtu, edhe atë që merr lekë për lëndën, hetoje dhe çoje në burg. Kjo është e thjeshtë dhe nuk keni pse na njollosni me. Pse duhet të njollosem unë si 40 palaço, që janë nëpër universitetet e lodhura apo nëpër universitetet e rretheve për një 50-euro të qelbur? Jo, ore, nuk janë të gjithë pedagogët ashtu! Pse? Sepse është çështje mendësie. Kam pasur unë raste kur ka ardhur gjyshja e të bijës së botës dhe më ka lënë 200 euro në zarf dhe i them: “None, jepja dhe bëja dhuratë gocës. Nuk bëhet kjo punë kështu.”. Edhe Kryeministri, duke qenë se nuk e njeh fare, kujton se bëhet kështu. Tregtojmë ne libra?! Zotëri, ne nuk kemi fare libra. E di pse?! Sepse të bësh një libër duhen një qerre me lekë; duhen një qerre me njerëz nga mbrapa dhe nuk bëhen librat kështu, siç e sugjeron zotëria te VKM-ja e dytë apo e tretë që do të ngrihet komisioni i lalushëve me radhë. Çfarë bëhet kështu?! Si u bëka libri me komision të përgjithshëm, njësoj si në kohën e qoftëlargut? Kjo bie ndesh edhe më pjesën e frymës së ligjit. Ky ligj, përpos teknikave që shpjegoi profesori, ka disa probleme, shkon ndesh me diversifikimin e arsimit të lartë; shkon ndesh me frymën e kërkim-zhvillimit; shkon ndesh me konkurrueshmërinë. Tha ai do të ngrihet komision që do të miratojë... Po ku e njeh ti lëndën time që do të miratosh një libër për mua?! Unë jam inovacion. 98% e shqiptarëve nuk e dinë se çfarë lënde jap unë.

Zotëria ka pasur ministri për inovacionin dhe nuk e mori vesh një herë që është e vetmja lëndë në Shqipëri që jepet. Kishte Ministri Inovacioni, ministrja nuk e kishte haberin se çfarë ishte inovacioni. Po kur thotë që vlerësimi i pedagogëve të bëhet nga studentët! More, zotëri, në fakultetet tona aktualisht ka metodologji dhe e ka shpikur bota metodologjinë se si vlerësohen pedagogët. Nuk vlerësohen nga Këshilli Kombëtar... Përsëri do të ngrihet një grup pune; do të bëjmë një surealizëm më vete dhe çfarë?! Do të kalojmë ne në gijotinë: “Ti je burrë i mirë, ti je burrë i keq”. I ka kaluar bota këto më parë, rajoni gjithashtu. Kemi qenë në lloj-



lloj konferencash për këto vlerësime. Duke filluar që nga rajoni, Kroacia, Bosnja dhe më tutje Spanja, Italia dhe Gjermania kanë metodologji për këtë, ka proces. Këto nuk shpiken brenda ditës apo natës. Unë ju kërkoj ndjesë, sepse ndoshta fola pak i revoltuar, por janë gjëra që më prekin, edhe kur nuk artikulohen në formë masive. Edhe më i dhimbshëm është fakti, sepse është bërë një diskutim butaforik. Ne po diskutojmë për gjëra të paprekshme. Në qoftë se doni t'i jepni një vlerë arsimit në këtë vend (një herë në një shekull, se ne kemi një shekull pa arsim, se nuk mbetëm sot pa arsim), dëgjoni disa njerëz, të cilët i kanë dy informacione, i kanë dy lidhje, i kanë tri pare mend dhe janë të besueshëm, dhe e njohin kontekstin dhe mendësinë. Në fund të ditës ligjin mund ta bëjmë si të doni, por kjo është çështje mendësie. Çfarë vizioni ke? Unë i them atij për një projekt 1 milion euro të Bashkimit European, ai thotë: “Rezart, do të bëj një simpozium”, sepse i ka mbetur sahati në ’88-ën, simpoziumin njeh ai si instrument. Do të bëjmë një konferencë. Shumë nga ju kanë qenë në konferenca dhe e dinë se pas orës së dytë do t’u bëhet goja çorape e do të trashen. Çfarë shkencë do të bëjmë ne? Do të dëgjojmë njëri-tjetrin dhe do të përsëritim të njëjtat fjalë gjatë gjithë kohës. T’i bëjmë gjërat më praktike. Ky debat do të plasë, se ka filluar *drain*-i i pedagogëve. Pastaj do të vijnë edhe shkollat e mesme, sepse edhe ato 4-5 vjet i kanë bërë! E kanë bërë komplet eksperimental. Pardje isha në shkollën më të mirë, në pesëshen më të mirë në Shqipëri, dhe ankoheshin e më shihnin mua si kisha e Shën Antonit. I them “të dëgjoj dhe e di problemin tënd, se kam 4 vjet që po merrem me këtë punë”. Do të përpiqem, sepse nuk i dëgjon njeri ata. U ndjeva bashkëvuajtës, sepse, siç nuk më dëgjon njëri mua, që kam në dy kanale akses, kush i dëgjon ata?! E njëjta gjë ndodh gjithandej. Megjithatë, dua të them se çfarëdolloj gjëje që të prodhohet, zhgënjimi më i madh është moskomunikimi qoftë nga ana e qeverisë, duke marrë parasysh eksperiencën e fundit të ministres që ne hymë shul e dolëm lloz. M’u kujtua ai humori i atëhershëm: “Shoku Jashar, si është partia?”, “Partia e shulave”- tha ai.

Gjithashtu, kemi edhe mosmarrjen e informacionit nga këta politikëbërës, të cilët kanë tre muaj që nuk po dinë nga ta kapin gomarin, nga para apo nga mbrapa. Janë gjëra shumë të thjeshta për t’u rregulluar dhe nuk ka nevojë për shkencë. Mjafton të dëgjoni tre-katër njerëz nga lidhet ky sistem.

Faleminderit për kohën! Ishte kënaqësi!

**Albana Vokshi** – Faleminderit shumë, zoti Prifti! Faleminderit edhe për pasionin, me të cilin folët dhe shtjelluat një sërë prej problematikave.

Po ia jap fjalën Klejdi Këlliçi, që është i fundit në radhë, pastaj do të vazhdojmë me pyetjet e deputetëve.

**Klejdi Këlliçi** – Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja kryetare,

Unë jam Klejdi Këlliçi vij nga Fakulteti i Shkencave Sociale. Do të ndalem më tepër në dy momente historike për sa i përket ligjit. Kam përshtypjen se në momentin kur u vu ligji, fryma e asaj kohe, tendenca për të bërë njëfarë reformimi të përgjithshëm e lanë mënjanë arsimin. Ideja, të paktën si e kam parë unë ligjin, ka qenë që politikëbërësit shqiptarë kanë dashur të heqin dorë nga arsimi ose t'ia lënë vetë arsimit të lartë të merret me problemet e tij, por arsimi i lartë nuk i ka instrumentet e duhura financiare për ta përballuar gjithë këtë ndryshim.

Momenti i dytë është ai draftpaktit për universitetin, që fillon e kapet më tepër me reagimin ndaj krizës, por duke e parë këtë krizë si produkt të universitetit dhe jo si produkt i asaj që sjell ligji. Praktikisht, fryma e draftpaktit, në njëfarë mënyrë, tenton t'i kundërvërë studentët me pedagogët. E gjithë fryma dhe mënyra se si do të bëhet kontrolli ngjan pikërisht me këtë ide, që problemet janë brenda universitetit dhe nuk lidhen me sistemin. Unë do të thosha se është pak a shumë e kundërta, është mënyra si është ndërtuar ligji, mënyra si është ndërtuar financimi i universitetit që e ka sjellë gjendjen në këtë pikë. Mos harroni se ju jeni përfaqësues dhe vini nga zona të ndryshme të Shqipërisë, të paktën punoni në ato zona. 90% e studentëve nuk janë nga Tirana, por vijnë nga rrethinat e Tiranës, gati nga e gjithë Shqipëria. Është pak e çuditshme, sepse dega ku jam unë, shkenca politike më duket një degë, nëse do ta quajmë, luksi, unë shoh një problem të natyrës socio-ekonomike, që nuk ka të bëjë shumë me universitetin në vetvete. Tarifat universitare, që nuk i përballojnë dot këta studentë, lidhen me një problem më të madh shoqëror.

Për sa ekzistojmë ne si shtet, arsimi ka qenë një nga prioritetet e familjeve shqiptare dhe do të mbetet si i tillë. Është e kotë që ne mundohemi t'i ndryshojmë politikat publike për sa i përket arsimit, të kalojmë dhe t'i orientojmë njerëzit drejt arsimit më të ngushtë profesional. Kjo mund të ndodhë, por aspiratë e familjeve shqiptare është universiteti. Është një aspiratë, e cila ka filluar që në vitin 1990 dhe një nga kërkesat ka qenë hapja e universitetit, i cili perceptohej si i mbyllur. Prandaj po them se problemet që ka sjellë ligji dhe mënyra se si do të financohet universitetit, do të shfaqen më vonë.

Për sa i përket draftpaktit, unë e shoh në aspektin e kundërvënies me pedagogët. Këtu dua të ndalem të problemi i kërkimit shkencor. Sikurse tha edhe kolegu, pedagogëve shqiptarë u kërkohet cilësia, por është një cilësi, të cilën ne duhet ta financojmë vetë. Praktikisht, në të gjitha hapat që duhet të ndërmarr për të arritur nesër apo pasnesër titullin e “Profesorit të asocuar”, gati gjithçka do ta financoj vetë, që nga konferencat, sepse universiteti nuk mbulon asgjë, që nga vullnetarizmi për të mbajtur në këmbë revistën shkencore që kemi në universitet.

Puna e redaktorit shkencor dhe e atyre që mbledhin artikuj nuk paguhet në asnjë lloj momenti. Le ta marrim këtë si çështje vullnetarizmi, por ka edhe probleme të tjera, si problemet e konferencave shkencore, të konferencave që bëhen jashtë etj? Imagjinoni që për të botuar një libër duhen rreth 140 mijë lekë të rinj, të cilët janë të barabartë me dy rroga në rangun tim “Doktor shkencash”. A duhet t’ia heq unë familjes sime këto për të botuar një libër, i cili do të më shërbejë mua për të marrë titullin “Profesor i asocuar” nesër apo pasnesër, sikurse e parashikon dhe e kërkon ligji? Pra, pedagogët shqiptarë përballen me të gjitha këto probleme. Ka njerëz që i shprehin, ka njerëz që nuk i shprehin. Unë për vete e ndiej të nevojshme t’i shpreh.

Ne çdo vit na vjen nga Ministria e Arsimit një kërkesë për ato që bëjmë. Ato që ne bëjmë, pra konferenca shkencore, artikuj etj., janë të financuara totalisht nga personi. Pra, ka persona që duan ta bëjnë dhe e ndiejnë të nevojshme ta bëjnë, ka persona që nuk e bëjnë. Ata që e ndiejnë të nevojshme, e bëjnë me kosto personale. Pra, këto janë problemet që unë shoh, probleme të një skizofrenie që ka prodhuar ligji, kur u bë, draftpakti tani dhe problemet që kanë të bëjnë me rolin e pedagogut.

Ju faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit për prezantimet!

Në fakt, meqenëse ndodhi ngjarja të enjten të Filologjikut dhe një prej personave që pashë në video ishte edhe zoti Marku, që ndiqte në njëfarë mënyre policinë, do të doja ta pyesja: meqenëse keni qenë dëshmitar dhe keni komunikuar, çfarë ndodhi, zoti Marku, atë ditë në universitet dhe si e gjykoni këtë ndërhyrje të policisë në ambientet e Filologjikut? Kam edhe një pyetje tjetër. Kemi ndjekur me shumë vëmendje prezantimet që ka bërë Kryeministri nëpër universitete për paktin, për arsimin e lartë. Unë dua të ndalem tek takimi që pati me studentët e Mjekësisë. Si u ndjetë ju kur Kryeministri u tha studentëve që jeni marrë peng nga markmarkrit? Si janë ndjerë edhe profesorët e tjerë, të intimiduar nga gjuha e Kryeministrit? Si e shihni? A është etike apo jo që t’u vërë përballë njëri-tjetrit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të lutem, se po flas! Jo, jo, unë për të mirën time, unë po i bëj pyetje. Kemi profesorë të nderuar dhe do t’jua jap fjalën atyre. Mos më ndërprisni në çdo moment. Pra, a janë normale deklarata të tilla të një Kryeministri që vë përballë profesorët me njëri-tjetrin, studentët me profesorët?

**Bujar Çela** – Për procedurë.

Unë i përshëndes pedagogët që sjellin një shqetësim të studentëve dhe të stafit të tyre. Ne kemi qenë gjithmonë një komision i vëmendshëm për të dëgjuar, por shpesh i ngatërrojmë.

Ne këtu jemi për të dëgjuar njerëzit që janë të interesuar për mbarrëvajtjen e ligjit, që janë edhe grupe interesi, po t'u referohemi kolegëve tanë, por mendoj se nuk është vendi për t'i pyetur se çfarë u ndodhi? Ku ishte dhe kush të shtyu? Të lutem, për këtë çështje ishin thirrur dy ministra...

**Albana Vokshi** – Faleminderit shumë! Kam një pyetje, nëse nuk të intereson...

**Bujar Çela** – Ta mbaroj, të lutem!

**Albana Vokshi** – Jo.

**Bujar Çela** – Po si jo?

**Albana Vokshi** – Nuk të intereson ty gjuha e Kryeministrit, por më intereson mua..

**Bujar Çela** – Më intereson mua, se nuk janë grupe interesi në interesin tuaj dhe të PD-së...

**Albana Vokshi** – Lëre, se nuk i quan dot ti grup interesi, pavarësisht mesazheve që merr.

Të lutem, zoti Marku!

**Bujar Çela** – A ka mundësi? Ne kemi thirrur dy ministra, të cilët janë mbi 18 vjeç...

**Albana Vokshi** – Bujar, të lutem, të respektojmë! Nuk e prishni dot dëgjuesin. Ta respektojmë tani zotin Marku!

**Bujar Çela** – Jo, nuk është e drejtë. Ju po e prishni, se jeni në funksion të një gjëje jashtë sallës. As universitete doni ju, as ligj doni ju, as dëgjues doni ju...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

**Bujar Çela** – Ta mbaroj, pra! Nuk e kam mbaruar. I dashur Luçiano, ju e merrni fjalën sa herë të doni dhe e keni këtë privilegj. Unë jam i interesuar të dëgjoj...

**Albana Vokshi** – A ndihesh mirë, Bujar që e bën këtë?

Nuk besoj se ndihesh mirë që bën zhurmuesin.

**Bujar Çela** – ... t'i dëgjoj pedagogët për interesin publik të universitetit, jo për gjëra në funksion dhe për të hedhur baltë mbi ata që nuk janë këtu.

**Albana Vokshi** – E di që prekeni kur flasim për Kryeministrin. Do të dëgjojmë mendimet e pedagogëve që Kryeministri po i atakon çdo ditë... Tani po ia jap fjalën t'i dëgjojmë pak...

**Bujar Çela** – Kryetare, kam shumë respekt për rolin e kryetares, por ju mund të jeni shumë e zonja për të bërë kryetaren e opozitës, por jo kryetaren e Komisionit të Medies, Arsimit. Të lutem, të dëgjojmë! Për procedurë, ne pedagogët i dëgjuam, ishin shumë shterues

në mendimet e tyre dhe mendoj se, edhe nëse e lënë tani sallën e komisionit, neve na kanë shërbyer shumë, por edhe punës për të cilën kanë ardhur...

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Po i përzë ti?!

Zoti Marku, të lutem, bëra dy pyetje shumë konkrete, pastaj kanë pyetje edhe kolegët e mi që kanë kërkuar fjalën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nëse ke mbaruar, Bujar, ne të tjerët nuk kemi mbaruar.

Zoti Marku.

**Bujar Çela** – A ka mundësi ta hedhim në votë këtë që propozova?

Kjo është çështja. Do të jemi konkretë, apo jo?

**Albana Vokshi** – Zoti Marku, të lutem!

**Mark Marku** – Mos u mërzit, sepse unë nuk do ta shaj Kryeministrin, sikur e gjithë Shqipëria të më thotë ta shaj, sepse unë nuk shaj. Kështu që nuk kam ndër mend të përmend... E para, nuk kam ndjerë as zë, as jam intimiduar dhe as kam frikë... Është fatkeqësi që pedagogë ose qytetarë të Shqipërisë linçohen dhe përgojohen rrugëve, por kjo është një çështje etike e politikës shqiptare dhe le ta zgjidhin vetë, por mendoj se për miliona shqiptarë që dëgjojnë, është një gjë krejt... dhe, mbi të gjitha, është antikushtetuese dhe antiligjore. Askush nuk ka të drejtë të përdorë emrin e askujt për ta linçuar rrugëve e mitingjeve. Nuk ndiej asgjë. Nuk jam fare i shqetësuar nga kjo. Më vjen keq për këtë që po ndodh, por del jashtë gjithçkaje që mendoj dhe jashtë vizionit që kam për shoqërinë shqiptare dhe për botën në përgjithësi. Kështu që, kur flasim, ne bëjmë disa reagime.

E dëgjova që u përmend disa herë “grupe interesi”, me sa kuptova, një tip insinuate. Po, jemi grup interesi në kuptimin jo të atyre interesave që mendohet, kur bëhet fjalë për grup interesi. Nuk kemi asnjë interes në universitet, përveç dëshirës që të bëhet mirë universiteti shqiptar, sepse, po të ishte për interesa personale, do të na interesonte të mos rrinim asnjë ditë në këtë universitet, që keni krijuar ju dhe në gjendjen që e keni çuar ju. Rimë këtu sepse kemi vendosur të jetojmë këtu, por asnjë sekondë nuk do të rrinim, për asnjë sekondë nuk do të rrija, për asnjë arsye, sepse s’kam asnjë interes, as unë, as kolegët e mi të rrimë në këtë universitet, në këtë gjendje që është universiteti. Rimë sepse kemi pasionin për këtë punë, nuk rrimë nga halli, e kemi zgjedhur këtë punë dhe jemi të detyruar ta bëjmë këtë mbrojtje në mënyrë të vazhdueshme.

Për sa i përket rastit të Filologjikut, ditën e enjte ka ardhur dy herë policia. Herën e parë nuk kam qenë aty, por më lajmëruan studentët. Ishte një makinë policie që ndaloi para

fakultetit dhe dy policë hynë në oborr dhe shkuan deri në hollin e fakultetit. Njëri raportonte që po bëhet mësim, sepse ai polici e dinte se bëhej mësimi në holl, meqenëse pa ca njerëz aty.

Çfarë pune ka policia të hyjë dhe të raportojë nëse bëhet mësim apo jo? Normalisht, ne reaguam, sepse ishte në shkelje të plotë të ligjit. Studentët ishin shumë të irrituar, por nuk ishin të frikësuar, as studentët, as pedagogët, se nuk janë fëmijë që të tremben nga policët.

Pra, nga një pikëpamje ishte edhe një lloj idiotizmi total, se të çosh polic për të trembur pedagogët apo studentët, në thelb, vetëm shkel ligjin.

I qetësuam studentët, komunikova me policët, të cilët ikën nëpër oborr; m'u desh t'i ndjek sepse kishin ardhur për të kërcënuar dhe situata u bë qesharake. Pastaj, meqenëse nuk kishin nga të shkonin se u ndeshëm me një mur, nuk e kaluan murin se do të rrëzoheshin, u kthyen dhe dolën jashtë. Ne i kemi regjistruar me kamera. Kanë qenë kamera televizioneve, me celularë studentësh dhe gjithë ngjarja është e dokumentuar. Kjo ngjarje ishte në shkelje flagrante me ligjin.

Është e vërtetë ajo që thatë ju se unë u habita, sepse m'u duk një lloj çorientimi total, se një ditë më parë kishte ardhur ministri i Rendit, zoti Lleshaj, dhe kishte thënë se nuk është e vërtetë që autoritet... etj., etj., gënjente pa pikë turpi, dhe të nesërmen sillte forcat e policisë si për t'i bërë karshillëk opinionit publik. I sillte aty duke demonstruar se jo vetëm është gënjeshtar i paparë, por që nuk pyeste fare për ligjin, për Kushtetutën, për rendin etj..

Mesazhi më i keq që mund t'u jepet studentëve të mi është ky, që policia kur të dojë e shkel ligjin, pra vë gjoba për shkeljen e ligjit, por ligjin e shkel vetë. Ne kemi vendosur ta denoncojmë, do të bëjmë një denoncim si asamble në gjykatë. Edhe nëse na ftoni ju këtu, jemi gati të vijmë bashkë me kolegët që kanë qenë aty, me fakte, për të dëshmuar për shkeljen e ligjit.

**Albana Vokshi** - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Rrokaj!

**Shezai Rrokaj** - Faleminderit!

Po sqaroj qëndrimin tim lidhur me konceptin “grup interesi”. Ky është një koncept modern, demokratik, sot kur grupet e interesit nuk kanë të bëjnë me marrëdhënie për të zhvatur apo për të kapur, apo për të qëndruar në mënyrë jo demokratike në krye të institucioneve, por është thjesht dhe vetëm që të gjitha ligjet në shoqëritë demokratike në vendet e UECD-së marrin parasysh dhe nuk kalojnë pa pasur konsensusin e atyre grupeve që pësojnë ose veprojnë me këto ligje.

Ajo që ka ndodhur në këtë ligj është fakti se grupet e interesit u bë sikur u dëgjuan. Nuk u morën parasysh mendimet kryesore që ata shfaqën në gati 1000 faqe vërejtje, kur vinin

për konsultë herë pas here, pra pati një mënyrë tinëzare midis qeverisjes dhe grupeve të interesit, ku rolin kryesor e luajtën draftbërësit, të cilët për hir të së vërtetës, ata janë kolegë dhe unë nuk dua të flas keq, por nuk njihnin si dhe sa duhet, sepse nuk kishin drejtuar universitetin dhe nuk e kuptonin në atë mënyrë. Kështu që pati, siç ndodh gjithmonë, transplantime konceptesh nga modele të ndryshme, duke i ikur sadopak modelit të Bolonjës, për ta zëvendësuar me një kinse model anglosakson, i cili prishi disa ekuilibra.

Ka ndodhur që nga njëra anë kemi parimet, siç janë parimet e së drejtës për arsim, parimet e transparencës, parimet e lirisë akademike, të autonomisë, pra, po t'i shikoni, te neni 5 janë të gjitha të shkruara, por nga ana tjetër nuk janë zgjidhur ashtu si duhet dhe goditjet janë bërë në tre drejtime themelore: është goditur liria akademike edhe në VKM-të; është goditur te shkolla e doktoratës, për të cilën universitetet nuk mund të vendosin, por duhet të shkojë projekti te kërkimi shkencor; është goditur edhe të akreditimi, si i vetmi vend që e mbajmë akreditimin nën ombrellën e Mistrisë së Arsimit. Është goditur modeli ekonomik, duke qenë një vend që nuk ndjekim rregullat e financimit të arsimit në masën e duhur. Kjo nuk i takon vetëm kësaj qeverisje, pra është zgjatim në të gjitha vitet e demokracisë, por kjo qeverisje sanksionoi me ligj, madje i trumbetoi që për tarifat i mbajnë përgjegjësitë IAL-të.

Dikur, para vitit 2015, IAL-të propozonin dhe qeveria miratonte, kurse me këtë ligj IAL-të vendosin dhe qeveria vendos një tavan.

1. Qeveria u tha IAL-vë që ju merreni këtë grant dhe shmangu, mënjanoi përgjegjësinë direkt të qeverisë nga arsimi publik.

2. Ndau ciklin e shkollimit Bachelor dhe Master nga një kriter sipas Bolonjës, që rregullonte mobilitetin, e vuri si kriter ekzistencial, sepse tarifat e shkollimit lidhen jo thjesht dhe vetëm me meritokracinë, ku ne mund të bëjmë politika të drejta, siç edhe propozohet në pakt, por tarifat në radhë të parë lidhen me mundësitë familjare të shqiptarëve, të cilat vendosin që jo domosdoshmërisht truri lidhet me xhepin, pra jo domosdoshmërisht ai që ka para, ka edhe mend dhe ai që ka mend, ka detyrimisht edhe para.

Së fundmi, me autonominë financiare, me dublimin e strukturave kolegjiale dhe krijimin e paralelizmave me autoritetet drejtuese, që do të thotë se në universitet nuk po kuptohet sot se cili prevalon midis dy autoriteteve: ai i vizionit, i akademizmit apo ai i menaxhimit, që gjithë bota e di se prevalon ai i akademizmit, ndonëse në ushtrimin e funksioneve, këtu me të drejtë u tha, secili duhet të ketë funksione të ndara.

Kulmin e arriti te kreu 12, ku u kuptua edhe hileja që u bë, sipas së cilës do të zgjidhej çështja e marrëdhënies së universiteteve publike dhe private, ndonëse ne mbështesim universitetet private.

U bë një ligj shumë burokratik, sepse përqendroi në Ministri të Arsimit 5 agjenci dhe i dha kësaj ministrie, për fat të keq, nga një rol politikëbërës dhe auditiv mbi institucionet, me VKM-të e fundit, role që nuk i takojnë.

Duhet të kuptojmë një gjë, që është shumë e thjeshtë, transparencën institucionet nuk e kanë për shkak të varësisë, por për shkak të zbatimit të ligjit. Ne duhet të jemi transparentë. Pse u dashka që Ministria e Arsimit apo çdo ministri, apo qeveria të jetë më e ndjeshme se institucionet? Sigurisht institucionet kanë punën e tyre, por shkeljen e konsideron ligji.

Pyetja ime është shumë e thjeshtë: Ju mendoni se është e nevojshme një ndërhyrje emergjente në disa nene që kanë të bëjnë kryesisht me mënjanimin e krizës së mirëfilltë, të cilat mund të bëhen shumë shpejt dhe pastaj të hapet një debat shumë më i gjerë, që të marrë një kohë të nevojshme, ku të rregullohen kjo problematikë që ka lindur?

Sugjerimi juaj, me sa kuptova, është një ndërhyrje e menjëhershme për të rregulluar disa gjëra që vërtet e kanë futur arsimin e lartë në kolaps, sa për t'i dhënë një frymëmarrje dhe të hapet një debat akoma më i gjerë për të bërë ndryshimet e një ligji, ashtu siç e dëshirojnë grupet e interesit dhe gjithë shoqëria, që e konsideron arsimin jo një të mirë politike apo partiake, por një të mirë publike, një të mirë kombëtare.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** - Faleminderit, zoti Rrokaj!

Urdhëroni!

**Fadil Nasufi** - Faleminderit!

Dua të falënderoj pedagogët që parashtruan probleme, të cilat fokusoheshin në dy çështje, te ligji i arsimit të lartë dhe te problematika që ka dalë nga protesta e studentëve. Duke qenë se kjo është bërë një temë pothuaj e përditësuar, qoftë e komisionit, qoftë e medias, unë konstatoj se ende nuk kuptohet përmbajtja dhe nuk njihet mirë ligji i arsimit të lartë, edhe nga ju pedagogët përfaqësues të asambleve.

Propozimet që u bënë për të ndërhyrë te ky ligj, për të qenë në sinkron me të gjitha ligjet e tjera që rregullojnë jetën akademike, universitare, por edhe atë financiare, është padyshim një arsyetim logjik, ashtu si natyrshëm vjen edhe kërkesa që në sinkron me ligjin të plotësohen VKM-të përkatëse dhe gjithë kuadri ligjor, që të mos krijohet asnjë lloj vakumi në jetën universitare.

Për sa i përket problemit tjetër, ne shikojmë se ka edhe një lloj dualiteti midis kërkesave që shtrojnë studentët, përgjigjes së këtyre kërkesave nëpërmjet VKM-ve, që ka dalë në kuadrin e paktit për universitetin, dhe një lloj hezitimi të një pjese të pedagogëve.



Fjala bie, studentët kërkojnë verifikimin e titujve shkencorë. Kjo është një kërkesë që ka dalë me propozim të qeverisë, por ka dalë si kërkesë e 8 pikave që kishin studentët që e shikojnë se ka probleme në këtë fushë dhe qeveria ka bërë një propozim përkatës me VKM.

Së dyti, shikojmë se ka përplasje dhe dualitete brena strukturave të vetë universiteteve, siç ka përplasje të linjës akademike me linjën administrative dhe ju i kërkonit zgjidhjet jashtë jetës së universiteteve, i kërkonit te Ministria e Arsimit ose i kërkonit te qeveria, ndërkohë që janë hapësira të domosdoshme që ligji jep, por që nuk janë injektuar dhe nuk vënë në zbatim nga strukturat përkatëse midis bordit administrativ dhe bordit akademik.

Siç e thatë edhe ju, nga 6 asamble janë krijuar 4, ndërkohë që duhej të kishit 3 vjet që t'i kishit krijuar. Kush ju ka penguar? Ligji ka dalë.

Në pikëpamjen e demokratizimit dhe të reformës në arsim ne me të drejtë kërkojmë ligje perëndimore, kërkojmë t'i ngjajmë Anglisë apo Gjermanisë, kurse nga pikëpamja financiare kërkojmë t'i ngjajmë pak sistemit të Lindjes apo modelit të vjetër.

Ne duhet ta gjejmë zgjidhjen dhe ta shëndoshim jetën universitare edhe me rritjen e buxheteve përkatëse, ashtu siç e jep ligji sepse, në fund të fundit, në implementim pengesat i krijojnë kosto brexit të studentëve që vijnë.

Siç u tha edhe nga pedagogët, ndoshta në variantin e parë të diskutimit të ligjit "Për arsimin e lartë" kanë pasur variantet e tyre, edhe të konsultimit publik. Ju, a keni marrë pjesë në konsultimet publike, në kohën e hartimit të ligjit? A keni depozituar kërkesa pranë grupeve përkatëse të hartimit të ligjit? A keni debatuar në media apo me grupet parlamentare?

Ju kërkonit që ligji të anulohet, kërkonit të ketë një vakuum ligjor, duke e shoqëruar me protesta dhe më një lloj vetoje, apo kërkonit që ky ligj të vazhdojë, të mos pengojë jetën universitare dhe të mos pengojë absolutisht procesin e mësimdhënies, që të punohet jo në vakum, por të punohet me këtë bazë ligjore, të cilën ne e kemi dhe po e implementojmë?

A mendoni se jeni minorancë në këtë ndërmarrje apo jeni në një lloj debati konkurrueshmërie, apo kemi një lloj arrogance intelektuale që imponohet falë një mbështetjeje apo falë një përfaqësimi, pse jo edhe politik, për të qenë në koherencë me vullnetin e shumicës dhe me një model që i shërben arsimit, i shërben stadi të sotëm dhe i shërben korrigjimit të gjithë defekteve që ka trashëguar arsimit i lartë, por që kërkon edhe stadi i sotëm bashkëkohor i arsimit në Shqipëri?

Një pjesë e mirë juaja foli për probleme reale, edhe për çështje që kanë të bëjnë me trashëgiminë e plagëve që ka sistemi arsimor në periudhën e tranzicionit dhe më një frymë që kërkon kontributin e të gjitha forcave politike, por në këtë kontekst unë besoj se jo çdo gjë duhet ta adresojmë me mohim, me kundërshtim, pa sjellë një alternativë dhe pa qenë në sinkron

me vullnetin dhe me atë që ka filluar të kurohet dhe të vijë si produkt i shëndetshëm i gjithë këtij procesi që po ndodh sot në arsimin e lartë.

Kam edhe një pyetje të fundit: A ka më shumë kundërshti në arsimin privat ky ligj, apo është ashtu siç e komentoni ju, që më shumë i shkon për shtat arsimit privat se arsimit publik? Se, në fund të fundit, sipas përmbajtjes së ligjit, edhe fondet, nëpërmjet kërkimit shkencor apo ekselencës, adresohen atje ku vete studenti, nuk adresohen sipas ligjit, atje ku ka prioritet arsimit shtetëror.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Nikolla!

Si duket paskeni pyetje. Mbase nuk i keni konsumuar, kur keni qenë ministre dhe tani keni rastin të flisni, të debatoni, të dëgjoni shqetësimet e pedagogëve. Mendoj se gjëja më e mirë që Kryeministri ka bërë, është që ju sjell në këtë komision pas 6 vjetëve si minister. Të paktën, tani keni rastin...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Tani ka rastin t'i dëgjojë shqetësimet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ka gojë vetë zonja Nikolla.

Unë po them se është gjëja më e mirë që e kanë sjellë në këtë komision. Jam e lumtur për këtë, sepse do t'i dëgjojë vetë shqetësimet, problemet. Çfarë nuk ka dëgjuar dikur, ka rastin t'i dëgjojë tani.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe për fokusin, e bën vend e pavend, gjithsesi do të kesh mundësi ta bësh vend e pavend, faleminderit, sepse sa herë silleni në këtë mënyrë, aq më shumë e kuptoj sesa të ndryshëm dhe larg jemi.

Unë doja të falënderoja profesorët e nderuar; me disa prej tyre kam pasur fatin dhe nderin që shpreh të dialogojmë, të debatojmë, të komunikojmë. I dëgjova me vëmendje për gjithçka që ata adresuan për situatën në arsimin tonë të lartë, për gjithçka që adresuan në lidhje me nevojat që ata mendojnë për të ndryshuar ligjin “Për arsimin e lartë”. Është një moment shumë i rëndësishëm. Nuk dua t'i jap asnjë lloj vlere, në kuptimin e largimit të përgjegjësisë të mia, sa kohë që kam qenë në krye të Ministrisë së Arsimit, por do të doja, si një njeri që ka dijeni të plotë për të gjithë procesin dhe të gjitha problematikat, të ndaja, së pari, respektin për profesorët e nderuar që janë sot këtu, por edhe për kolegët, si edhe refleksionet e mia. Në çdo kohë, biem dakord besoj, është e nevojshme të përmirësojmë

cilësinë e arsimit të lartë, të përmirësojmë mënyrën se si i mësojmë studentët. Gjithmonë, sado një ligj të jetë i mirë, nuk ka ligje perfekte, sepse ligjet nuk janë shkruar për të mos u ndryshuar. E kundërta është e vërtetë. Nevoja për të përmirësuar cilësinë në arsimin e lartë, për t'iu përgjigjur aspiratave dhe interesave të të rinjve, çon patjetër edhe në ndryshime ligjore.

Unë kam një pyetje për të gjithë ju këtu: vërtet e mendoni se e keqja e madhe e të gjithë situatave të vështira që përjeton arsimi ynë i lartë është ligji? Vërtet besoni se me ndryshimin e ligjit, gjithçka do të sjellë ndryshimin e një situate në favor të cilësisë, të kërkimit shkencor dhe të pedagogëve?

Unë dëgjova me shumë vëmendje edhe zotin Prifti. Ai foli për çështje të masivizimit, që ligji ka krijuar një situatë të re përmirësuese, foli për kurrikulat, absolutisht është shumë e vërtetë, janë kurrikula të stërvjetra dhe një lloj frenimi apo mosangazhimi, po marrim edhe fajet që ministria, unë si ministre, pasi nuk po drejtoj gishtin te ministrat e tjerë, mund të kemi pasur, se nuk kemi shtyrë aq sa duhet dhe nuk kemi mundësuar fonde aq sa duhet, për të përmirësuar kurrikulat, por, nga ana tjetër, jam e vetëdijshme dhe dua të them të vërtetat që kam përjetuar. Sot dhe gjithë ditën është shumë e vështirë të bësh profesore e profesorë për të bërë të mundur një qasje të re dhe realizimin e një situate të re për sa u përket kurrikulave. Këtë e kam me fakte, sepse kemi kërkuar dhe kemi realizuar nën drejtimin tim shumë tryeza lidhur me kurrikulat e mësuesisë, edhe pse ligji për sa u përket kurrikulave ka një risi, sepse kërkon të kemi një përputhshmëri të tyre në masën 70%. Besoj se ky ishte një moment që do t'u shërbente departamenteve, pedagogëve, jo thjesht dhe vetëm për të bërë një përputhshmëri mekanike të kurrikulave, por për ta përdorur këtë situatë për përmirësimin dhe kthimin e kurrikulave tona në standardet më të mira dhe në trendet e reja, ku ka hyrë metodologjia. Ka shumë problematika në metodologjinë e mësimdhënies në universitetet tona, mekanizmin e kontrollit, sikurse e thatë. Mendoj se ligji duke dhënë më shumë autonomi, nga ana tjetër ka forcuar edhe një komponent që është përgjegjshmëria. Por nëse ju i referoheni Universitetit të Tiranës, po është e vërtetë që aty ka një moment të vështirë për sa u përket dy titullarëve: rektorit dhe administratorit. Ju që e dini po aq mirë sa edhe unë, dhe besoj se e gjithë kjo nuk vjen për shkak të ligjit, por vjen për shkak të disa influencave dhe disa grupimeve, luftërave të vogla, qoftë edhe brenda llojit që kanë ndodhur aty, por që besoj se në cilësinë e ministres së Arsimit, për sa kohë që isha, dhe të dikasterit që pata nderin, fatin ta drejtoj, kemi shërbyer si një katalizator për të çliruar shumë nga ngërçet, por gjithmonë në respekt dhe pa ndërhyrë, pa cenuar autonominë e universitetit.

Do të doja të ndaj me ju edhe një vlerësim, folët për 5 agjenci, ligji nuk krijon agjenci të reja, krijon vetëm një agjenci të re dhe kjo është një nga vonesat e ligjit: Agjencinë e Financimit të Arsimit të Lartë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, ka qenë...

**Albana Vokshi** - Ju lutem, se nuk jemi ne për të folur për ligjin.

Në respekt të ish- ministres, po e lë të flasë, por jemi te pjesa e pyetjeve.

**Lindita Nikolla** – Ka qenë edhe Agjencia e Kërkimit Shkencor.

**Albana Vokshi** - Zonja ish- ministre, ju lutem, pyetjet!

**Lindita Nikolla**- Janë sërish, kanë marrë emër të ri, por janë sërish.

Profesor, më thoni që te ASKAL-I, në bordin e tij të akreditimit, nuk ka asnjë përfaqësues nga ministria e Arsimit. Ndryshe nga dje që kishte përfaqësues të kabinetit të Kryeministrit, zgjidhej direkt nga ministri i Arsimit, sot shkon te Kryeministri, pra, është rritur pavarësia...

**Albana Vokshi** - Pyetjet!

**Lindita Nikolla**- E dyta, si është ASKAL-i, është më i pavarur, kur në të gjithë bordin e akreditimit janë profesorë të nderuar dhe zero prani të ministrisë së Arsimit, të kabinetit të ministres apo si dje kur edhe në bord kishte përfaqësues të kabinetit të ministres së Arsimit dhe kryetari i bordit të akreditimit ishte këshilltari i Kryeministrit, që kishte edhe universitet privat? Pra, kemi edhe një hap të përmirësuar në këtë drejtim.

Ndërkohë po ju bëj me dije se ky është hapi i parë për të realizuar autonominë e ASKAL-it, që do të bëjë verifikimin e sigurimit të cilësisë sonë të arsimit të lartë, krahas momentit tjetër që është duke u punuar për të qenë anëtare e ENKA-s, për të siguruar më pas të gjitha potencialet profesionale dhe standardet e nevojshme, që të kthehet në një agjenci totalisht të pavarur, ku aderon dhe bëhet anëtare e ENKA-s.

Dëgjova me shumë vëmendje profesorin e nderuar, i cili foli dhe bëri një koment juridik, duke filluar nga kodi i etikës. Më lejoni, i dashur professor, t'ju bëj me dije se është një produkt i dalë nga Akademia e Shkencave, një produkt ku shkencëtarët, akademikët e Akademisë së Shkencave kanë prodhuar kodin e cilësisë nga A-ja te Zh-ja, për të cilën është e tepërt të them se kam pasur objeksionet e mia, por di të them se për këtë shkak nuk ka kaluar në qeveri. Pra, e gjithë referenca që bëtë, nuk ka lidhje me Ministrinë e Arsimit. Nuk dua të bëj komente, as me qeverinë, por thjesht për informacion është një dokument i prodhuar nga Akademia e Shkencave, krahas edhe një dokumenti tjetër, ligji “Për Akademinë e Shkencave”.

Po ashtu dua t'ju bëj me dije se u tha këtu se ata që bënë ligjin, erdhën nga këtej, hyn nga andej, por di të them se Universiteti i Tiranës ka pasur dy përfaqësues, jo të rastësishëm, jo papërvojë, por njëri ish -zëvendësrektor i Universitetit të Tiranës dhe tjetri pedagog, sot dekan i Fakultetit Juridik, ashtu sikurse ka pasur edhe profesorë të fushave të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, zëvendësrektori i Universitetit të Tiranës dhe me një përvojë të gjatë në fushën akademike. Ashtu sikurse kemi pasur përfaqësues edhe nga opozita, profesori i nderuar Besnik Aliaj, nuk është përfaqësues i PS-së, ashtu sikurse asnjëri nga profesorët, sepse qëllimi ishte shumë i qartë: të kemi një ligj, që bëhet nga profesorati, të kemi një ligj, që debatohet me të gjithë aktorët. Ju thatë se deri dje jemi akuzuar se nuk ka pasur proces dhe nuk është pyetur profesorati; sot rezulton se janë me mijëra faqe, kështu është e vërteta, kanë ardhur me shkrim...

**Albana Vokshi** –Tani, mirë që po e shpjegon se si është bërë ligji, ka shansin të na e shpjegojë, por ju lutem, pyetjet, zonja Nikolla, sepse nuk jemi këtu për t'ju dëgjuar juve!

**Lindita Nikolla-** Mund t'ju vijmë në ndihmë edhe mediet, kemi pasur një ballafaqim përfundimtar me të gjithë drejtuesit e universiteteve të Kisha Ortodokse dhe debati ka përfunduar nga ish- rektori i Universitetit të Tiranës, vetëm një oponencë që lidhej me kapitullin XII, e ka thënë me zë dhe me figurë edhe herë të tjera: ligji është një ligj, që sjell një qasje të re.

**Albana Vokshi-** Zonja Nikolla, do t'ju kërkoja të përmbliidheni te pyetjet, me shumë lutje!

**Lindita Nikolla** - Një ligj që do të mundësojë një histori të re drejt cilësisë. Unë këto nuk është se i kam dëgjuar dhe domosdoshmërisht janë të vërtetat absolute, sepse çdo gjë duhet të verifikohet dhe riveifikohet, dhe nuk kam pikën e drojës të them se kjo gjë duhet të ndryshohet, këtu duhet të reflektohet, por kam gjithë merakun dhe ndërhyrja ime ishte kjo, që ne të flasim me të vërteta, pa anatemuar dhe pa krijuar një stuhi në gotë, përmes gjysmë të vërtetave. Edhe një herë, pyetja ime është: vërtet mendoni se vetëm ligji do të përmirësojë të gjithë situatën e arsimit tonë të lartë? Vërtet mendoni se ligji ka sjellë përkeqësim? Nëse ligji ka sjellë përkeqësim, më thoni një tregues që ka ardhur i përkeqësuar për shkak të ligjit të ri “Për arsimin e lartë”.

**Albana Vokshi** - Faleminderit!

Me mirëkuptim, të bëjë edhe zoti Boçi pyetjet. Pastaj vazhdojmë me raundin tjetër të pyetjeve.

Po, zoti Boçi.

**Luçiano Boçi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të falënderoj përfaqësuesit e asambleve për panoramën e problematikës ligjore dhe akademike që paraqitën!

Në fakt, bashkohem me ta, ka qenë pjesë e debateve tona të përhershme që në momentin kur është miratuar ligji “Për arsimin e lartë” dhe në vazhdim për të gjitha ato shqetësime që u ngritën, qoftë për financimin e pagave të arsimit të lartë, madje një korrigjim, nuk është 0,5%, por është 0,46%, sikurse edhe problematikat e tjera që lidhen me buxhetin dedikuar arsimit në tërësi. U premtua që edhe ky ligj të vepronte i plotë, se do të rritej në progresion dhe të arrinte 5%, sikurse dhe shqetësimet që janë paraqitur për kapitullin XII.

Unë e kam konsideruar, duke marrë edhe mendimin e pedagogëve dhe të senatit të Universitetit të Tiranës, si pikën fundore të arritjes së qëllimit final të këtij ligji. E gjithë arkitektura ligjore e këtij ligji që nuk funksionon, është për këtë arsye, sepse në fund ka një kapitull që është kontestuar me forcë nga të gjitha universitetet.

Ndërsa për pyetjen që bën zonja ministre, po e quaj kështu se është titull që nuk hiqet, në fakt e gëzon titullin, pyetjen që i bëri në mënyrë të përsëritur trupës së pedagogëve, përfaqësuesve të asamblesë: a mendoni se është ligji “Për arsimin e lartë” ai që ka sjellë pasoja negative? Unë do të thosha se është një lloj sikur të përmendësh “litarin në shtëpinë e të varurit”. Nëse ne themi sot se arsimi i lartë është varur, se pozita e pedagogut është varur, se pozita e studentit është varur dhe për këto arsye ata kanë dalë në protestë si grupe interesi, që doni t’i quani, është pikërisht litari i ligjit “Për arsimin e lartë”. Për më tepër, kur e bën ministrja që e ka firmosur atë, mua më krijohet ajo skena, në mënyrë figurative, e heqjes së stolit të “varjes” së arsimit të lartë. Ishte ministrja ajo që e firmosi ligjin dhe të gjithë i dimë pasojat e ligjit. Në vazhdim, për hir të së vërtetës, dua të përmend disa të vërteta që janë, se Lëvizja për Universitetin, Forumi për Liri Akademike, Senati i Universitetit të Tiranës, senatet e tjera të universiteteve, rektorët e nderuar, të cilët u paraqitën atëherë, nuk kundërshtuan vetëm kapitullin e dymbëdhjetë.

Për fat të mirë, unë kam qenë relator i atij ligji dhe në emër të universiteteve, në vazhdimësi, në një situatë maratonë, kemi vijuar dy net rresht, gati dyzet e tetë orë pa pushim, jam prezantuesi i të gjitha kërkesave të formuluar nga senatet akademike, mes tyre edhe senati i Universitetit të Tiranës. Ishin vërejtje konkrete për nene të caktuara, vërejtje të cilat nuk u morën në konsideratë, por u rrëzuan me forcën e kartonit të maxhorancës.

Pra, në qoftë se këtu u tha që të themi disa të vërteta dhe jo gjysmë të vërteta, unë po e kthej përgjigjen: të mos ecim me gjysmë të vërteta, por të themi të vërteta. Në lidhje me dilemën nëse ajo trupa e nderuar atje e njeh ligjin, hiqeni nga mendja, sepse janë oponentët kryesorë të ligjit “Për arsimin e lartë”. Në qoftë se ne e kemi kundërshtuar atë në terma politikë,

në terma akademike, konkretë e ligjorë, kanë qenë përfaqësuesit e asaj trupës aty, jo me dëshirën për t'i bërë qejfin, po për të thënë ato të vërtetat e pakundërshtueshme.

Duke hyrë në panoramën që paraqitën pedagogët, do të thosha se, pak a shumë, shqetësimet e tyre përmbledhen në katër pika, sipas optikës sime. Shqetësimi i tyre për rrënimin e pozitës publike të universitetit publik, gjë që ka ardhur për dy arsye, në fakt, këtu do të bëj edhe pyetjen, të mungesës së financimit të universitetit publik, të heqjes së mbështetjes shtetërore dhe për arsye të cenimit të autonomisë universitare.

Çështja e financimit. Edhe sot, dhe zonja ministre duhet ta dijë, universitetet publike financohen jashtë ligjit të arsimit të lartë. Nuk financohen nëpërmjet Agjencisë së Financimit të Arsimit të Lartë. Vazhdon një metodë krejtësisht burokratike, që dërgon vetëm një pjesë të buxhetit, i cili përballon vetëm nëntë muaj paga për universitetet. Është e vërtetë se universitetet e kanë humbur atë funksionin jetëdhënës, iluminues, do të thosha unë, dhe janë shndërruar thjesht në ndërmarrje që marrin dhe menaxhojnë para, për të mbajtur frymën gjallë, pa u përqendruar aspak te cilësia e mësimdhënies.

Pjesa tjetër është e autonomisë. Sepse duhet të themi se çfarë kundërshtuan atëherë pedagogët. Zoti Fuga ka thënë në mënyrë taksative: “Ky është një ligj etatist”. Kështu ka thënë, dhe ka kundërshtuar gjithë zinxhirin e VKM-ve të ligjit për arsimin e lartë. Në fillim ishin 46, më pas u bënë 39. Midis tyre, agjencitë që ishin me varësi tërësisht ministrore, politike, sikurse produkti që pedagogët paraqitën si shqetësim, importit të administrimit, që ka një varësi totale nga Ministria e Arsimit, një vendimmarrje totale politike për administrimin financiar të universiteteve, gjë që ministria nuk duhet ta merrte për shumë arsye, dhe që ministria e ka menaxhuar me njerëz aspak ekspertë. Ka çuar drejtorët e saj në Universitetin e Mjekësisë, në universitetet e tjera, dhe sot ne kemi një konflikt të hapur midis trupës akademike dhe bordit të administrimit.

Në fakt, pyetja ime konsistonte në pozitën financiare, dhe pyetjen e kam për panelin e pedagogëve: a keni dijeni në lidhje me buxhetin e universitetit? A është miratuar buxheti i Universitetit, këtë vit? Sepse, shpeshherë pedagogët nuk informohen as për gjëra elementare.

Pyetja tjetër është po për çështjet financiare. Për shkak të një vendimi të qeverisë, vendimi i përgjysmimit të *baçelor*-it, fjalë për fjalë, Kryeministri ka thënë se “do ta rimbursojmë ne universitetin”. Sot, unë e di shumë mire, nga shqetësimet e rektorëve dhe trupës akademike, se universitetet janë drejt falimentimit. Shuma që ato merrnin, u vinte nga xhepat e studentëve, sepse studenti ishte klienti, por nuk u vjen më, kështu që këtë shumë duhet ta rimbursojë qeveria. Qeveria nuk ka një akt, një VKM, që të rimbursojë pjesën e financimit. Pritet që vetëm në korrik të shihet akti normativ, siç ka ndodhur vjet. Por vjet është zvogëluar

buxheti për arsimin, në bazë të aktit normativ, dhe prapë pritet të zvogëlohet, sepse buxheti është parashikim. Në qoftë se të ardhurat nuk mbliidhen, trendi është i tillë, atëherë buxheti godet mjekësinë, arsimin. Pra, a keni dijeni për këtë?

Ndërkohë, në lidhje me vendimin 723, që ishte një nga arsytet e fillimit të protestës së studentëve. Në fakt, protesta e studentëve ishte edhe për pozitën e rrënuar publike të universiteteve publike nga ligji për arsimin e lartë, por le të flasim konkretisht: 723-shi hodhi poshtë vendimin 288, pikën 4, sipas së cilës tarifa për kreditet e studentëve nuk do të paguhej.

Duke qenë se universiteti është bashkëmarrëdhënie me studentët dhe pedagogët, a jeni në dijeni se sot studentët paguajnë kredit për lëndët? Ja ku e kam faturën. Në fakt kam dy fatura, por po paraqes vetëm një: është 4 mijë. I kam mbuluar të gjitha të dhënat e universitetit, sepse normal, do të ruaj personat nga penalitetet që mund t'u vinë. Studenti në fjalë ka paguar shumë përkatëse për kreditet. Ndërkohë, ka një VKM, e cila e anulon këtë lloj vendimi, sepse, për paradoks, nxjerrin VKM për pedagogët dhe VKM-të për veten e tyre nuk i zbatojnë, por thjesht gënjejnë, mashtrojnë, sipas radhës së tyre.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Milva, mos e vërë fare në dyshim, se ta jap edhe me data, do të t'i sjell edhe të dhënat e tjera, i kam shumë të sakta.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Shqetësimi tjetër i pedagogëve ishte hapësira e zvogëluar akademike e pedagogut, e cila lidhet me dy gjëra: me mosvlerësimin e tij financiar. Pagat e pedagogëve tanë janë pagat më mizerabël, në Europë po e po, që s'bëhet fjalë fare, por edhe në rajon. Kjo lidhet edhe me pozitën e tij akademike, e stimuluar shumë nga mënyra e hartimit dhe e funksionimit të ligjit "Për arsimin e lartë", e stimuluar shumë nga sulmet politike.

Mua më vjen keq, por në fakt më vjen edhe mire, edhe keq, se i kam të dyja emocionet, që diskutoj me pedagogët, por në këtë rast më vjen keq se fokusimi i vëmendjes së opinionit publik përqendrohet te pjesa e goditjes që qeveria po u jep pedagogëve, me synimin që gjithë protestën e studentëve ta devijonte si një protestë kundër pedagogëve të tyre dhe kundër universiteteve të tyre, gjë që nuk është fare e vërtetë. Shqetësimet e pedagogëve dhe të studentëve janë të barabarta, janë të njëjta. Ata janë në të njëjtën llogore të betejës së tyre akademike, do të thosha. Nuk është fare betejë politike dhe unë s'kam asnjë iluzion në lidhje me këtë gjë.

Pyetja ime për ju është: përse në kërkesat tuaja nuk parashtroni kërkesën e rritjes së pagës, të vlerësimit financiar të pedagogut? Pse? Sepse ky është elementi thelbësor. Këtu u përmendën shqetësimet. Që një pedagog të bëjë sot një mbrojtje doktorature apo titull



akademik, duhet të paguajë për një artikull në revistat e famshme shkencore, gjë që duhet në fakt, 400 euro. Jo 200, siç u tha këtu, por 400 euro. Paga fillestare e pedagogut është 550 mijë lekë, në kohën kur sapo futet një pedagog me doktoraturë, 550 mijë lekë.

E si mund ta përballojë ai një gjë të tillë?

Tani gjëja tjetër, për të cilën është bërë zhurmë, e që në fakt ka shumë zgjidhje. Unë mendoj se çështja e plagjiaturës është pjesë e debatit akademik, që duhet hapur në universitete dhe duhet trajtuar sipas universiteteve. Vlera e titullit “akademik” është vlera e vetë universitetit, është kredibiliteti i një universiteti. Për mendimin tim, pedagogë të nderuar, studenti asnjëherë nuk pyet se çfarë grade shkencore apo çfarë titulli ka profesori që ndodhet përballë, por vlerëson elokuencën, mënyrën e parashtrimit, dijen që ofron. Nuk pyet fare studenti.

Megjithatë, unë jam dakord që të mos ketë hezitim, por jam gjithashtu dakord që kjo nuk mund të bëhet nga qeveria. Nuk mund të bëhet edhe për një arsye ligjore shumë të famshme, që këta nuk e thonë. Ligji “Për arsimin e lartë” e përcakton, sepse kemi pasur debat shumë të fortë në lidhje me këtë, që titulli akademik është pronësi e universitetit, është pronësi universitare, nuk është pronësi shtetërore. Duke qenë pronë universitare, shteti nuk ka asnjë lloj të drejte të hyjë në vlerën akademike të titullit akademik. Por, vetë pedagogët, vetë universitetet janë të interesuara. Ne kemi pasur një debat, dhe unë e kam kërkuar personalisht një gjë të tillë, që titulli akademik të jetë pronë shtetërore, të vlerësohet në vlerë financiare dhe vlerë morale. Sot i takon universitetit. Ç’punë ka ministria, ç’punë ka qeveria këtu, të hyjë në këtë debat? Debatin për plagjiaturën dhe vlerën reale të titujve akademikë duhet ta bëjnë universitetet. Janë ata që vendosin. Në fakt, a i kanë mekanizmat? Po, i kanë mekanizmat. Ç’janë këto VKM?

E dini se në çfarë situatë absurde jemi ne? Ligji aktual ka katër vjet dhe nuk është plotësuar me VKM-të që detyron ligji. Kryeministri nxjerr VKM, të cilat bien në kundërshtim me ligjin. Po kjo është situatë për të vënë duart në kokë. Është situatë e çmendur, për mendimin tim, sepse sot universitetet i kanë mekanizmat: Këshilli i Etikës... Do të thosha se, por me këtë rast kam pyetje për ju, profesor: a keni dijeni për këshillat e përhershëm, që sipas ligjit “Për arsimin e lartë”, a duhej të ishin ndërtuar në rang universiteti dhe në rang fakulteti? Bëhet fjalë për Këshillin e përhershëm të Etikës, Këshillin e promovimit të stafit akademik, të cilët janë shumë të rëndësishëm për kriteret e trajtimit të plagjiaturave, si dhe Këshillin e Përhershëm për Promovimin e Titujve Akademikë, që janë shumë të rëndësishëm. Sepse kemi pasur një debat në momentin që doli rregullorja e zgjedhjeve, pasi këto institucione të parashikuara në ligjin

“Për arsimin e lartë” ishin të përjashtuara dhe nuk u zgjodhën asokohe me votën e asambleve, gjë që duhet sqaruar.

**Albana Vokshi** – Luçiano, të lutem!

**Luçiano Boçi** – Po. Vetë asambletë krijohen në momentin e bërjes së zgjedhjeve në universitete dhe të gjitha asambletë janë formësuar, prandaj dhe reagimi im ishte i tillë në atë moment, dhe vazhdojnë të funksionojnë duke u mbledhur me një të tretën ose nëpërmjet dekanit, sipas rregulloreve.

Pra, për pedagogët VKM-të janë kompilime të rregullave, të këshillave, të akteve nënligjore, që i kanë vetë universitetet në statutet e në rregulloret e tyre, madje edhe në ligj. Prandaj, ato nuk duhej të ishin hartuar të tilla, sepse bien në kundërshtim dhe janë në alogjizëm total me linjat që ka ligji, i cili kontestohet, por kjo s’do të thotë se duhet të pjellim VKM që kontestojnë vetë ligjin, që bien në kundërshtim me vetë ligjin.

Pra, pyetjen time për këtë pjesë e bëra të qartë...

**Albana Vokshi** – Përmbylle, të lutem!

**Luçiano Boçi** – ...ndërkohë që shqetësimi i tretë i pedagogëve është pozita e sotme e rrënuar e studentit, për shkak të mënyrës së trajtimit të tij. E thanë pak a shumë pedagogët, e në fakt unë do të doja të ishte e theksuar më fort në ligjërimin e tyre, që pozita e studentit është pozita e një klienti, që hyn nga dera e parme dhe del nga dera e pasme e universitetit, i cili bën luftën e tij për mbijetesë, për të siguruar vetëm pagesën. Pse është e tillë? Sepse e tha edhe profesor Shezo, vetë Marrëveshja e Bolonjës e përcakton qartë që vërtet masteri nuk është privilegj, por thjesht çështje mobiliteti. Kur e konsideron privilegj, kjo do të thotë se shteti heq dorë nga subvencionimi. Jo. Është pjesë integrale e diplomës së arsimit të lartë. Është një profilizim i domosdoshëm. Si universitete, të gjithë e kemi firmosur marrëveshjen e Bolonjës, ndaj duhet ta respektojmë atë në detaje, por ligji bie në kundërshtim me Marrëveshjen e Bolonjës. E kemi trajtuar atëherë, por e kanë trajtuar edhe pedagogët në dëgjësat e tyre.

Unë kam një pyetje në lidhje me studentët: si mendoni ju në lidhje me rolin që kanë kërkuar studentët në vendimmarrjen universitare? Kanë kërkuar një shifër pak të madhe, 50 %, por unë kam një trajtim për atë 50-përqindëshin. Sot universitetet shqiptare janë të vogla dhe krijojnë mundësinë e përsëritjes së trupës drejtuese, sepse departamentet janë të vogla, njohjet, nepotizmi social luan rol te ne. Për t’i shmangur këto, pse të mos e rrisim pak aktivizimin e studentëve që janë pjesë kalimtare, por ama më objektivë në gjykimin e tyre për pedagogët? Pra, si e mendoni ju? Është çështje që lidhet me mendimin tuaj. Si zgjidhet çështja e trajtimit financiar të studentëve në lidhje me masterin, për ato mastera që kanë qenë pjesë e shqetësimeve tona, të retorikës sonë politike. Janë më të mëdhatë jo vetëm në rajon, por madje

edhe në Europë. A duhet të marrin subvencion nga shteti apo jo, dhe në cilat forma duhet ta marrin këtë subvencion?

Problemi i fundit, se ndoshta u zgjata, më falni, janë problemet e cilësisë së mësimdhënies e të komunikimit akademik. Pajtohem plotësisht: janë prishur të gjitha marrëdhëniet. Të paktën nga përvoja ime si pedagog, nga ajo çfarë komunikohet sot në aulat universitare, jemi shndërruar thjesht në ca persona që kryejmë formalitete. Sepse puna e pedagogut, e akademikut, ka brenda pasionin, ka kërkimin shkencor, por pasioni dhe kërkimi shkencor janë interkomunikim me aulën, me studentët. Unë them se është prishur për ato arsye që u paraqitën.

Ndërkohë, në lidhje me çështjen e kurrikulës, e cila është pjesë e problemit, që e paraqiti edhe zoti Prifti, me mendimin e të cilit bashkohem, përbashkësia e kurrikulave, shumë mirë që qeveria e ka pasur në vëmendje, por ministria duhet të dijë një gjë: është detyrë e vetë universiteteve që të barazojnë kurrikulat, sepse Marrëveshja e Bolonjës detyron që 70 % e kurrikulës bazë të jetë e barabartë. Pse s'e kanë bërë? E dini pse s'e kanë bërë? Sepse nuk ka funksionuar Konferenca e Rektorëve, sipas meje, sepse nuk u janë dhënë kompetenca Konferencës së Rektorëve.

Si mendoni ju se zgjidhet ky problem, pa ndërhyrjen e ministrisë, sepse është problem krejtësisht i pastër akademik dhe universitar?

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Ngaqë janë bërë shumë pyetje, mund edhe t'i përmbledhni dhe t'i ndani pastaj sipas dëshirës.

Po, zoti Marku.

**Mark Marku** – Ne e kemi pjesë të metodologjisë, që ta vlerësojmë tjetrin edhe nga pyetjet, e në këtë kuptim është aftësia juaj që shprehni vlerësimin përmes pyetjeve. Unë do t'ju përgjigjem shkurt.

Në fillim katër-pesë pyetjet e para, e pastaj do të flasim kolegët.

Zoti Fadil bëri katër pyetje. Pyetja e parë: a keni marrë pjesë dhe a keni debatuar për ligjin “Për arsimin e lartë”?

Po, është e vërtetë që kemi debatuar, është e vërtetë që kemi marrë pjesë në një mënyrë shumë konstruktive dhe shumë kritike. Universiteti është shumë plural, për fat të mirë. Të gjitha fakultetet e Universitetit të Tiranës dhe të gjitha institucionet kanë qenë kundër ligjit “Për arsimin e lartë”; kanë dhënë një mal me vërejtje dhe me alternativa për zgjidhjen e tyre.

Është e vërtetë se ka pasur komunikim shumë normal nga ana e ministrisë dhe sipas gjykimit tim, falë këtij komunikimi normal nga ana e ministrisë, komunikim në kuptimin njerëzor, është shtyrë shpërthimi dy a tre vjet.

Nga ana tjetër, me sa kam vënë re, problemi ka qenë se përtej ministrisë, përtej shumë personave që do të duhej të merreshin me ligjin, përtej këtyre ka qenë një fuqi e cila, praktikisht, i ka penguar edhe këta që të marrin parasysh të gjitha vërejtjet. Kjo ka të bëjë me filozofinë e trajtimit të sektorit publik, filozofinë e arsimit publik, me delirin e disave që mendojnë se dinë gjithçka, por parimi ynë është: “Në momentin kur mendojmë se dimë gjithçka, s’dimë asgjë”.

Pra, mendoj se kanë qenë disa elementë përtej këtij komunikimi, që e kanë bërë të pamundur që komunikimi të ishte produktiv. Meqenëse po them se ka qenë shumë njerëzor, e meqë e kemi ministren këtu, gjejmë rastin ta falënderojmë. Ne kemi qenë kritikët më të mëdhenj të ligjit, por ama kemi komunikuar në mënyrën më normale me ta.

Pyetja e dytë: “Kërkoni të anulohet ligji apo kërkoni të vazhdojë”.

E thashë: ne e dimë shumë mirë, e edhe te kërkesat tona themi se kërkojmë që të shprehet vullneti për ndryshimin e ligjit. Kjo sepse e dimë shumë mirë që ky ligj nuk mund të anulohet, pra, nuk mund të anulohet menjëherë, sepse do të krijonte vakuum ligjor, por në momentin që shprehet vullneti, më pas hapet procedura për një ligj të ri.

Këtë kërkojmë ne dhe kërkojmë që të mos bëhet në mënyrë mekanike, siç është bërë tani. E para, ne duhet të përcaktojmë modelin. Në universitet, në asambltë e fakulteteve, është kërkuar që fillimisht të bëhet debati për modelin e arsimit publik që kërkojmë, më pas një debat gjithëpërfshirës me të gjithë aktorët. Jo vetëm me ne, por me të gjithë aktorët, që të krijohet modeli i universitetit publik që kërkojmë, një universitet i orientuar drejt të mirave materiale dhe jo e konsideruar si e mirë publike.

Në këtë kuptim, ne duhet të diskutojmë për modelin, pastaj të bëhet ligji. Kjo kërkon kohë. Në këtë kuptim, qeveria s’ka pse të frikësohet, sepse ne nuk vëmë afate për një ligj të mirë.

Pyetja tjetër ishte: “Jeni minorancë apo shumicë?”

I nderuar deputet, ne jemi minorancë, jemi krenarë që jemi minorancë dhe shqyr që jemi minorancë, sepse jemi profesorë. Jemi minorancë, por jemi përfaqësues. Pse? Flas në raport me Universitetin e Tiranës. Me këtë qëndrim kanë dalë katër asamble të Universitetit të Tiranës, ka dalë senati i Universitetit të Tiranës. Kësisoj, Universiteti i Tiranës është në minorancë akoma edhe sot e kësaj dite në qëndrimin kundër ligjit dhe kundër VKIM-ve.

Në këtë rast ne shprehim vullnetin e maxhorancës. Edhe sikur të isha një, në momentin që mendoj se kjo është e nevojshme për ta shprehur, unë e shpreh, pa marrë fare parasysh nëse

janë një, dy, tre apo katër. Ia thamë edhe ministres së re të Arsimit. Për fat të mirë, është një filozof i komunikimit që thotë se në kërkimin shkencor nuk ka rëndësi vota e shumicës, sepse po të ishin votuar formulat e Ajnshtajnit, do të ishin rrëzuar edhe nga komuniteti i ngushtë shkencor. Të gjithë ishin kundër, e madje me ta u përfshi edhe shkencëtari më i njohur gjerman. Po të ishte votuar dhe të ishte marrë vendimi i shumicës, të gjitha do të kishin rënë poshtë. Pra, ideja është se në shkencë, në fushën tonë, nuk funksionon populizmi, shumica e të tjera. Edhe një, edhe dy, edhe tre. Kini parasysh Galileo Galilein, s'po bëjmë paralelizma, se s'jemi delirantë, por të gjithë ishin kundër, ndërsa ai tha se Toka rrotullohet. Doli se Toka rrotullohet.

Pra, jemi në një fushë ku shumica s'është e domosdoshme. Madje, këtë s'e kërkojmë fare, nganjëherë as na intereson fare të jemi shumicë, as nuk duam të jemi shumicë. Po të jemi shumicë, do të vija në dyshim veten, se jemi konformistë, se po shkojmë drejt atyre që kërkojnë gjëra të lehta e të tjera. Pra, në këtë rast jemi, fatkeqësisht jemi.

Një pyetje prej zonjës ministre. E kemi thënë disa herë se normalisht ka një sërë problematikash, që dalin përtej ligjit, që edhe janë trashëguar, por ky duhej të ishte ligji që do të reformonte arsimin e lartë. Nuk themi se është i vetmi problem, por ky ligj nuk u jep përgjigje problemeve të reformimit të arsimit të lartë, ashtu siç do të duhej të ishte arsimi i lartë në këtë moment që po flasim. Madje, një ligj parashikon minimumi edhe për dhjetë vjet.

Ky ligj nuk i bën këto. Jo se në Shqipëri nuk ekziston mundësia për të bërë një ligj të mirë, sepse ka pasur ligje shumë të mira, por sepse nuk ka qenë vullneti, kam përshtypjen edhe përkundër titullarëve të shtetit shqiptar apo përfaqësuesve politikë, të cilët në heshtje kanë menduar se ky ligj nuk është ligji i duhur. Mendoj se grupe të caktuar interesi, në kuptimin negativ siç thatë ju, kur bëtë insinuata, kanë ndikuar që ky ligj të jetë i tillë.

Kaq për këto pyetje.

Në lidhje me pyetjet e tjera e kanë fjalën kolegët.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

**Altin Shegani** – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë do të doja t'i përgjigjesha shkurtimisht vetëm dy pyetjeve, e pastaj në funksion të ecurisë.

“A keni marrë pjesë në debatin mbi ligjin dhe si keni reaguar?”, të deputetit Nasufi.

I nderuar zoti deputet!

Personalisht, jo vetëm, sepse ky s'është ndonjë monument i qëndresës historike e juridike, por është një detyrim për çdo akademik, kam marrë pjesë, ndjehem i lumtur që jam përfshirë në debat. Personalisht bëj pjesë ndër ata, e këtë duhej ta thosha se jo vetëm për këtë ligj, që i kam kundërshtuar edhe ndryshimet e ligjit të mëparshëm nr. 9832 datë 12.11.2007 me

gjithë ndryshimet e viti 2007 dhe 2011. Kjo është mediatike, janë të ruajtura gjërat, kështu që për fatin e mirë mund t'i konsultoni. Me këtë dua të them që këtë e bëjmë jo si grindavecë universitarë, por të shqetësuar për fatin e universitetit në Shqipëri dhe besoj se kjo duhet të mirëkuptohet si një e mirë publike dhe si një përgjegjësi sociale. Mosnjohja të një njeri është më e madhe se njohja, dhe kjo besoj është mënyra më e mirë për të kuptuar se duhet lexuar dhe mësuar më shumë. Këto që thashë i kam thënë në mënyrë luajale, si shprehje e vlerësimit të kolegëve të mi. Kështu që në këtë pikë nuk ndaj as veten time nga pikëpamja e produktit. Unë personalisht di diçka, por mendoj se kolegët që unë përmenda, të Departamentit të së Drejtës Civile, dinë shumë më tepër nga shumë njerëz, të cilët u angazhuan dhe punuan për të formësuar detajet e ligjit të arsimit të lartë aktual në Shqipëri, i cili që nga 5 tetori i vitit 2015 është në fuqi dhe ushtron efektet e veta juridike.

Sa i përket pyetjes së zonjës Nikolla, a është ligji mekanizmi i vetëm, që ne kontestojmë se rregullon situatën, sigurisht që jo, nuk është vetëm ligji, por unë mendoj se ligji është mekanizmi kryesor që orienton rregullimin e procesit, kështu që, nëse nuk rregullohet ligji dhe formësohet drejt, nuk ka se si të jenë të mira aktet nënligjore që dalin në bazë dhe në zbatim të ligjit. Këtu është thelbi. Autonomia, të cilën e përmendën disa deputetë të nderuar, është atribut kushtetues, nuk është atribut i ligjit, sepse edhe po të mos e thoshte ligji, do të zbatohej Kushtetuta si akti më superior juridik me përparësi dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, kështu që problemi është të mos konceptohet sikur universitetit i është dhënë ndonjë gjë që nuk ekziston dhe që nuk e meriton, por të konceptohet që janë të drejta, të cilat në Europë janë fituar me luftë të madhe. Në fakt, ne sot kemi modele dhe rrugë të shkelura, të projektuara, që jo se kalojnë pa debate, por që mendojmë se janë ligje që ofrojnë sigurinë juridike dhe një garanci të mëtijshme për të ecur para në fushën e arsimit. Arsimi nuk është i lehtë. Unë e di që ne flasim para një grupi të nderuar deputetësh, që vijnë nga mësimdhënia. Ju i dini sfidat që ka arsimi. Absolutisht askush nuk thotë që ne nuk jemi pjesë e problemeve. Edhe komuniteti ynë ka problemet e veta, të cilat as nuk kemi dashur t'i fshehim, nuk e kemi thënë kurrë këtë gjë, por të paktën kërkojmë që nëpërmjet një mekanizmi rregullator efektiv të mund të ecim në rrugën për t'i përmirësuar gjërat.

Ky ka qenë dhe është të paktën thelbi i asaj çka unë përfaqësoj në emër të kolegëve të mi, aspak për të bërë një lloj figure tjetër, që ju mund ta hamendësoni në kuptime nga më të ndryshmet, por e thashë këtë për të qenë luajal që gjithmonë kemi qenë kritikë, edhe pse shpeshherë në minorancë, edhe për këtë ligj, por asnjëherë kurrësi për të pasur një sens arrogance ose presioni për të influencuar opinionin publik ose segmente të veçanta të ligjbërjes. Nuk ka qenë ky qëllimi ynë.

**Jani Marka** - Fillimisht do të ndalem te pyetja e zonjës Nikolla, se çfarë ka shkaktuar ligji. Ligji, në fakt, ka kthyer në sistem ligjor problemet e vjetra që ka gjetur. Ne të gjithë jemi të mendimit që problemet janë të thella dhe në disa dekada, por ama ky ligj ka shpikur edhe probleme të reja, që nuk kanë qenë më parë. Po ju sjell disa shembuj shumë modestë. Mua më kujtohet që në vitin 2007-2009 procesi i doktoraturave u pezullua. Pezullimi ndodhi edhe me ligjin aktual, zhbllokimi i doktoraturave ende nuk ka filluar. Tani, do të thoni ju se 3 vjet e gjysmë janë pak, por, në fakt, nuk janë hiç pak dhe, po të bëjmë llogari, është një humbje e jashtëzakonshme kohe dhe energjish.

Gjithashtu, tarifat e masterit në përgjithësi po rriteshin, ligji i bën edhe më sistemike, duke e liberalizuar masterin, siç u fol këtu.

Burokracia ka qenë mbytëse në universitet dhe ky ligj e bën edhe më mbytëse.

Të gjitha këto që citova janë probleme të vjetra, ndërkohë ligji shpik edhe probleme të reja. Për shembull, më përpara nuk kemi pasur hallin si do t'i ndanim paratë publike me universitetet private, gjë që shfaqet në ligjin e ri.

Së dyti, mendoj se duhet ta dëgjoni këtë, të nderuar deputetë, në një shkrim te revista "Monitor" kam lexuar se në bazë të një studimi, 30-vjeçarët me arsim të lartë në Bashkimin Europian janë 40%, në Serbi 30%, në Bosnje 23% dhe në Shqipëri 21%. Pra, kujdes kur flasim për masivizimin, sepse jemi ende larg standardeve që duhet të kërkojë një shoqëri për një treg pune, që përdor dijen dhe jo krahun, por ama biem dakord që ky masivizim, i pashoqëruar me rritje të financimeve dhe të investimeve, ka shkaktuar shumë probleme në universitet.

Së treti, sa i përket pyetjes së zotit Boçi për votën e studentëve, ne mendojmë se zgjedhjet dhe qarkullimi i elitave ka qenë shumë problematik dhe ju shumë mirë i dini shembujt se si qarkullonin dy herë dekanë, dy herë rektorë, prapë dekanë e rektorë. Kështu që, unë mendoj se një trupë më e madhe zgjedhore, siç janë studentët, mund ta rregullojë këtë. Ndoshta juve ju duket shumë 50%, por ama mund të bëni diçka tjetër, për shembull, vini një dysHEME, vendoseni 20%, me të drejtën që të jenë vetë universitetet që ta shfrytëzojnë autonominë si të duan. Mund të ketë universitete të Tiranës ku asambleja e pedagogëve dhe studentëve e vendos në 40%, një universitet tjetër mund ta ruajë më ndryshe.

Unë mendoj se është ligji problemi, zonja Nikolla. Natyrisht ligji nuk do t'i zgjidhë të gjitha, por një ligj me një frymë tjetër dhe, mbi të gjitha, i shoqëruar me financim të konsiderueshëm për arsimin e lartë, mund të jetë e vetmja mundësi. Një ligj tjetër, sado i mirë që të jetë në letër, i pashoqëruar me financim, prapë do të na sjellë në këtë komision.

Kam edhe një koment politik, për sa kohë do të vazhdojë konfliktualiteti i zgjatur mes jush, fatkeqësisht, jo arsimi i lartë, por as shoqëria në përgjithësi nuk mund të ketë të mira.

Ndoshta konflikti duhet, se ndonjëherë i zgjidh problemet, por, nëse vazhdon gjatë ky konflikt, vendi do të boshatiset nga të rinjtë dhe nga intelektualët, siç e citoi kolegu.

**Rezart Prifti** - A mund të bëj dy komente?

E di që është kohë dreke dhe, siç thotë Masta, filozofi me barkun bosh nuk bëjmë dot, por dua të sqaroj diçka për titujt akademikë, që është kërkesë e studentëve. Dua të sqaroj, sepse thuhet që ne nuk duam që të na shikohen titujt akademikë. Ne me qejfin më të madh e mirëpresim këtë, të fillojë nga unë. Unë nuk e kam problemin e kujt është kërkesa, nuk ka rëndësi, por mjafton të bëhet një proces i mirë, kështu që nuk po hyj fare ta diskutoj këtë punë, sepse nuk jam kundër.

**Mark Marku** – Po abuzohet shumë me këtë. Së pari, përdoret për një lloj propagande, për të denigruar të gjithë pedagogët.

Së dyti, është e paligjshme, nuk është problemi se kemi frikë, se unë personalisht nuk e kam bërë këtë, por është njëlloj sikur të më thotë dikush aty jashtë, profesor, do të të kontrolloj xhepat, sepse mendoj se ti ke vjedhur. Unë them jo, sepse është e paligjshme. Është më e rëndë shkelja e ligjit. Unë jam i sigurtë se në xhepat e mi kam vetëm paratë e mia, por nuk lejoj dikë që të më thotë që do të të kontrolloj xhepat, për të treguar se jam i ndershëm. Jo, trego një herë xhepat e tu. Do të kisha shumë dëshirë që Kryeministri të tregonte xhepat para nesh, të tregonte ndershmërinë e vet, të tregonte koston e pallatit në Surrat, të pranonte vetingun e politikanëve. Pse e refuzuat vetingun e politikanëve ju? Sepse është e paligjshme, sepse kemi sistem drejtësie, jemi në shtetin e së drejtës, kjo ishte logjikë e saktë. Edhe unë isha kundër, por do të duhej që në të njëjtin raport të jemi edhe ne. Jemi në shtetin e së drejtës dhe nuk mundet që një kategori tjetër, ku korrupsioni është një milion herë më i ulët, më i reduktuar se në politikë, aty nuk pranohet për veten, sepse i qëndrojmë një logjike. Kjo nuk është pse kemi frikë ose sepse nuk duam, por është e paligjshme dhe duhet gjetur një formë ligjore që të bëhet ajo. Ne pranojmë gjithçka që bëhet me ligj.

**Albana Vokshi-Zoti Prifti.**

**Rezart Prifti**- Shumë shkurt do t'i përgjigjem pyetjes, nëse kemi marrë pjesë ne te hartimi i ligjit. Të them të drejtën, në fillim na dërgohej një draft në orën 22:00, ku na thuhej, ju lutem, nesër në mëngjes na jepni përgjigje, a thua se do të flinim me ligjin ne, jo me Maliqin. Kjo u bë qesharake. Të dërgohet në darkë dhe të kërkojë të marrësh mendimet në mëngjes, nuk shkon. U pa se ishte një proces fiktiv, këtu nuk ia vë fajin ministres, se nuk ka pasur lidhje, ka qenë faji i autoriteteve universitare, por ka qenë edhe një gjë tjetër, nga krahu tjetër paguheshin një qerre me njerëz për të bërë atë punë, ndërsa ne duhej ta bënim këtë punë qyl, si përherë. Pra, kjo nuk shkon.



A kërkojmë ne, si përfaqësi, debat? Ne kërkojmë debat, sepse ne gjatë të gjithë kohës komunikim kemi kërkuar, por unë nuk mund të kem debat me dikë që ka asimetri informacioni me mua, sepse nuk është debat. Unë kështu prapë kaloj në pozicionin e lektorit t'i shpjegoj komplet procesin, t'i shpjegoj si janë konceptet, pastaj të hyj në debat. Unë dua debat me njerëz që i japin dum asaj pune.

Sa i përket pyetjes nëse është përfshirë arsimit privat, kjo nuk është puna ime që të mbroj fokusin e arsimit privat, të llobojnë vetë, instrumentet i kanë më të fortë se ne dhe nuk është ndonjë gjë për t'u diskutuar, për mendimin tim.

Sa i përket pyetjes nëse është vetëm ligji problemi, të cilën e bëri zonja ish-ministre, të them të drejtën, këto kohë që jam duke u marrë me këtë punë, më ka kushtuar shumë në sensin profesional, sepse çoku bëjmë edhe ndonjë punë private, por po marr prapë rrezikun t'i them që jo, nuk është vetëm ligji, madje ne të dy e dimë shumë mirë që ligji në pjesën më të madhe të IAL-ve nuk është implementuar fare. Nuk e kanë miratuar, kështu që po vazhdojmë me karrocën e vjetër.

Sa i përket buxhetit të universitetit, na erdhi një e-mail para disa ditësh dhe na thoshte që jepni sugjerimet tuaja, se do të miratohet buxheti atje lart. Për shembull, elementi i parë: sa tonerë ju duhen, bojë printer; elementi i dytë: kompjuter, PC, ose desktop, se ai debili që e ka shkruar këtë nuk e ka ditur se janë të tre njësoj, siç duket e ka marrë *copy-paste* diku. Më pas, kërkohej nëse kemi ndonjë projekt. Unë kam 4 vjet që sugjeroj të njëjtin libër për t'u miratuar, kam disa vjet që sugjeroj të njëjtin projekt *copy-paste* dhe më e forta është se aplikohet projekti, miratohet, medemek, sikur është i mirë, por është e pamundur që nga ana ligjore pedagogët të shpërndajnë fondet. Kjo sa i përket pjesës ligjore.

Sa i përket shkakut të mungesës së rimbursimit, shpërndarja e rimbursimit është pjesë ligjore, sepse kur ikën me vrap të bësh VKM-të, harron që nuk ke bërë gjëra të tjera dhe faktikisht mungesa e rimbursimit është idiotllëk total, sepse ai thotë se duhet të presësh të miratohet kjo që të kalojë ajo. Kështu që është budallallëk juridik.

Sa u përket krediteve, janë disa fakultete që e kanë aplikuar atë. Disa nuk e kanë marrë guximin që ta aplikojnë pagesën për kreditet e studentëve. Kërkesa e rritjes së pagës ka kohë që po qëlon nën zë, duke marrë parasysh se protesta e parë e suksesshme e institucionit të arsimit të lartë ka qenë ajo e dyfishimit të pagës, nga 300 mijë lekë në iks lekë, mirëpo ka një kompromis midis sistemit të brendshëm dhe atij të jashtëm. E keni parasysh eksperimentin e bretkosës, që kur hedh një bretkosë në tenxhere ajo kërcen direct, ndërsa kur e lë të ngrohet, avash-avash, ngordh brenda dhe nuk e ndjen ndryshimin? Edhe institucionet tona janë brenda në tenxhere, po vlojnë aktualisht. Duke qenë se kjo punë është bërë tërhiq e mos e këput nga

krahu i pagesës, unë kaq po marr, nga krahu tjetër i llogaridhënies mos më kërko më llogari, se po bëj edhe ndonjë punë tjetër, ndaj dhe nuk ka presione të mëdha për çështjen e rritjes së pagesës. Kjo është edhe çështje ambicieje.

Së fundi, këshillat permanentë në fakultete deri tani nuk kanë ekzistuar fare. Të gjitha procedurat janë bërë me çudibërje.

Sa i përket çështjes së vendimmarrjes së studentëve, unë nuk jam dakord për 50%-shin, për arsye të pastra menaxheriale. Duke qenë pedagog i menaxhimit, nuk mund të lejoj që objektivat afatshkurtra të kenë konflikt kaq të madh me objektivat afatgjata. Vizionin që kam unë për një institucion, nuk mund ta ketë një student që është në vit të parë ose të dytë. Po është e vërtetë që ka nevojë për mbi 10%, sepse në fund të ditës edhe ata janë pjesë e jetës së fakultetit për 5 vjet dhe nuk janë pak, por 50% nuk më duket e arsyeshme. Po të bëjmë disa llogari, ne, si intelektualë, mund t'i japim një peshë përfaqësimit të studentëve, por gjysmë për gjysmë nuk e shoh të arsyeshme.

Sa i përket çështjes së trajtimit financiar për masterin, këtu dua të jem pak konfliktual, sepse unë kam një pikëpamje tjetër për pjesën e masterit. Unë e shikoj masterin nga ana anglosaksone, siç jam trajnuar edhe vetë. Masteri të jep avantazh konkurrues në treg, qoftë në administratë, qoftë në privat dhe kryesisht masterin nuk e bëjnë, siç bëhet në Shqipëri, që meqë i hyra 8-vjeçares, do të bëj edhe të mesmen; meqë i hyra të mesmes, do të bëj edhe *bachelor-in*; meqë bëra *bachelor-in*, do të bëj edhe një master, më mirë. Unë mendoj se duhet rritur më shumë çmimi i masterit, por jo me këto masterë që ofrojmë ne aktualisht, sepse janë deficiente, sepse masteri duhet bërë 4 mijë, edhe 5 mijë euro. Nëse doni që ndonjëherë kur të mblidheni të diskutojmë pak më me baza, kemi bërë një studim para disa kohësh me disa kolegë të mi, që deshën të hapin një universitet privat, për të ofruar vërtetë çështje që kanë nevojë firmat dhe kishte kërkesa për masterin, sidomos për NBI-në. Pra, ishte e përballueshme që të paguhej nga 8 mijë dollarë në 12 mijë dollarë. Pra, tregu ynë në bazë të studimit, e mban pagesën 8-12 mijë dollarë të masterit.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Po, zoti Shegani.

**Altin Shegani**- Në lidhje me pyetjen se pse duhet të financohet masteri, unë do ta nis nga një model i fakulteteve juridike. Aktualisht, nëse do të mbarosh vetëm programin trevjeçar, për programin *bachelor* në drejtësi, sigurisht që në këtë treg pune që ne kemi sot, nuk ka mundësi integrimi. Kështu që në planin konkret, një master është mënyra e vetme për të shkuar ose në avokati, ose në magjistraturë, ose në noteri. Pra, është e pamundur që në disa gjëra

specifike të mos kërkohet kjo dhe unë mendoj që masteri duhet të financohet, prandaj absolutisht që duhet mundësuar kjo.

Gjithashtu, ka dy vjet që në ligjin e arsimit të lartë është projektuar një program 5-vjeçar për Fakultetin Juridik, në kuadrin e të qenit profesion i rregulluar, por ka dy vjet që ai program nuk është i implementuar ende në bazë të kërkesave të këtij ligji. Kështu që unë mendoj se duhen financuar edhe studentët e masterit.

**Mark Marku** – Kjo ka të bëjë edhe me sistemin. Sistemi universitar quhet i plotë në sistemin 3 plus 2, sepse ka lidhje me kartën e Bolonjës. 4-vjeçari është bërë 3 plus 2, që do të thotë ajo që ka qenë diplomë e integruar 4-vjeçare, sot është bërë 5-vjeçare, veçse me mundësi fleksibiliteti 3 plus 2, ose 4 plus 1, ose 4 plus 2, në mënyrë që t'i përgjigjet tregut të punës. Pra, kjo nuk e përjashton që të jetë pjesë e sistemit.

Kolegu im tha se ka përvoja që për masterin paguhet më shumë, por po flasim për një sistem publik dhe për këtë model duhet diskutuar fillimisht. Në Francë modeli publik e përfshin edhe doktoraturën, e cila futet te sistemi i financimit publik, sepse ashtu e kanë modelin, të cilit i qëndrojnë. Unë aty kam paguar 318 euro. Këtu paguhet 2 mijë euro. Pra, në momentin që përcaktohet modeli edhe sistemi nuk mund të kuptohet pa minimumin plus 2.

Tani sa i përket ndihmës financiare, ajo nuk është ndihmë meritokracie. Ndihma që jepet për arsimimin në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin është ndihmë sociale, siç jepet në të gjitha vendet europiane, që do të thotë, t'ia japësh kujtdo, varësisht të ardhurave. Investimet që bëhen për meritën janë tjetër gjë. Çdo shtet social në Europë jep ndihmë që nuk mbështetet mbi meritën, por mbi nevojat sociale; pastaj vendosën kriteret që, nëse nuk merr numrin e krediteve, nuk e merr vitin e dytë ose nuk merr këstin e dytë.

Më falni, kisha edhe diçka në lidhje me pyetjen që u bë për buxhetin. Ne para një jave kemi kaluar buxhetin e fakultetit. Na është thënë që nuk ka ardhur asnjë lek në universitet, po bëjmë një buxhet provizor, nëse nuk vjen buxheti deri në mars, gjë që ka shumë gjasa të mos vijë. Në fakt, një ministër ka marrë në patronazh një universitet, por ata kanë ardhur deri tani pa lekë.

**Albana Vokshi** – Një ministër ka marrë në patronazh një universitet?

**Mark Marku** – Një ministër ka marrë në patronazh një fakultet.

**Albana Vokshi**- Kjo në lidhje me autonominë universitare?!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

**Mark Marku** – Deri tani ajo çfarë ka ardhur në universitet, janë vetëm vendime dhe disa policë me bark të fryrë, përkundër urdhrin të ministrit Lleshaj dhe asgjë tjetër. Nëse nuk vjen buxheti deri në mars, universitetet kalojnë në falimentim total.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Ju lutem, bëni vetëm pyetje, sepse e kemi kaluar kohën.

**Valentina- Duka** – Falënderoj kolegët që kanë ardhur këtu!

Unë bashkohem me Markun, sepse kam qenë pjesë me të në diskutimet për ligjin e arsimit të lartë. Fakulteti i Filologji- Historisë ka qenë pararojë e diskutimeve të mëdha. Duhet ta themi se kemi qenë të lirë të diskutojmë çdo gjë në lidhje me ligjin e arsimit të lartë. Ka qenë një nga ligjet për të cilin është diskutuar dhe debatuar më shumë se çdo gjë tjetër në Universitetin e Tiranës. Por në ndryshim me atë që mund të ketë thënë rektori i universitetit të asaj kohe, te diskutimi përfundimtar, pjesë e të cilit kam qenë edhe unë, senati i Universitetit të Tiranës ka pasur disa objeksione kryesore për ligjin e draftuar. Së pari, nuk ishim dakord për filozofinë e financimit, pra për modelin ekonomik që ligji ekspozonte; së dyti, ishim kundër kapitullit 12 të ligjit; së treti, ishim kundër ekzistencës së tri kokave drejtuese të universiteteve, që po e çojnë në një kolaps të madh universitetin dhe, së katërti, ishim kundër krijimit të 5 agjencive të varura nga Ministria e Arsimit, të cilat burokratizonin të gjitha çështjet që lidheshin me arsimin e lartë.

Asnjë nga vërejtjet tona nuk u reflektua në ligjin përfundimtar dhe unë mendoj se arsyeja kryesore e mbushjes së Tiranës dhe të të gjitha qendrave të qyteteve universitare ka qenë efekti financiar i ligjit të arsimit të lartë. Studentët mund të mos i dinin dispozitat e ligjit, por, kur familjet e tyre të ndjenin efektet financiare, kemi thënë që studentët do të dalin në rrugë. Sigurisht që ngritën edhe çështje të trashëguara, siç ishin konviktet, karta e studentit e të tjera, por ligji presupozonte dhe u prodhua nga ju që të rregulloheshin edhe gjërat, që para vitit 2013 nuk u bënë siç duheshin.

Bashkohem me sugjerimet e kolegëve të mi që sot është koha për një debat të madh publik për çështjet e arsimit në përgjithësi dhe të arsimit të lartë në veçanti. Duhet që politika dhe shoqëria ta shohin arsimin si çështje kryesore të sigurisë kombëtare, se, përndryshe, jam dakord me zotin Prifti, unë e kam dëgjuar që një pjesë e madhe e pedagogëve të universiteteve publike po bëhen gati të lënë vendin. Në qoftë se ata, ashtu siç janë, largohen dhe universitetet publike mbeten me më pak pedagogë të kualifikuar, atëherë kjo është një çështje që e dëmton jashtë mase sigurinë kombëtare.

Dëshiroj t'ju them se në kohën kur hartohet ligji, edhe pedagogët, kolegët tanë që ishin pjesë e grupit të punës, ne që e kundërshtonim na quanin anakronikë, sepse na konsideronin si pedagogë që nuk i njihnim eksperiencat europiane. Dua t'ju them diçka, sepse tani e shoh këtë edhe nga perspektiva e ligjvënësës. Në Shqipëri është bërë traditë që një pjesë e ligjeve që funksionojnë shumë mirë në Angli, në botën anglosaksone apo në Europë merren *copy-paste*

dhe na sillen këtu, duke mos na lënë as të diskutojmë, sepse e quajnë që këto ligje implementohen si në Europë, si në Amerikë ashtu edhe në vende të tjera.

Në qoftë se ne do t'i referohemi Singaporit, i cili është një nga shtetet me arsimin më të emancipuar dhe më të mirë të botës, po ju them diçka. Politikanët e këtij vendi, të cilët erdhën në pushtet në një vend jashtëzakonisht të varfër të sapodalë nga Lufta e Dytë Botërore, siç doli edhe Shqipëria, në qoftë se do të kishin ngelur vetëm te legjislacioni anglez, sepse ishin për një kohë të gjatë nën pushtimin anglez, atëherë reforma arsimore e atij vendi do të kishte dështuar.

Kështu që çdo reformë që merret duke sjellë ligje *copy-paste* nga Europa, pa u përshtatur te trashëgimia, te tradita kombëtare, ai ligj është i destinuar të dështojnë, siç dështoi edhe ky ligj. Ky ligj, sigurisht nuk erdhi *copy-paste* nga Anglia, sepse disa prej dispozitave ishin marrë nga ligjet angleze, ndërsa disa të tjera u bënë sipas interesave klienteliste të grupeve të interesit, që lobuan pranë qeverisë shqiptare, por nuk u morr parasysh tradita shqiptare. Në Shqipëri nuk mund të funksionojnë kreditë, donacionet, sepse ambienti i biznesit shqiptar nuk ka se si t'i bëjë donacionet. Në Shqipëri ende nuk jemi në nivelin e shitjes së patentave dhe përderisa nuk jemi në këto nivele, universitetet do të mbështeten vetëm te tarifat e studentëve. Pra, përderisa mbështeten te tarifat e studentëve, universitetet publike shqiptare do të vazhdojnë të jenë në krizë.

Duke iu bashkuar shqetësimeve të kolegëve të mi se “Pakti për universitetin” është një pakt okult, që është hartuar pa u marrë parasysh interesat e pedagogëve, pa u diskutuar me grupet e interesit, kam një pyetje për kolegët e mi që janë të pranishëm. Në qoftë se qeveria nuk do të heqë dorë nga ai pakt, cila do të jetë rruga ligjore që ju do të ndërmerri?

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Fjalën e ka Ismeti dhe, më pas, Romeo.

Ju lutem, përqendrohuni te pyetjet!

**Ismet Beqiraj** – Të nderuar kolegë,

Siç e tha edhe profesor Marku, shumica e të ftuarve janë pedagogë, prandaj edhe unë kam fatin të jem pjesë e trupës akademike të Universitetit të Tiranës. Pra, duke qenë pjesë e kësaj trupe, jam në dijeni të problemeve, të shqetësimeve, të halleve dhe nevojave që ka kaluar ky institucion, si dhe arsimi i lartë në Shqipëri. Gjithmonë, kur vjen fundi i mbledhjes, kryetarja e komisionit na nxiton për minutazhin, prandaj unë do të doja t'i shosha zonjës kryetare se ne ato gjëra që kemi për t'i thënë, do t'i themi, qoftë komentet apo qoftë pyetjet, prandaj ju lutem, mos na limitoni!

Si çdo gjë e re...

(Diskutime pa mikrofon.)

... edhe kjo nuk implementohet lehtë, prandaj edhe ligji për arsimin e lartë ka kohën e maturimit, të implementimit dhe në konceptin tim deri tani, nuk po ju them se nuk kam marrë pjesë në diskutim, por kam qenë i angazhuar dhe i pranishëm në këtë diskutim, bashkohem me mendimin e zotit Marku, i cili tha: “Ne jemi në minorancë”. Unë i kam kontestuar disa pjesë të ligjit, të cilat duke u mbledhur edhe me mendimin e kolegëve të tjerë, gjeti implementim në ligj dhe u morën në konsideratë. Sa i takon ligjit, mbetem i parimit se nuk është një testamant i shkruar në gur, pra nuk është një produkt juridik absolut, është relativ.

Sa i takon ecures së implementimit të ligjit, sigurisht ka nevojë edhe për korrigjime, për ta bërë më të shkurtër kohën e implementimit të tij dhe më të lehtë nga ana burokratike dhe të instrumenteve që e pengojnë. Protesta e studentëve zgjoi pedagogët, duke filluar nga unë, edhe të tjerë. Sa u takon halleve dhe problemeve, kemi fjetur për vite të tëra. Mua më kujtohet vetëm një protestë që është bërë me të drejtë, protesta e bërë në periudhën 2003-2004, e cila solli edhe një hov të pagave.

Kam një pyetje. Sa herë janë rritur pagat nga 2005 deri tani? Të paktën për atë kohë që unë kam qenë pedagog, mbaj mend që rritje të ndjeshme pagash ka pasur vetëm në vitin 2004 dhe në 2007. Pra, ne, si trupë akademike, jemi pajtuar me *status quonë* dhe me ato benefite që kemi marrë nga mësimdhënia në institucionet publike dhe institucionet jopublike; kjo gjë duhet pranuar me ndërgjegje.

Po kthehem te pyetjet konkrete. Aktet e fundit të qeverisë, që kontestohen si prekje e lirisë akademike dhe e autonomisë universitare, në përgjithësi i shoh si institucionalizim me akte nënligjore, VKM-të, urdhra që kanë dalë si rezultat i partneritetit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe qeverisë. Pra, studentët kërkonin shpejtësi në veprim, zgjidhje reale, që nga problemet që kishin të bënin me përgjysmimin e tarifave të studentëve, por edhe për ndërhyrje emergjente në konvikte dhe në mjedise të tjera. Ky institucionalizim ligjor ka pasur në fokus evidentimin e të gjitha problematikave, të cilat po nxjerr vetë implementimi i ligjit. Kjo është risia më e madhe e këtij ligji gjatë zbatimit të tij, sepse të jemi të ndërgjegjshëm dhe realistë, vjet në këtë periudhë kanë qenë aktet e fundit nënligjore që kanë dale nga qeveria, janë gati 35-36 akte nënligjore. Të gjitha këto akte nënligjore nxorën të gjithë pluhurin 28-vjeçar jo vetëm të kësaj qeverisjeje. Kjo vetëm i evidentoi, u tregua fleksibël dhe zgjodhi instrumente për t'i zgjidhur, si bashkëbisedimin dhe dialogun studentë-pedagog-qeveri, hartoi te “Platforma për universitetin” programin me afate, me përgjegjësinë e vetë institucioneve të arsimit të lartë dhe të vetë strukturave të shtetit...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Të lutem, për etikë, mos ndërhyjni...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Unë të kam dëgjuar për orë të tëra, zotëri, nëpër të gjitha studiot televizive dhe nuk jam mërzitur...

**Albana Vokshi** – Unë po ju lutem për pyetjet, ndërsa Ismeti po ju sqaron atyre ligjin e arsimit të lartë, VKM-të, madje i thotë edhe gabim...

Ismet, të lutem, se je duke u shprehur gabim, aktet nënligjore nuk kanë dalë ende, mësoje...

**Ismet Beqiraj** – VKM-të janë akte nënligjore..

**Albana Vokshi** – E ke gabim, nuk kanë dalë të gjitha ende...

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem, paneli që është në dëgjim të respektojë Rregulloren!

**Albana Vokshi** – Cila është Rregullorja?

**Ismet Beqiraj** – Rregullorja është që kur flet një deputet, nuk duhet të ndërhyj askush...

**Albana Vokshi** – Te cili nen është kjo?

**Ismet Beqiraj** – E di ti, se je e vjetër...

**Albana Vokshi** - Ma thuaj pak nenin...

**Ismet Beqiraj** – Lexoje...

**Albana Vokshi** – Unë e kam lexuar, por lexojuni ju. Ju lutem, bëni pyetjet dhe të mos hyjmë në konflikt!

**Ismet Beqiraj** – Të lutem, do të bëj pyetje konkrete!

**Albana Vokshi** – Ismet, të lutem, vazhdoje atje ku e le, të mos bëjmë kot replika!

**Ismet Beqiraj** – Ku e shihni...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Mark Marku** – Unë e di, se kam qenë edhe deputet, seanca dëgjimore është që të na dëgjoni ju ne...

**Ismet Beqiraj** - Profesor Marku, edhe unë në një linjë me ju jam, por kryetarja nuk e respektoi këtë. Ju la të flisnit, të bënit komente dhe pyetje...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Ismet, të lutem, bëj pyetjet!

Nuk ke as interes tani, se nuk ke as kamera të pranishme, kështu që kot e ke...

**Ismet Beqiraj** – Unë nuk e bëj për kamerat, prandaj mos bëj diferencime...

**Albana Vokshi** – Jo, nuk bëj fare diferencime. Vali foli 2 minuta dhe bëri pyetje, edhe ti ke të drejtën të flasësh, por, të lutem, bëj pyetjet.

**Ismet Beqiraj** – Bëri edhe pyetje, edhe komente...

**Albana Vokshi** – Këta nuk kanë ardhur për të na dëgjuar ne. Unë nuk kam bërë asnjë pyetje, nuk kam folur...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ismet Beqiraj** – Tani do ta kisha mbaruar fjalën time...

**Albana Vokshi** – Të lutem, mbaroje fjalën!

**Ismet Beqiraj** – Kolegë të nderuar, nuk ju kam dëgjuar asnjëherë të shpreheni publikisht, të mbronin vullnetin dhe të drejtën e studentëve e pedagogëve që kërkojnë të vazhdojnë mësim...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Koleg, pse je kaq i paduruar?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Pastaj na bëni moral për etikën dhe sjelljen! Të lutem, pse...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Po thuaj nuk përgjigjem!...

**Albana Vokshi** – Zoti Prifti, do të përgjigjeni më pas, por ta lëmë zotin Beqiraj, ta mbarojë fjalën...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Nuk kemi se çfarë t'i bëjmë, se kështu e ka...

**Ismet Beqiraj** – E di pse po ta bëj këtë pyetje? Unë këtu kam një deklaratë...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

... të Asamblesë së Personelit Akademik, të njërit prej fakulteteve, e cila thotë: “Të sigurojmë të drejtën e tyre për të protestuar me forma dhe mjete demokratike, por pa cenuar zhvillimin e procesit mësimor”.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Zotëri, je pjesë e Asamblesë së Pedagogëve, prandaj duhet të përgjigjesh...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Pse nuk jeni shprehur publikisht, kjo është pyetja ime, për pedagogët, për studentët, për prindërit që dëshirojnë që fëmijët e tyre të jenë në shkollë?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Përse keni heshtur?..

**Albana Vokshi** – Zoti Prifti, të lutem, mos ndërhyini!

... për presionet e të gjitha formave dhe intimidimit që u është bërë studentëve, pedagogëve?...

*(Diskutime pa mikrofon.)*



**Albana Vokshi** – Zoti Prifti, do t’jua jap fjalën menjëherë më pas...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Po nuk kam se çfarë t’i bëj, se kështu është *non sensi*! Kështu jemi çdo ditë këtu dhe me këtë *non sens* jetojmë edhe ne...

**Ismet Beqiraj** – Profesor Marku, po ju drejtohem juve, se kam respekt. Kështu krijohet ideja se ju, profesorë të nderuar, i ndanit studentët, në ne dhe ata, duke mos i mbrojtur të gjitha palët, edhe ata që bëjnë protestë, edhe ata që ngujohen, por edhe ata që kërkojnë arsim dhe duan të shkojnë në shkollë, që të cenohen dhe intimidohen. Pra, të mos hidhet nga shkallët e Fakultetit të Shkencave kolegia juaj dhe imja ku jep mësim...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Zotëri, nuk të vjen mirë ty...

**Albana Vokshi** – Ismet, të lutem, mbaroje fjalën, se ke gjysmë ore që flet...

**Ismet Beqiraj** – Jo gjysmë ore, por edhe një orë do të flas...

**Albana Vokshi** – Nuk jemi këtu vetëm për ty, por për të dëgjuar ata.

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem, mos i ndani studentët nga e drejta dhe kërkesat e tyre.

**Albana Vokshi** – Po, fjala për ju.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Mark Marku** – Ju lutem, pak kujdes me tonin, se jemi pedagogë dhe profesorë. Jemi të pranishëm sot këtu dhe as nuk po bërtasim dhe po ofendojmë askënd, prandaj edhe nuk lejojmë askënd të na bërtasë.

E para, nuk kemi frikë, të jeni të qartë.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Po bërtisni...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

A të zihemi me gurë tani!?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Ju lutem, uleni tonin, se nuk kemi frikë, përndryshe ikim!

Ne jemi duke ju respektuar, sepse ju na dëgjuat dhe për këtë arsye na duket jo e logjikshme të ngrihemi pa i dëgjuar të gjithë deputetët, të cilët patën mirësinë të ishin të pranishëm dhe të na dëgjonin.

Pra, u bë një pyetje, e cila ishte shumë e gjatë, por po jua them në mënyrë të përmbledhur. Pak a shumë ideja ishte pse ne nuk kemi reaguar? Kundër kujt? Për çfarë?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Në mbështetje të cilëve studentë?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

E para, nuk është deklarata e Asamblesë së fakultetit ku unë jam pjesë, unë përgjigjem vetëm për fakultetin ku jam pjesë...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Për të qenë të qartë, ka pasur një tendencë, po jua shpjegoj hapur dhe qartë, për t'i përdorur pedagogët si policë për t'u bërë presion studentëve që të shkonin në mësim. Protesta ka qenë e studentëve dhe gjëja më e ndyrë ka qenë presioni që u është bërë studentëve nga ana e pedagogëve; protesta ka qenë e studentëve e kanë vendosur vetë ata. Pra, ata mund të binin në konsensus me kolegët e tyre për të hyrë apo për të mos hyrë. Unë personalisht atë që ju po ma quani si faj, e quaj nder, sepse nuk u kam thënë studentëve as të futen dhe as të mos futen. Sa i takon filozofisë së edukimit, unë u them studentëve: më mirë protesto, se po protestove për gjendjen tënde, atëherë ke mundësi ta përmirësosh atë, sepse diploma të digjet kot, dijet po ashtu dhe shoqëria merr fund.

Pra, në qoftë se pyetja ishte për mua, filozofia ime është: protesto! Edhe nëse proteston kot, është më mirë sesa të heshtësh!

Nga ana tjetër, studentët ne i kemi respektuar dhe askush nuk u ka bërë presion. Ata pedagogë që u kanë bërë presion studentëve për t'u futur në mësim, turp të kenë, se janë bërë si police në universitet, ndërkohë që ky rol nuk u takon.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Gurakuqi.

Do t'ju lutesha në mënyrë të përmbledhur.

**Romeo Gurakuqi** – Unë do të bëj vetëm një prononcim të shkurtër.

I falënderoj kolegët për vlerësimin e tyre dhe ndaj të njëjtat pikëpamje me ta! E vlerësoj analizën tuaj, sepse ka qenë e bazuar në arsyen juridike dhe atë profesionale. Në fakt, për hir të së vërtetës, shpjegimi që u bë nga ana juaj ishte mjaft i qartë, gjë që është bërë herë pas here në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, edhe dimrin e kaluar, por jemi në disa rrethana të pamundura për të ecur përpara.

Mesazhin tuaj e mora shumë qartë. Pra, sipas jush, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, po ashtu edhe ligjvënësit, nuk duhet të zgjaten sa i takon vendosjes së bazave për korrigjimin e ligjit të arsimit të lartë. Studentët prej 3 muajsh janë në krizë, po ashtu edhe universitetet dhe shoh se ka një rreshtim ose lëvizje të korrigjimit në rrugë të paqarta. Në fakt, jo sot, por kjo gjë ka ndodhur historikisht, ndërhyrjet korrigjuese në sistemin universitar shqiptar janë penguar sistematikisht të paktën nga dy ekipe frenuese dhe konservatore, sipas këndvështrimit tim.

Së pari, rrethi i drejtuesve të atyre universiteteve shqiptare që kanë qenë për mbajtjen e universiteteve në suazat e kontrollit të tyre, jo vetëm të kuadrit, por në përgjithësi të rinovimit dhe të konkurrencës.

Së dyti, ka qenë bashkësia po aq diverse e interesave të pronësisë së universiteteve private, të cilat gjithmonë kanë tentuar ta zhvendosin bllokun e interesave nga vetja.

Së treti, sot e 3 muaj kjo gjë nuk korrigjohet. Pyetja që unë kam është: pse nuk korrigjohet sot?

Sot, ka një faktor të tretë, sipas këndvështrimit tim, që e frenon këtë situatë dhe kjo është e lidhur, para së gjithash, me qeverinë shqiptare, e cila sot ka ndërhyrë si një faktor i tretë dhe nuk kërkon të heqë dorë nga ato parime që ka vendosur në ligjin aktual.

Ajo nuk do të korrigjojë ndërhyrjen e shtetit dhe mbrojtjen e interesave të studentëve dhe pedagogëve, dhe, mbi të gjitha, financimin e sistemit universitar shqiptar. Ky është, pak a shumë, sipas këndvështrimit tim, një faktor i tretë, i cili pengon që reforma të korrigjohet sipas asaj opionence që ju bëtë dhe që ne e kemi bërë disa herë në këtë sallë, edhe jashtë kësaj salle, si dhe po përpiqeni ta artoni sistemin me ndërhyrje të tilla, sikurse edhe pakti për universitetet.

Unë doja të dija nga ju se çfarë mungon praktikisht në kuadrin ligjor të arsimit të lartë në Shqipëri në mbrojtjen e profesoratit shqiptar? Së pari.

Së dyti, a mendoni ju që trajtimi i universiteteve private dhe i universiteteve shtetërore publike me dy standarde është një qasje e gabuar në unifikimin e sistemit ligjor në Shqipëri?

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Fjalën e ka Milva dhe më pas Vilma.

**Milva Ekonomi** – Unë kam disa pyetje të shkurtra, por duke e vënë situatën në një kontekst. Të gjitha gjërat që ju parashtuat, të nderuar profesorë, unë i kam marrë shënim. Njëra prej tyre, të cilën e quaj më të rëndësishme dhe që dua ta sjell në vëmendje, është se reagimi për dëgjuesën që po bëjmë sot, lidhet me protestën dhe me draft-paktin.

Ajo që dua të ndaj me ju është se draft-pakti erdhi menjëherë si reagim ndaj protestës së studentëve dhe në të u përfshinë edhe 11 vendimet e Këshillit të Ministrave, si dhe 3 urdhëresat që nxori Kryeministri. Për t'i bërë këto të mundura, natyrisht, ai dhe e gjithë qeveria u mbështetën në një nen të veçantë të ligjit për arsimin e lartë, neni 5, pika 2, germa b. Në të thuhet: “Shteti është përgjegjës për përcaktimin dhe monitorimin e standardeve të arsimit të lartë, për hapjen, akreditimin...”.

Pra, një bazë ligjore, nga e cila rrjedh ligji për arsimin e lartë u mor në konsideratë për hartimin e këtyre VKM-ve. VKM-të në përgjithësi adresonin disa gjëra që kishin të bënin me protestën studentore për tarifat. Për këtë arsye tarifat, sepse vendosjen e tavanit për to e ka në

dorë Këshilli i Ministrave, u përgjysmuan dhe për ata që ishin studentë ekselence, u bënë falas. Ekselencia u hap si definicion jo vetëm për 10-at, por edhe nga 9 deri në 10, gjithashtu edhe për ata studentë që janë me ndihmë ekonomike tarifa u hoq. Besoj se kjo është kompetencë e Këshillit të Ministrave.

Dua t'ju them edhe diçka tjetër. Duke ardhur këtu sot po shihja me shumë vëmendje botimet e INSTAT-it lidhur me nivelin e varfërisë në Shqipëri dhe sa pjesë zë buxheti i familjeve shqiptare për pjesën e arsimit. Ne duhet të dimë diçka: nga viti 2014 deri në vitin 2017 kemi një situatë financiare të familjeve që ka ardhur duke e ulur pabarazinë. Në qoftë se në vitin 2014 familjet që bënin pjesë në grupin e familjeve të pasura fitonin goxha të ardhura, në vitin 2017 kjo e ardhur e tyre u ul me 1,7%, ndërsa për familjet e varfra të ardhurat e tyre u rritën me 11%. Këto janë shifra zyrtare që vijnë nga INSTAT-i.

Sa u takon shpenzimeve që bëjnë familjet shqiptare në buxhetin e tyre për arsimin, në vitin 2016 shpenzimet mujore mesatare të një familjeje ishin 32 036 lekë, ndërsa për vitin 2017 janë 28 625 lekë. Pra, duke parë gjithë këtë situatë, mendoj se vendosja e këtyre tarifave ishte në të mirë të popullatës dhe të studentëve, duke vepruar, nga njëra anë, mbi bazën ligjore dhe, nga ana tjetër, mbi të dhënat që tregojnë institucionet kombëtare të të dhënave.

Ligji u përpoq të adresonte edhe një problem tjetër, që lidhej me autonominë që kishin fituar universitetet, cilësinë e mësimdhënies në universitete. Në fakt, ajo që u pretendua dhe u dha në pakt është që, meqenëse deri tani nuk është vepruar me shpejtësi nga universitetet, ndoshta vendosja para presionit për të kryer punë është një gjë e mirë, duke mundësuar që para universiteteve të vendosej i gjithë arkivi digjital i masterave dhe i temave të tjera shkencore që ishin kryer në Shqipëri, njëkohësisht edhe një *soft* për antiplagjiaturën.

Të mos harrojmë se gjatë periudhës 2007-2018 ne kemi shumë grada shkencore si “Doktor” brenda dhe jashtë vendit, “Profesor” brenda dhe jashtë vendit, si dhe “Profesor i Asociuar”, brenda dhe jashtë vendit, që nuk kanë ndjekur siç duhet rregullat që kishte ligji për të marrë gradat. Për shembull, rasti ku një profesor duhej të akomodonte 5 kandidatë, nuk ishte zbatuar aq mirë, sepse një profesor kishte akomoduar në përgjithësi ndjekjen e 15 kandidatëve, që pretendonin të merrnin gradën, ose koha nga 2 vjet ishte bërë 3 muaj, madje ka pasur edhe raste të tjera ku tema nuk lidhej fare me fushën ku pedagogu do të jepte mësim.

Prandaj, në këtë situatë kjo që propozon qeveria, a është një zgjidhje që ndihmon për ta çuar përpara procesin e cilësisë? Ju na prezantuan këtu vrojtimin kombëtar të studentëve. Unë di se në çdo fakultet bëhet vrojtimi, sepse ka një model që vjen nga Fondi Amerikano-Shqiptar për Zhvillim, i cili ka mundësuar pilotimin e projektit të vëzhgimit studentor për cilësinë e mësimdhënies. Por ajo që po kërkohet është që ky pilotim të unifikojë metodologjinë

kombëtare dhe të përdoret e dhëna për të qenë transparente, për konkurrencë të ndershme për çdo pedagog, sepse është e rëndësishme që të shikohet rankimi i pedagogëve. Ne kemi e diskutuar edhe herë të tjera...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

...Dakord, atje ku vendoset një konkurrencë e ndershme, pra për mënyrën se si zhvillohet një lëndë, sa pedagogë mund të ketë e të tjera. Shumë universitete hapin programin, duke marrë më shumë pedagogë të jashtëm sesa ngarkesa që lejohet në financim. Ju e dini që ka një strukturë, ku shporta mban pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm. Prandaj, kjo është një gjë që duhet parë me kujdes.

Për sa i takon transparencës financiare, që ishte një gjë që e kërkuan studentët, unë besoj dhe biem dakord që transparenca financiare nuk është e munguar, por nuk është e lexuar.

Ju jeni ent buxhetor me thesar dhe çdo veprim financiar që bëni, regjistrohet në thesar. Por ajo që ndodh është se kjo nuk lexohet dot nga pedagogë dhe studentë, pra se si shpenzohen paratë, prandaj kërkohet që me një udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Arsimit dhe universiteteve të vendoset një mënyrë, që të shikohet buxheti i konsumuar nga fakultetet, por jo se kjo gjë nuk ka ndodhur deri tani.

Për sa i përket cilësisë së jetës universitare, pra për jetën që bëjnë studentët në kampus, që ju e ngritët si shqetësim, unë dua t'ju sjell në vëmendje që para dy javësh miratuam një akt normativ të buxhetit të shtetit, ku ishin parashikuar fonde shtesë për dy kampuse, atë të Tiranës, me 300 milionë lekë, dhe për kampusin e Durrësit, 150 milionë lekë, ashtu siç ishin parashikuar edhe pako financiare për tarifën me një shumë prej 2 miliardë lekësh. Pra, të gjitha gjërat që janë pakt dhe që lidhen me VKM-të kanë shkuar më tej me financë dhe me realizim. Në bordet e administrimit po regjistrohen të gjithë studentët me tarifën e përgjysmuara, ndërsa studentëve që kanë bërë pagesën e plotë në fillim të vitit, po u rimbursohet.

Për shembull, rasti i Durrësit është një rast që dua ta vlerësoj. Ne patëm rektoren e Durrësit në dëgjuesë, e cila nuk ishte në gjendje të fliste për administrimin, por situata tregoi që po shkon drejt regjistrimit të studentëve përfitues të bursës.

Unë ju pyes: a shikoni vështirësi përtej kësaj që jep pakti për plotësim?

Zoti Marku, e kam me ju, e respektoj shumë që vini nga universiteti dhe që jeni pakica, sepse kjo është një formë e shprehjes së demokracisë dhe se pakicat janë ato që duhet të dëgjohen, por, meqenëse gratë demokratike janë shumë të rëndësishme, them që ju duhet të tërhiqni mbrapsht fjalën “gënjeshhtar” që thatë për ministrin e Brendshëm, sepse nuk e meriton këtë fjalë.

**Albana Vokshi** – Faleminderit shumë!

**Mark Marku** – Meqenëse m'u drejtuat, dua të shpjegoj se kë quaj gënjeshtar, quaj atë njeri që thotë: “unë nuk e bëj këtë” dhe pastaj e bën të nesërmen. Nëse kjo quhet fyerje, atëherë të mendohet ai që e bën atë dhe jo unë që e them. Hajdut është ai që vjedh, turp duhet të ketë ai që vjedh dhe jo ne që i themi hajdut; ashtu siç është kriminel një person që bën vrasje, turp duhet të ketë ai që bën vrasjen dhe jo ne që i themi kriminel. Pra, në këtë kuptim është edhe konteksti i fjalës që kam thënë, sepse unë i mas fjalët që them.

Kisha edhe diçka për të mirat e paktit e të tjera. Këtu kishte një abuzim me shifrat, meqenëse jeni financiere. 11% i 20 mijë lekëshit, që është paga e të varfërve, është 3 mijë lekë. Pra, të keni parasysh logjikën matematike, proporcionaliteti ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Mos thoni shifra, sepse shkollën e gazetarisë e kam bërë në Francë dhe i kuptoj shifrat. Prandaj kur thoni 20% e 10 mijë lekëshit, a e dini se sa është?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Është fyerje kur thoni se është rritur 11- përqindëshi i 3 mijë lekëve të vjetra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Meqenëse m'u drejtuat.

**Albana Vokshi** – Milva, të lutem, dëgjojeni, sepse të dëgjoji.

**Mark Marku** – Për çështjen që ngritët për matjen kombëtare për rankimin e pedagogëve, ku ka vend në botë që bën vlerësimin e pedagogëve me sondazhe? Ky është turp i botës po të dëgjohej! Kjo tregon që nuk merrni vesh fare nga universiteti. E para.

E dyta, vlerësimi i titujve dhe gradave, është shumë e saktë që të vlerësohet çdo shkelje, por është njëllë si të kapësh një patentë të falsifikuar dhe të bëhet verifikimi i të gjitha patentave në Shqipëri.

Më falni, a është zbuluar që disa prej jush kanë diploma të falsifikuara? Përse nuk janë marrë masa dhe përse nuk janë përjashtuar nga parlamenti, kur Kryeministri e ka seriozisht? Përse janë përsëri ministra? Pra, në vend që të ndëshkohen, ata promovohen. Me këtë që thoni, ju talleni. Janë zbuluar deri tani 5 apo 6 plagjiatura të deputetëve dhe figurave politike. Meqenëse Kryeministri e ka seriozisht, përse nuk i përjashton dhe nuk merr masa? Mos u tallni, sepse nuk mund të thuash që e kam hallin tek titujt dhe gradat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** – Po flasim për Kryeministrin, që e ka shumë qejf plagjiaturën, i cili duhet të merrte hapin e tij të parë.

A jemi pro evidentimit të çdo shkeljeje në marrjen e gradave dhe titujve? Po. Atëherë largo ata që kanë dalë me plagjiaturë dhe kështu vazhdojmë edhe me partitë e tjera. Ne jemi gati që të hapet si proces dhe t'i shkohet deri në fund.

Fjalën e ka Vilma, dy minutat e fundit, pastaj e keni radhën ju për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe do ta mbyllim.

**Vilma Bello** – Unë mendoj që dy janë gjërat më të rëndësishme, se pjesa më e madhe këtu jemi pedagogë universiteti dhe të gjithë biem dakord, së pari, që arsimi është një e mirë publike dhe, së dyti, patjetër që duhet të jetë një qasje e duhur ndaj arsimit të lartë, si gjëja më e rëndësishme jo vetëm për të ardhmen e arsimit të lartë, por edhe të Shqipërisë.

Unë ju përgëzoj për ndjeshmërinë tuaj për përmirësimin e arsimit të lartë, gjithashtu, edhe në misionin tuaj për ta kundërshtuar në vite, siç e pranuat, por pa zë ligjin e arsimit të lartë. Kjo ka qenë ndër vite. Por nuk ju përgëzoj dot që kjo kundërshti e ka marrë zërin sot. Duke e marrë në këndvështrimin tim, ka edhe një konotacion të lexueshëm politik, sepse më vjen një ngjashmëri shumë e madhe mes platformës së opozitës që e nxit sot dhe asaj çfarë thatë ju sot.

Unë kam një pyetje, kështu shkurtoj edhe dy minutëshin që thotë kryetarja e komisionit: cila është marrëdhënia juaj afektive apo institucionale me Partinë Demokratike?

**Albana Vokshi** – I ke lënë të gjithë pa tekst.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

A mund t'ju bëj edhe unë një pyetje? Profesor Shegani bëri një analizë ligjore si për draftligjin, ashtu edhe për disa nga VKM-të e fundit dhe ju konsideruat që pjesa më e madhe e tyre janë në shkelje të ligjit dhe një pjesë prej tyre janë antikushtetuese. A do të ndërmermni një hap në lidhje me VKM-të? Pra, a keni ndonjë plan në lidhje me këtë?

**Jani Marka** – Sa të mendohen kolegët për dy pyetjet e vështira që bëtë, më lejoni të jap një përgjigje...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, kërkoj ndjesë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Personalisht e kam pasion çështjen e dimensionit social dhe të pabarazisë. Zonja Ekonomi ngriti disa çështje që kanë lidhje me këtë drejtim, pra kanë të bëjnë me aksesin. A e kuptoni se sa larg jemi? Po të bëjmë një llogari, tarifa e studimit zë 20% të kostove të studentëve që vijnë nga rrethet, nuk e di sa zënë studentët e Tiranës. Për shembull, po marrim një student që vjen nga Saranda në Tiranë dhe mbaron ciklin e plotë, ai do të harxhojë 25 milionë lekë të vjetër për 5 vjet. Po të bëni llogaritë sociale me pagën minimale që keni miratuar, do të shikoni që një nëne, për ta çuar një fëmijë në universitet, do t'i duhet të kursejë çdo muaj 80 mijë lekë

të vjetër. A mendoni se është e mundur kjo? Pra, një nënë që punon në fasoneri, që ka një vajzë dhe do ta çojë në universitet, i duhet të kursejë 80 mijë lekë nga rroga e saj. Ajo duhet të paguajë tarifën, çmimet e librave, transportin, koston e konviktit, koston e ushqimit dhe kosto të tjera, që lidhen me jetën universitare. Pra, të paktën mbuloni pjesën e tarifave dhe jepuni bursë atyre që janë në nevojë për të mbuluar pjesën tjetër.

E fundit, ne që jemi pedagogë e vëmë re që sa më shumë kalojnë vitet, aq më shumë studentët punojnë. Dikur punonin në vit të pestë, tani punojnë në vit të katërt, në të tretin, në të dytin dhe në vit të parë. Përse punojnë studentët? Punojnë nga qejfi apo nga halli? Kemi dy studentë që njëri punon dhe tjetri jo, atëherë ata janë të pabarabartë, sepse njëri ka më pak kohë të angazhohet me studime.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Si jo? Në të gjithë botën punojnë, por nuk punojnë 7 ditë në javë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, punojnë në fundjavë dhe disa orë në javë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Shkoni shikojini *call center*-rat, sepse janë të mbushur me studentë. *Call center* është një punë shumë e vështirë.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

**Mark Marku** – Për pyetjen që bëtë për afeksionin, kjo futet në çështjet intime dhe nuk do të përgjigjem, meqenëse ne nuk u futëm në çështjet tuaja intime.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** – Mark, e ka porosi dhe duhet ta kryente.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E kishte porosi dhe e kreu detyrën ndaj partisë shtet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Vilma, pyetja jote ishte një turp.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Na lër të dëgjojmë profesorët e nderuar, që të përfitojmë edhe ne.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E bëtë deri këtu, mos e çoni deri në fund. Vazhdoni, profesor.

**Mark Marku** – E para, gjëja më e shëmtuar që ndodh me deputetët, gjë që unë nuk e kam bërë kurrë, që sapo vij këtu, tradhтони komunitetin nga keni ardhur dhe bëni sikur nuk ishit dhe sikur nuk ju njeh njeri. Jemi kolegë ...



*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zonjë jemi kolegë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Unë ju hedh në gjyq për këto. Duhet t'i vërtetoni, sepse unë jam njeri serioz. Unë nuk u mora me ty, por për këtë ju hedh në gjyq, sepse po bëni akuza.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Më vjen shumë keq që një militante e transformon veten për dy vjet, sa keni ju si deputete, dhe më bëni pyetje mua se çfarë afeksioni politik kam!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kur kam qenë në këtë parlament, kam ikur, sepse kam mbajtur integritetin tim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në vitin 2007, kemi ardhur me kolegen tënde, Mirelën...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për të njëjtat arsye kemi ardhur, kur ka qenë ligji ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Apo jo, Mirela?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo për të treguar afeksionin politik.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të njëjtën gjë kemi bërë në vitin 2007, bashkë me të majtë dhe të djathtë, për ligjin "Për arsimin e lartë", kur Berisha donte të hiqte zgjedhjet në universitete dhe kemi krijuar këtë lëvizje, dhe kemi shkuar edhe në Gjykatën Kushtetuese.

Pra, zonjë, unë jam në koherencë totale absolute me veten, prandaj matu mirë kur do të flasësh me mua, sepse nuk je në mbledhjet e partisë, por je me një koleg që e njohin njerëzit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Mos bëj akuza të pabaza, matu mirë, se të hedh në gjyq!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Patjetër, sepse harroni të jeni njerëz dhe nuk keni turp të transformoheni. Bëheni bisha, vetëm se ju vjen një sms në telefon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, ti asgjëson veten si njeri për një mesazh dhe je gati të fyesh një koleg! Nuk të vjen turp?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Është turp!

**Albana Vokshi** – Zoti Mark, të lutem, të lutem, a mund të përgjigjeni...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të lutem, Vilma, mos na trego, sepse do të dalë ndonjë gjë tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo pyetje nuk ka vlerë, sepse ishte porosi dhe e bëri. Kemi disa pyetje shumë më të rëndësishme për sa i përket arsimit të lartë dhe nuk kemi përse ta deformatim debatin, dhe të shkojmë aty ku duan këta, prandaj t'u përgjigjemi pyetjeve në lidhje me VKM-të, ligjin e arsimit të lartë dhe të tjera.

**Klejd Këlliçi** – Unë vij nga Fakulteti i Shkencave Sociale, kemi bërë katër asamble, kemi të gjitha procesverbalet dhe të gjitha vendimmarrjet. Për të tjerët nuk mund të flas, por ne kemi kundërshtuar çdo gjë, për sa i përket ligjit, mbështetjes së studentëve dhe të tjerave.

Të premten do të mbledhemi përsëri për të parë draftprojektin, VKM-të, draftet për mbrojtjen e universitetit e të tjera. Nga kjo pikëpamje ne i kemi ezauruar të gjithë proceset demokratike brenda fakultetit.

Në asamble kanë qenë minimalisht 50 veta, ku ka pasur vota pro dhe kundër, dhe të gjitha votat janë respektuar.

Për sa i përket pyetjes së profesor Gurakuqit, për mbrojtjen e pedagogëve, natyrisht që ka një preokupim për sa i përket mënyrës së bërjes së procesit të vlerësimit apo rishikimit, mund ta quani si të doni, të pedagogëve. Pra, shqetësimi ka ardhur nga mënyra se si do të bëhet procesi i rishikimit, ndërkohë që kjo do të influencojë në autonominë që kemi.

Dua të ndalem në debatin që kemi pasur brenda për brenda universitetit. Janë bërë asambletë dhe kemi marrë vendime për të hyrë ose jo në mësim. Ne kemi qenë në universitet në të gjitha ditët që ka qenë greva e studentëve dhe greva jonë. Në fakultet ka pasur probleme nga më të ndryshmet, pedagogë që u bënë presion studentëve për t'u futur në mësim dhe studentë që u bënë presion pedagogëve për të hyrë në mësim, pra ka pasur nga të gjitha. Ajo që kemi konstatuar, kur hoqëm dorë nga greva, është se ditët e enjte dhe të premte nuk ka pasur studentë, pra sot ka filluar procesi i rregullt mësimor. Kjo tregon që edhe ata studentë që donin të futeshin në mësim, nuk e kanë pasur të qartë. Pra, situata ka qenë e amullt. Por që të ketë pasur presion brenda universitetit, të paktën në Fakultetin e Shkencave Sociale, kjo është e përjashtuar.

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Prifti.

**Rezart Prifti** – Për sa i përket pyetjes së pedagogut, kërkesa kryesore është statusi i pedagogut, pra është një nocion që njihet në të gjithë botën që quhet *tener ship*, por duhet të ketë një proces më vete për të.

Për sa u përket universiteteve private, nëse duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë nga ligji apo jo, për mendimin tim, jo, sepse në konceptin tim universiteti privat është biznes. Nëse do të futesh në treg, merr përsipër marketingun, shitjen dhe ofertën tënde. Ne nuk kemi një hierarki dhe të drejtë ose ndërgjegje të atillë shoqërore, sa që universiteti privat të trajtohet si Hawardi në Amerikë, sepse ata funksionojnë me *endowment*, pra është një koncept tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky është një ngërç teknik më vete, sepse vetëm ne kemi kontrollin. Ata nuk ushtrojnë kontroll tjetër. Kjo ka prodhuar kristalet e radhës, siç është ky i fundit i KLSH-së.

Për atë që tha zonja Ekonomi, dua të them: “unë them ujku, ju përsëri thoni gjurmët”. Unë nuk kam dalë nga asnjë lloj asambleje, por këto që thashë a janë të gabuara? Ta zëmë se jam fashist, por këto që thashë a janë të gabuara? Ndoshta jam gjysmak nga mendja, por këto që thashë a janë të gabuara?

Për sa i përket përgjigjes së VKM-ve, edhe nëse kemi ndonjë dashni politike, çfarë problemi ka? Ne intelektualë jemi, nëse nuk kemi ne dashni politike, kush do të ketë?! Ata që nuk ishin intelektualë dhe ju i morët me dashni politike, po jua hanë kokën sot në parlament dhe gjithandej.

Për atë që zonja Ekonomi tha se u përgjigjëm 8 pikave me VKM-të e të tjera, unë po ju them që ju nuk shtuat gjë në këtë VKM, sepse përkrahja sociale e atyre njerëzve që ishin me ndihmë sociale, ka qenë në vitin 2013 dhe asnjë nuk e përmend këtë. Pra, nuk keni shtuar ndonjë gjë të re, ata njerëz që nuk kishin para të paguanin tarifën...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Këtë e di, sepse kam ndihmuar vetë disa studentë të formulojnë letrën dhe kjo ka qenë që në vitin 2013. Pra, ata që nuk kishin të ardhura financiare të mjaftueshme, ata që kishin një invalid në shtëpi, ata që kishin një prind, përjashtoheshin dhe të tjera me radhë, se nuk i mbaj mend të gjitha.

U tha që u zgjerua ekselencia dhe nga nota 10 u ul në notën 9. Po a ishte ky një hall i madh, apo jo?

U tha këtu që u rrit autonomia për të rritur cilësinë. Nuk ka lidhje autonomia me cilësinë akademike, sepse janë dy gjëra të ndryshme.

Unë po flas me njerëz që kanë asimetri informacioni në lidhje me këtë. Pra, ju kërkoni të bëni VKM dhe ligje, pa njohur mirë kontekstin e punës. Këtë nuk e vë re vetëm te ju, por

edhe tek ata që kanë qenë para jush. Kur kam folur me njerëz që kanë pasur influencë në qeveri, përsëri nuk ishin në dijeni të asaj çfarë thoshin dhe çfarë bënin.

**Albana Vokshi** – Zoti Shegani, a kishit diçka?

**Milva Ekonomi** – Më fal, por dua të shtoj diçka.

**Albana Vokshi** – Nuk e bëjmë dot me replikë.

**Milva Ekonomi** – Nuk e kam replikë, por dua t’i them zotit Prifti që tarifat kanë qenë të pandryshuara që nga viti 2014, ndërsa ajo që ndodhi tani, i përgjysmoi ato tarifa, ndërsa përfituesit e bursave mbetën ata që ishin, vetëm u shtua një kategori. Pra, tarifat e vitit 2014 u përgjysmuan.

Pyetja që ju bëra unë ishte: çfarë shikoni përtej paktit që nuk është plotësuar?

**Mark Marku** – Plotësuar ku?

**Albana Vokshi** – “Pakti” i ka plotësuar të gjitha, dhe përtej tij, çfarë nuk është plotësuar?

**Mark Marku** – Zonjë, unë kam shumë respekt për ju dhe ju njoh edhe personalisht të gjithëve, por të kërkosh se çfarë nuk plotëson “Pakti”, do të thotë që e gjithë bota të besojë që ai është i mirë. Pra, problemi është që të dalim përtej gjendjes kaotike, ku mendoni se i zgjidhni gjërat. Unë po them, po t’i përktheni VKM-të dhe t’ia çoni çdokujt që merr vesh nga arsimi i lartë në Europë, po ju garantoj që do t’i bjerë të fikët nga tmerri, se si mundet një qeveri të prodhojë akte të tilla për universitetin. Pra, kuptojeni që janë qesharake dhe nuk është problemi që janë të mira apo të këqija, i mendoj unë apo jo, këto janë të pazbatueshme në universitet, sepse, nëse do të zbatohen, universiteti nuk do të ekzistojë më.

Ajo që thoni për plagjiaturën, jam dakord. E para, këtë duhet ta bëjnë universitetet, sepse e bëjnë shumë mirë.

E dyta, që të bësh verifikimin duhet të kesh rregullat për plagjiaturën, dhe çdo vend i ka rregullat dhe parimet ndryshe...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ndryshe i ka parimet Holanda, ndryshe i ka parimet Gjermania, ndryshe i ka parimet Franca e të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Brenda të njëjtit shtet, universitete të ndryshme kanë parime të ndryshme metodologjike, kështu ndodh edhe brenda të njëjtit fakultet, nuk mund t’i ketë ndryshe të njëjtat parime metodologjike gazetaria, të njëjtat parime metodologjike gjuha, që janë brenda së njëjtës godinë, apo të njëjtat parime metodologjike gjuhët e huaja. Pra, është pastërtisht çështje

e atyre që e njohin fushën. Për shembull, çfarë quhet plagjiaturë: marrja e frazës që e zbaton përmes *copy paste-it*, përmbajtja kur nuk e citon, metodologjia, bibliografia e të tjerë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ajo që thoni ju, është një gjë që nuk bëhet dot.

**Albana Vokshi** – Nuk ka më asnjë mundësi kohore.

A keni ndonjë gjë, zoti Shegani, sepse duhet ta mbyllim?

**Altin Shegani** – Kam bindjen se zonja Milva bëri një ekspozitë të disa elementeve, që e gjenin bazën te neni 5/2.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Mendoj se neni 5, pika 2, vjen në renditjen e ligjit dhe jo rastësisht pas nenit 3, ku formatohet në mënyrën më të plotë të mundshme, sipas meje më domethënëse, autonomia universitare. Pa diskutim që do të kontrollohen standardet dhe këtu nuk ka asnjë lloj hamendësimi, por gjithçka duhet bërë në përputhje me standardin e sigurimit të autonomisë. Janë gjëra që nuk i kemi shpikur ne, por mënyra se si formësohen në ligj apo në akte të tjera nënligjore, duhet të jetë në përputhje me parimet kryesore, me ligjet dhe me Kushtetutën. Pa diskutim që nuk kam asnjë dyshim të them se qëllimi është pozitiv. Jam dakord me atë që thatë ju, pra edhe ju keni interes që të ndahen. Pra, që të përmirësohet gjendja, duhet të evidentohen edhe problematikat. Mendoj se kjo duhet bërë në një formë ligjore, që të mos bierë ndesh me aktet kryesore, me Kushtetutën dhe me ligje të tjera. Ligji “Për arsimin e lartë”, pavarësisht se miratohet me një matematikë 50%+1%, mendoj se është gati në lartësinë e një ligji organik. Kjo bën (sepse ka rëndësi kombëtare, madje edhe ndërkombëtare, ka profilin e shtetit në garë me shtetet e tjera në ekonomi, në shkencë dhe kudo), që një pjesë e vendeve të Bashkimit Europian të kenë në strukturën e tyre qeverisëse edhe ministrinë e Arsimit të Lartë. Në fakt, ka një veçanti specifike arsimit të lartë, ka kërkimin shkencor në raport me hallkat e tjera. Në këtë sens, absolutisht ne nuk jemi kundër që të evidentohen problemet, por të evidentohen në një mënyrë të ligjshme dhe jo në një mënyrë të paligjshme. Kërkimi ligjor duhet të jetë kryefjala e çdo gjëje. Ky është mendimi im personal.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Urdhëroni, zoti Rrokaj!

Ju lutem, vetëm 30 sekonda, sepse më duhet ta mbyll!

**Shezai Rrokaj** – E drejta nuk ka nevojë për shumicë dhe për pakicë. Kur ngrihet një problem i drejtë dhe problemi i drejtë i ngritur nga profesori dhe nga aktorët më domethënës publikë është që ky ligj ka probleme. Ne nuk duhet ta kapitalizojmë në favor të partive që ne

përfaqësojmë këtu, por duhet të bashkohemi, bashkë me profesoratin, të bëjmë një ligj siç duhet. Kjo është e rëndësishme.

Sa për pikën b, ne nuk duhet ta ngatërrojmë shtetin me qeverinë, sepse po të ishte ashtu, thoshte qeveria. Problemi që na ndodh të gjithëve, dashur pa dashur, është se ne nuk rregullojmë balancën e institucioneve. Kështu që, absolutisht ato nene bien ndesh me ato që quhen *acque* të universiteteve, që janë: liria akademike, autonomia administrative dhe financiare. Këto nuk janë të negociueshme, nuk negocohen, sepse janë të fituara. Kështu që, në qoftë se ne të gjithë bashkë duhet të bëjmë një vepër të mirë, mbajeni ju meritën e ligjit, hajdeni ta bëjmë për të mirën e arsimit, të profesorëve dhe të universitetit. Të gjithëve, edhe Vilmës, edhe mua më vjen keq që ndodhi kjo, sepse e njoh Vilmën shumë mirë dhe e di sa e përkushtuar është në fushën e arsimit. Asnjëri nga ne nuk ka qëllim dhe nuk do që ta vërë kapitalin politik mbi atë me të cilën ne kemi siguruar jetën, kemi lidhur të ardhmen tonë dhe përkushtimin tonë. Kështu që mesazhi është që ne të jemi bashkë në një front, apo të përdorim njëri-tjetrin në të mirë të asaj që të gjithë e duam dhe e dëshirojmë.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit!

Nëse nuk keni diçka tjetër, unë mendoj që mbyllje më të mirë se sa kjo e profesor Shezaiut nuk ka. Ne duhet të jemi të gjithë bashkë, sepse arsimi i lartë, në fund të fundit, është një e mirë e të gjithëve dhe jo e njërës parti apo e opozitës.

Shumë faleminderit për kohën!

U lutem deputetëve të qëndrojnë edhe 5 minuta, sepse do të diskutojmë për kalendarin!

Ju lutem, a mund t'i zini vendet që të vazhdojmë me kalendarin, sepse më duhet të largohem?!

Diskutojmë për kalendarin e kësaj jave dhe atë të dy javëve në vijim. Kemi disa çështje, që i kemi lënë për diskutim. Pra, kemi lënë dëgjuesin me përfaqësuesit e asambleve të fakulteteve; kemi projektligjin “Për arsimit e lartë”, por që ministrja ende nuk ka...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju keni kërkuar tjetër përfaqësi, kjo ishte e asamblesë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ismet, të lutem, sepse këtë debat e kemi bërë 500 mijë herë!

Ju keni kërkuar dëgjues me përfaqësues të asambleve të çdo fakulteti të Universitetit të Tiranës.

Kemi projektligjin “Për arsimin e lartë” propozim i LSI-së, për të cilin nuk kemi marrë ende asnjë përgjigje. Ministria konfirmoi se nuk vjen nesër, axhenda është shumë e ngarkuar, i kemi lënë vetëm dy ditë zyrtare kohë, ndërkohë i ktheva përgjigje që kur ta shikojë ajo të arsyeshme, le të vijë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ia kemi thënë në të gjitha mënyrat dhe format. Unë po ju informoj, meqenëse ministres i duhet më shumë kohë, është çështje me shumë rëndësi.

Kemi projektligjin “Për rritjen e buxhetit për arsimin e lartë”, që është...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të lutem, nuk është tërhequr, sepse po të ishte tërhequr, as unë nuk do të lodhesha, as ju nuk do të lodheshit.

Zoti Rrokaj, të lutem, sepse po thonë që jeni tërhequr!

Kemi projektligjin “Për rritjen e buxhetit të arsimit të lartë”, edhe ky është propozim i LSI-së. Gjithashtu, kemi një projektligj “Për rininë”, që thonë se është propozim deputeti, por nuk e di se kush e ka bërë këtë. A dini gjë se kush e ka bërë këtë projektligj?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në rregull, edhe ky qenka propozim i LSI-së.

Për dëgjuesën me ministren e Arsimit ju thashë se jemi dakordësuar të gjithë, por ministria përsëri ka kthyer përgjigje që nuk vjen as nesër. Dëgjuesën me ministrin e Brendshëm dhe ministren e Arsimit do ta shtyjme për një herë të dytë. Gjithashtu, kemi dëgjuesën me studentët, që e ka kërkuar LSI-ja, por edhe këtë e kemi shtyrë për një moment të dytë.

**Milva Ekonomi** – Në lidhje me studentët, edhe kur zhvilluam mbledhjen e kaluar ramë dakord...

*(Mungesë regjistrimi.)*

**Albana Vokshi** – Çfarë do të bëjmë me asamblëtë?

**Milva Ekonomi** – Asamblëtë do t’i thërrasim nesër.

**Albana Vokshi** – Po ju informoj në lidhje me shkresat që kanë ardhur: ka ardhur shkresë nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe përfaqësues janë: Edmond Rapti dhe profesoreshë e asociuar Marinela Sota. Në dijeninë time, e kanë bërë mbledhjen e asamblesë dhe janë dakordësuar. Nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë kemi Mark Marku, Erka Çaro, Jonida Godole dhe Andi Pinari. Në dijeninë time është bërë mbledhja e asamblesë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Janë asamblëtë e fakulteteve.

**Milva Ekonomi** – Kjo është kërkesë e tyre për dëgjuesë, ne bëjmë kërkesë për asambletë.

**Albana Vokshi** – Këta janë përfaqësues të asambleve, që kanë bërë mbledhjet dhe na kanë çuar emrat.

Dekani i Fakultetit të Ekonomisë na ka çuar një shkresë, që thotë se përfaqësues janë: Dhori Kule, Shyqyri Llaçi dhe profesor Sulo Hadëri. Në dijeni time, asambleja e Fakultetit të Ekonomikut nuk është mbledhur. Gjithashtu, nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja kemi përfaqësues: professor.doktor Artur Sula dhe Alban Foçi, anëtar i asamblesë. Unë nuk e di nëse janë mbledhur apo nuk janë mbledhur këta.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Milva Ekonomi** – Ne dëgjuesën do ta bëjmë nesër, nuk do ta shtyjmë.

**Albana Vokshi** – Milva me ngadalë, sepse nuk bëhen kështu: do ta bëjmë me zor, nuk do ta bëjmë me zor!

**Milva Ekonomi** – Është e zgjidhshme edhe kjo dëgjuesë, por ne kemi kaq ditë që diskutojmë dëgjuesën dhe ramë dakord për të bërë një zgjedhje. Zgjedhja që bëjmë është dëgjesa e parë dhe dëgjesa e dytë. Simetria duhet ruajtur, sepse duhet ruajtur simetria në vendimmarrje dhe ne ramë dakord për të gjitha dëgjesat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** - Jemi shumë dakord.

**Milva Ekonomi** – E vetmja gjë që nuk ramë dakord, është dëgjesa me studentët. Kështu, a i bëjmë dëgjesat siç kemi rënë dakord?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** - Nuk janë mbledhur asambletë, sepse kam pyetur, ata janë të deleguar të dekanit. Pyet Fakultetin Ekonomik, pyet Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Që ju nuk doni ta bëni këtë dëgjuesë, është e qartë. Tani, hajdeni ta vendosim nëse do ta bëjmë, apo jo? E hedhim në votë, sepse kjo gjë nuk ka kuptim.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Hajdeni ta vazhdojmë dhe të bëhemi të mirë me gjërat që themi vetë.

**Milva Ekonomi** – Të lutem!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** – Jua dhashë informacionet që kam. Dy i kanë ngelur asamblesë. Kanë sjellë përfaqësi. Në dijeninë time, dy universitete nuk i kanë mbledhur asambletë dhe janë të deleguarit e dekanëve. Do vazhdojmë kështu siç janë, 2 po, 2 jo...?



**Fidel Ylli** - Unë nuk mendoj që duhet të vazhdojmë, nëse nuk kanë mbledhur asamblетë. S' duhet t'i thërrasim.

**Albana Vokshi** – Këtë po them.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Fidel Ylli** - ...e kam thënë që në krye të herës, duhet të vëmë disa procedura se kë do të thërrasim dhe si do t'i thërrasim, se janë 100 mijë studentë. Si do t'i thërrasim...?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Më dëgjoni pak!

I kemi bërë kërkesë... Të ulemi dhe ta mendojmë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

*(Deputeti Shezai Rrokaj flet pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Ismet, doni të thërrasim dekanët? T'i thërrasim. Ndryshojnë gjërat. Ju mendoni se ne nuk duam t'i dëgjojmë. Ne duam t'i dëgjojmë të gjithë, absolutisht, por duhet të ndjekim një standard për të gjithë, se nuk mund ta bëjmë ca të nënës, ca të babait, ca të zgjedhur dhe ca... Të vendosim një standard. Doni t'i thërrasim dekanët? T'i ftojme dhe t'i dëgjojmë.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Kjo trupë që erdhi këtu, është e pacertifikuar. Ne e dimë shumë mirë këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të deleguar nga kush? Ai i Ekonomisë... Si paska ardhur Rezar Prifti?! Asambleja nuk është mbledhur!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Ne e dëgjuam atë kur nuk ishte mbledhur asambleja. Ose të thërrasim ata që kanë vendosur asamblетë, se, në një farë mënyre, ajo është zgjedhje e asamblesë, ose të vendosim dekanët dhe t'i thërrasim nesër, si të doni.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** – Shkresat janë nga dekanët. Nuk i kanë mbledhur. Nuk është zgjedhur nga përfaqësia, nga asambleja.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Shezai Rrokaj** – Shkresa thotë: “Asamblетë e universiteteve të Tiranës të dërgojnë përfaqësuesit e tyre për problematikën në klasë”. Na rezulton se një pjesë e kanë bërë këtë gjë dhe një pjesë nuk e ka zbatuar.

**Fidel Ylli** – Profesor, mund të sugjeroj një mendim?

Ne duhet t'i përmbahemi shkresës, por rektorët dhe dekanët nuk janë sustat tona, që ne të shtypim butonin sot dhe "hajdeni në orën 17:00".

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Të mërkurën nuk jeni ju. Jeni të zënë të mërkurën.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Shezai Rrokaj** – Nuk e përfaqëson dekani asamblenë.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Fidel Ylli** -... Jua kam thënë që në fillim. Po e bëni han komisionin, që të vijë kush të dojë! Ata janë 100 mijë studentë...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Edhe pedagogët nuk mund të vijnë të gjithë, por vijnë me përfaqësi.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** – Ju lutem, mund të vendosim për...!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Nuk janë mbledhur, Mirela.

Jemi dakord për asamblenë.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Këtë po them. Kanë bërë mbledhje ato. Kanë ngritur duart. Janë emra të zgjedhur...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Ka dy javë që kërkojmë të bëjmë dëgjesa. Po përpiqemi të...

**Albana Vokshi** – Të bëjmë një standard.

**Milva Ekonomi** – Me një standard, pra! Standardi që bëmë sot është standardi që dha grupi i interesit, se ne e dimë shumë mirë që asnjëri nga ata nuk ka përfaqësi për të qenë në asamblenë e universitetit, 50+1, as Rezar Prifti. Ju po thoni që nuk është mbledhur Ekonomiku...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Nuk janë mbledhur, pra! A shkelëm një standard pa firmë, shkelëm një standard me marrëveshje? Tani po vjen një standard me firmë dhe po thuhet: "Ja, ku jemi ne, përfaqësuesit e asamblesë". I kishim thirrur të premten. Për të gjitha arsyet e botës ne e shtymë. Tani nuk ka kuptim kjo që bëjmë! Tani, hajde nesër në orën 10:00...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Shezai Rrokaj** - ...Ne kemi detyrimin t'i thërrasim ata që i kanë mbledhur asamblenë dhe i kanë përfaqësuesit ligjorë; të tjerët, kur t'i mbledhin...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Mirela Kumbaro** – ...Tani, ose janë grupe interesi, ose nuk janë. Kjo është një eksperiencë që nuk mendoj se i vlen zotërinjve, që qëndruan 6 orë këtu, as neve që...

**Shezai Rrokaj** – Atëherë, punonjësit e Kuvendit të...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Milva Ekonomi** – Në qoftë se nuk vendosim dot duke u marrë vesh, hajde ta hedhim në votim për nesër. Përndryshe, kjo gjë nuk ka kuptim. Nuk bëmë asnjë gjë që të mos i prisnim ata. Menduam që duhet t'i prisnim, t'i jepnim pozicionin që kishin. Ashtu vendosëm... Nëse nuk biem dakord me fjalë, unë them ta hedhim në votë.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** – Vilma, po flasim për... Nuk e kemi problem, do t'i thërrasim të gjithë dhe do t'i dëgjojmë.

Ju lutem, se duhet të ikja që në orën 14:00!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

E dimë që e keni votën, Milva.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

A dëgjon që ka vërejtje? Dëgjoji të paktën këto!

Cili ishte vendimi i komisionit? Vendimi i komisionit... ta përmbledhim pak. Kemi rënë dakord që do t'i thërrisnim rektorët. Rektorët erdhën si institucion më vete, i zgjedhur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Mirela, të lutem, ta përfundoj! Duhet të iki.

Kemi rënë dakord për përfaqësues të asambleve, mbasi ato të mblidhen dhe të zgjedhin përfaqësues.

**Milva Ekonomi** – Na erdhi shkresa me firmë nga dekanati. Tani, ne nuk mund të bëjmë xhandarin, e kanë bërë apo nuk e kanë bërë.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Albana Vokshi** – Nuk kemi ndër mend të bëjmë atë që keni bërë ju sot. Harrojeni këtë! Ne nuk vihemi përballë... Të gjithë janë të nderuar, nuk i ndajmë... Këdo që do të thërrisni ju nesër, nuk e ndajmë, të PS-së apo të PD-së. Absolutisht, të gjithë të nderuar janë. Doni ta bëjmë kështu, siç e duan?.. E bëjmë nesër në orën 10:00 mbledhjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo është për nesër. Asamblatë, nesër në orën 10:00 të njoftohen. Nesër do të ezaurohet mbledhja me përfaqësuesit e asambleve.

Të hënë, të martën dhe të mërkurën kemi tri projektligje, sipas asaj që ju lexova. Duhet të vijë ministria e Arsimit që të na japë përgjigje për dëgjesën. Të hënë, të martën dhe të mërkurën kemi secilin prej ligjeve që kemi rënë dakord.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Jeni dakord?

Për orarin do të merremi vesh.

## **MBYLLET MBLEDHJA**